



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LIGJ

Nr. _____, datë _____ 2014

PËR SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Mbështetur në nenet 78, 81 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

PJESA E PARË

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i një kuadri ligjor i cili do të mundësojë garantimin e një furnizimi të qëndrueshëm dhe të sigurtë me energji elektrike të klientëve, nëpërmjet krijimit të një tregu funksional dhe konkurrues të energjisë elektrike, duke marrë në konsideratë interesat e klientëve, sigurinë dhe cilësinë e shërbimit të furnizimit me energji elektrike, në harmoni me mjedisin.

Neni 2

Objekti i ligjit

Ky ligj rregullon marrëdhëniet për kryerjen dhe zhvillimin e veprimtarive të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike, si dhe vendos rregullat lidhur me:

- a) hapjen, organizimin dhe funksionimin e një tregu konkurrues të energjisë elektrike;
- b) pjesëmarrjen në tregun e energjisë elektrike;
- c) dhenien e autorizimeve dhe licencave në sektorin e energjisë elektrike;
- d) rregullimin e aktiviteteve në sektorin e energjisë elektrike dhe mbrojtjen e klienteve, sigurinë e furnizimit dhe krijimin e strukturve konkurruese të tregut të energjisë;

- e) integrimin e tregut Shqiptar në tregun Rajonal dhe ate European të energjisë elektrike

Neni 3 Përkufizime

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **"Aksesi i palëve të treta"** është e drejta e të gjithë përdoruesve të sistemit për përdorimin e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes të energjisë elektrike, bazuar në kushtet e paracaktuara dhe të bëra publike, në përputhje me parimet e transparencës dhe mos-diskriminimit, kundrejt tarifave dhe kushteve të tjera të miratuara nga ERE;
2. **"Aktivitete të energjisë elektrike"** janë aktivitete ekonomike që lidhen me prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin e energjisë elektrike, si dhe funksionimin e tregut të energjisë elektrike;
3. **"Anëtar"** është çdo anëtar i Bordit të Komisionarëve të ERE-s, i emëruar në përputhje me këtë ligj, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe;
4. **"Balancim"** është tërësia e proceseve nëpërmjet të cilave operatori i sistemit të transmetimit operon dhe ruan frekuencën e sistemit brenda kufijve të përcaktuar të qëndrueshmërisë;
5. **"Tregu i balancimit"** është menaxhimi, i bazuar në treg, i funksioneve të balancimit të sistemit të energjisë elektrike, i operuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit.
6. **"Siguruesi i shërbimeve të balancimit"** është një pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike, i cili siguron shërbimet e balancimit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit, bazuar në kontratën për pjesëmarrjen në tregun e balancimit, sipas rregullave përkatëse të sigurimit të balancimit të sistemit të energjisë elektrike.
7. **"Përgjegjësia e balancimit"** është një detyrim i pjesëmarrësve të tregut për balancimin e prodhimit, konsumit, proceseve të shitblerjes të energjisë elektrike, në përputhje me programin e pranuar, duke qënë përgjegjës financiarisht kundrejt Operatorit të Sistemit të Transmetimit për sistemimin e disbalancave të krijuara. ,
8. **"Shërbimi i Balancimit"** është kapaciteti rezervë i kontraktuar dhe/ose energjia elektrike balancuese, e përdorur nga Operatori i Sistemit të Transmetimit për të siguruar balancimin.
9. **"Pala përgjegjëse për balancimin"** është një pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike ose përfaqësuesi i zgjedhur prej tij, përgjegjës për disbalancat e krijuara përballë Operatorit të Sistemit të Transmetimit.
10. **"Bordi i Komisionarëve"** ose **"Bordi"** është organi vendimmarrës i ERE-s, i përbërë nga pesë anëtarë, të emëruar sipas procedurave të përcaktuara nga ky ligj;
11. **"Burime të rinovueshme të energjisë"** janë burimet e rinovueshme jo-fosile, si era, energjia diellore, aero-termale, gjeotermale, hidrotermale dhe oqeanike,

- energji hidrike, biomasa, gazi i përfuar prej vend groposjes se mbetjeve, gazi i përfuar prej impianteve të trajtimit të ujërave të zeza dhe biogazi;
12. **"Burim rezerve"** është një burim dytësor i furnizimit me energji elektrike, që nuk është i lidhur me sistemin elektroenergjetik;
 13. **"Çertifikim"** është procedura, e cila përcakton përputhshmërinë me kushtet që sigurojnë pavarësinë dhe ndarjen e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, si një parakusht për përcaktimin dhe miratimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit;
 14. **"Derivativ elektrik"** është një instrument financiar që synon sigurinë e pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike nga luhajtjet e mundshme të çmimit të energjisë elektrike në treg, ku ky instrument lidhet me energjinë elektrike;
 15. **"Detyrimi i Shërbimit Publik"** është një detyrim jo diskriminues, që përfaqësohet nga një tërësi kushtesh, të cilat vendosen ndaj një të licesuari, që lidhen me krijimin e sigurinë e furnizimit, cilësinë dhe çmimet e rregulluara në sektorin e energjisë elektrike, eficientë e energjisë elektrike, energjinë nga burimet e rinovueshme e mbrojtjen e mjedisit dhe që nuk çënojnë konkurrencën, përveç atyre kushteve që janë thelbësisht të domosdoshme për të siguruar shërbimin publik në fjalë. **"Dispeçerimi"** është veprimtaria e kryer nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, që konsiston në menaxhimin në kohë reale të flukseve të energjisë elektrike dhe zbatimin e masave të nevojshme për operimin e bashkërenduar të komponentëve të sistemit elektroenergjetik, përfshirë centralet prodhuese, rrjetin e transmetimit dhe shërbimet ndihmëse të nevojshme për operimin e sistemit;
 16. **"Eficientia e energjisë/ Menaxhimi i kërkesës"** është përjasja që synon të ndikojë në sasi dhe në kohë konsumin e energjisë elektrike, në mënyrë të tillë që të reduktojë konsumin e energjisë dhe të ngarkesës së pikut, duke i dhënë përparaësi investimeve për eficientë e energjisë ose masave të tjera, të tilla si kontratat të furnizimit me ndërprerje në rast të rritjes së ngarkesës dhe rritjes së kapaciteteve gjeneruese.
 17. **"Eksport i deklaruar"** është dispeçerimi i energjisë elektrike që i korrespondon sasisë së energjisë elektrike që lëvrohet njëkohësisht në një vend tjetër si import i deklaruar, mbi e bazën e një marrëdhënie kontraktuale. ;
 18. **"ERE"** ose **"Enti Rregullator i Energjisë"** është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për sektorin e gazit natyror.
 19. **"Fluksi ndërkuftar"** është fluksi fizik i energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit të Shqipërisë, i cili vjen si rezultat i veprimtarisë së prodhuesve dhe/ose klientëve jashtë Shqipërisë. ;
 20. **"Forcë madhore"** është një akt ose ngjarje natyrore ose shoqërore si tërmetet, rrafetë, ciklonet, përmytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret ose luftërat, konfliktet e armatosura, kryengritjet, veprime terroriste ose ushtarake, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, si dhe akte apo ngjarje të tjera që janë përtej kontrollit të arsyeshëm dhe që nuk kanë ardhur për faj të të licencuarit dhe i licencuari nuk ka patur mundësi të shmangë një akt ose ngjarje të tillë nëpërmjet ushtrimit të vullnetit, përpjekjeve, aftësive, dhe kujdesit të tij të arsyeshëm;
 21. **"Furnizim"** është shitja, përfshirë rishitjen e energjisë elektrike tek klientët;

22. **“Furnizues”** është një shoqëri e liçencuar për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit;
23. **“Furnizues i mundësisë së fundit”** është një furnizues i caktuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji, i cili, ofron për një periudhë të kufizuar kohe, shërbim universal në kushte të rregulluara ndaj klientëve familjarë dhe atyre jo-familjarë të vegjël ose ndaj klientëve, të cilët nuk kanë mundur të kontraktojnë vet një furnizues, ose kanë humbur furnizuesin e tyre;
24. **“I liçencuar”** është një person i cili mban një licence, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
25. **“Import i deklaruar”** është energjia elektrike që lëvrohet në një vend, e cila në të njëjtën kohë, dispecerohet si eksport i deklaruar nga një vend tjetër. **“Interkonektor”** është një linjë transmetimi e ndërtuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ose një palë e tretë, e cila kalon nëpërmjetkufirit shtetëror të Shqipërisë dhe të një vendi tjetër dhe lidh sistemet kombëtare të transmetimit të të dy vendeve;
26. **“Interkonektor i ri”** është një interkonektor i papërfunduar dhe i pakomisionuar, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji;
27. **“Klient”** është një klient shumice ose fundor i energjisë elektrike;
28. **“Klient i vogjël jo-familjarë”** është një person fizik apo juridik, i lidhur në nivel tensioni 0.4 kV, i cili ble energji për përdorim në mjediset ku ai ushtron aktivitetin e tij dhe jo për qëllim rishitje;
29. **“Klient familjarë”** është një klient që blen energji elektrike vetëm për konsumin e tij familjar, pa përfshire konsumin për aktivitete tregtare;
30. **“Klient fundor”** është një klient që blen energji elektrike vetëm për përdorim vetjak;
31. **“Klient jo-familjar”** është çdo person fizik ose juridik që blen energji elektrike, e cila nuk shkon për përdorim familjar, përfshire prodhuesit dhe operatorët e shitjes me shumicë;
32. **“Klient në nevojë”** është një konsumator familjarë i cili për shkak të gjëndjes sociale, gëzon disa të drejta të veçanta lidhur me furnizimin me energji elektrike, të siguruara në raste përjashtimore sipas përcaktimeve të këtij ligji;
33. **“Kodet e Rrjetit”** do të thotë Kodi i Transmetimit dhe Kodi i Shpërndarjes;
34. **“Kodi Shpërndarjes”** është tërësia e rregullave teknike, të cilat rregullojnë funksionimin e rrjetit të shpërndarjes, si dhe vendosin kushtet dhe termat e shërbimit që ofrohet nga operatorët e sistemit të shpërndarjes për përdoruesit e sistemit të shpërndarjes;
35. **“Kodi i transmetimit”** është tërësia e rregullave teknike, të cilat rregullojnë operimin e sistemit të transmetimit, si dhe përcaktojnë kushtet e shërbimit që ofrohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ndaj përdoruesve të sistemit të transmetimit;
36. **“Komisioner”** është një anëtar i Bordit të Komisionarëve, pa përfshire kryetarin;
37. **“Kontrata e furnizimit”** është një kontratë për furnizimin me energji elektrike, por që nuk përfshin derivatet e energjisë elektrike;
38. **“Kontratë e plotë furnizimi”** është kontrata e furnizimit e cila përfshin përgjegjësitë e përdorimit të rrjetit të transmetimit ose shpërndarjes;

39. **“Kontroll”** janë të drejtat, kontratat ose cdo mënyrë tjetër, që vec e vec apo në mënyrë të kombinuar duke u bazuar në një rrethanë apo në një ligj, i akordojnë një subjekti, mundësinë e ushtrimit të një ndikimi vendimtar mbi një shoqëri të caktuar në veçanti nëpërmjet a) pronësisë ose të drejtës për të përdorur të gjitha ose pjesë të aseteve të kësaj shoqërie b) të drejta apo kontrata të cilat akordojnë ndikim të theksuar në hartimin votimin apo vendimmarrjen e organeve të asaj shoqërie. ,
40. **“Kufizim i kapacitetit”** është situata në të cilën, një interkonektor nuk mund të tranzitohet të gjithë fluksin fizik të energjisë elektrike që rezulton nga kërkesa për tregti ndërkombëtare kërkuar nga pjesëmarrësit e tregut, për shkak të mungesës së kapaciteteve të interkonektorëve dhe/ose e sistemit kombëtar të transmetimit;
41. **“Kryetar”** është Kryetari i ERE i cili është emëruar dhe shërben në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
42. **“Legjislacioni në fuqi”** janë aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në kohën e kryerjes së veprimtarive të parashikuara në këtë ligj;
43. **“Licencë”** është një autorizim që i jepet një personi për ushtrimin e aktiviteteve elektrike në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
44. **“Linjë direkte”** është një linjë elektrike që lidh një prodhues të veçuar nga rrjeti me një klient të veçuar nga rrjeti brenda territorit të vendit, ose një linjë elektrike që lidh një prodhues të veçuar nga rrjeti me një klient jashtë territorit të vendit, ose një linjë që lidh një prodhues me një shoqëri furnizimi, e cila furnizon me energji elektrike ambientet, filialet ose klientët e saj të kualifikuar;
45. **“Menaxhimi i kërkesës”** janë masat që ndërmerren me qëllim ruajtjen e stabilitetit të rrjetit, si reduktimi i ngarkesës ose ndërprerja e furnizimit, të rena dakord paraprakisht midis palëve;
46. **“Ministria përgjegjëse për energjinë ose Ministria”** është Ministria e Energjisë dhe Industrisë ose çdo Ministri pasardhëse përgjegjëse për sektorin e energjisë.
47. **“Modeli i tregut të Energjisë Elektrike”** është një dokument i përgatitur dhe miratuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji, i cili përcakton marrëdhëniet ndërmjet pjesëmarrësve të ndryshëm të tregut të energjisë elektrike, me qëllim krijimin e një tregu konkurrues të produkteve dhe shërbimeve në sektorin e energjisë elektrike;
48. **“Operatori Pavarur i Matjes”** është një shoqëri me ekspertizë në matjen e energjisë elektrike që mund të kontraktohet nga operatori i sistemit të transmetimit ose shpërndarjes për të drejtuar dhe menaxhuar sistemin e tyre respektiv të matjes;
49. **“Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ose OSSH”** është një person juridik, përgjegjës për operimin e sigurt, të besueshëm dhe eficient të rrjetit të shpërndarjes, duke siguruar mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, të shtrirë në një zonë të caktuar dhe kur është e aplikueshme, lidhjet e tij me sisteme të tjera, për të siguruar aftësi afat gjatë të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë, në harmoni me mjedisin dhe efikasitetin e energjisë. ;
50. **“Operator i Sistemit të Transmetimit ose OST”** është personi juridik përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkoneksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike;

51. **“Operatori i Tregut** është përgjegjës për organizimin dhe menaxhimin e tregut të organizuar të energjisë elektrike;
52. **“Operimi i Tregut”** është veprimtaria që kryen Operatori i Tregut, lidhur me menaxhimin e tregut të energjisë elektrike, dhe përgatitjen e raporteve financiare për disbalancat e shkaktuara nga pjesëmarrësit e tregut, pa përfshirë blerjen apo shitjen e energjisë elektrike. ;
53. **“Pagesa e licencës”** është pagesa e përcaktuar nga ERE për dhënien e licencave për ushtrimin e një aktiviteti në sektorin e energjisë elektrike;
54. **"Palët e Komunitetit të Energjisë"** janë Palët Kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Bashkimi Europian dhe Shtetet Anëtare të tij;
55. **"Person"** është një person fizik ose juridik ;
56. **“Përdorues i sistemit”** është çdo person fizik ose juridik, i cili furnizon ose furnizohet me energji elektrike nëpërmjet sistemit të transmetimit ose të shpërndarjes;
57. **“Pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike”** është një person juridik, i regjistruar si pjestar i tregut të energjisë elektrike, që përfshin prodhuesit, , tregtarët, furnizuesit, furnizuesi i shërbimit universal, furnizuesi i mundësisë së fundit, klientët, operatori i sistemit të transmetimit, operatori i sistemit të shpërndarjes, sistemet e mbyllura të shpërndarjes dhe operatori i tregut. Operatori i sistemit të transmetimit dhe operatori i sistemit të shpërndarjes, janë pjesëmarrës të tregut të energjisë elektrike vetëm për qëllim të sigurimit të energjisë elektrike të nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjet, balancimin dhe shërbimet ndihmëse.;
58. **“Planifikim afatgjatë”** është planifikimi i nevojave për investime në kapacitetet prodhuese, transmetuese dhe shpërndarëse në baza afatgjata, me qëllim përputhjen me kërkesën e sistemit për energji elektrike dhe sigurinë e furnizimit të klientëve;
59. **“Prodhimi i energjisë”** është prodhimi i energjisë elektrike;
60. **“Prodhues”** është një person i licencuar për prodhimin e energjisë elektrike;
61. **“Prodhues i lidhur ne shpërndarje”** është një prodhues, centrali i te cilit është i lidhur ne sistemin e shpërndarjes;
62. **“Rregullat e Tregut”** janë rregullat që hartohen nga Operatori i Tregut dhe miratohen nga ERE, të cilat përcaktojnë rregulla të hollësisht mbi organizimin e tregut, regjistrimin e pjesëmarrësve, përgjegjësinë e balancimit prej pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike, rregullat për balancimin e sistemit të energjisë elektrike, rregullat për llogaritjen e disbalancës për palët përgjegjëse të balancimit; rregullat për përgjegjësitë financiare të palëve përgjegjëse të balancimit në rast të disbalancimit, dhe çështje të tjera lidhur me Operimin e Tregut;
63. **“Siguri”** është si siguria e furnizimit dhe garantimit të energjisë elektrike, si dhe siguri teknike;
64. **“Sistemi i energjisë elektrike”** është një sistem i ndërlidhur, i përbërë nga centralet elektrike, linjat elektrike, nënstacionet dhe pajisjet e transmetimit e shpërndarjes, me qëllim transmetimin apo shpërndarjen së energjisë elektrike të klientët;
65. **“Sistemi i shpërndarjes”** është sistemi i linjave, strukturave mbështetëse, pajisjeve transformuese dhe kyçëse/kyçëse, të përdorura për shpërndarjen e

- energjisë elektrike dhe lëvrimin e saj te klientët e vet. Kufiri ndarës midis sistemit te shpërndarjes me atë te transmetimit janë zbarrat 110 kV;
66. **"Sistemi i transmetimit"** është sistemi i përdorur për transmetimin e energjisë elektrike në tension të lartë dhe shume të larte, i lidhur në paralel me sistemet e vendeve te tjera që përfshin midis te tjerave linjat, strukturat mbështetëse, pajisjet transformuese dhe kyçëse/çkyçëse, për lëvrimin e energjisë elektrike te klientët, ose në rrjetin e shpërndarjes, pa përfshire furnizimin;
 67. **"Shërbime ndihmëse"** janë shërbimet e nevojshme për operimin e qëndrueshëm të sistemit të transmetimit ose shpërndarjes;
 68. **"Shërbim publik"** janë shërbimet që sigurohen nga një i licensuar që operon në sektorin e energjisë elektrike, i cili gjatë aktivitetit të tij merr në konsideratë objektivat e mbrojtjes së klientëve, sigurinë e furnizimit lidhur me cilësinë dhe çmimet e produkteve të sektorit elektrik, eficienten e energjisë, energjinë nga burimet e rinovueshme, mbrojtjen e mjedisit, si dhe nivele ekuivalente konkurrence në rajon;
 69. **"Shërbim universal"** është një shërbim publik i ofruar vetëm për klientët fundore te lidhur ne tension të ulët dhe në tension të mesëm i cili siguron të drejtën e tyre për tu furnizuar me energji elektrike të një cilësie të caktuar, brenda gjithë territorit të Shqipërisë, me çmime lehtësisht dhe qartësisht të krahasueshme, transparente, dhe jo-diskriminuese;
 70. **"Shoqëri Elektrike"** është çdo person fizik ose juridik që kryen të paktën një nga funksionet e mëposhtme: prodhim, transmetim, shpërndarje, furnizim, ose blerje të energjisë elektrike, i cili është përgjegjës për detyrimet tregtare, teknike ose të mirëmbajtjes lidhur me këto funksione, por që nuk përfshin klientet fundorë.
 71. **"Shoqëri e integruar e energjisë elektrike"** është një shoqëri elektrike e integruar vertikalisht ose horizontalisht;
 72. **"Shoqëri e integruar horizontalisht"** është një shoqëri e cila kryen të paktën një nga funksionet: prodhimit për shitje, transmetimit, shpërndarjes, ose furnizimit të energjisë elektrike, si dhe një aktivitet tjetër jashtë fushës së energjisë elektrike;
 73. **"Shoqëri e integruar vertikalisht"** është një shoqëri elektrike ose grup shoqëriash elektrike, ku i njëjti person ose persona kanë të drejtë, të ushtrojnë kontroll mbi këto shoqëri në mënyrë të drejtpërdrejte ose tërthorazi, dhe ku shoqëria ose grupi i shoqërive kryejnë të paktën një prej funksioneve të transmetimit ose shpërndarjes, si dhe të paktën një prej funksioneve të prodhimit ose furnizimit me energji elektrike;
 74. **"Shpërndarje"** është lëvrimi i energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes me tension të lartë, të mesëm dhe të ulët deri në dhe përfshire 35 kV, me qëllim lëvrimin e saj të klientët, pa përfshire furnizimin;
 75. **"Tranzit i deklaruar"** është sasia e energjisë elektrike që vjen nga një vend tjetër, e cila nuk konsumohet ne vend, por kalon në një vend të tretë;
 76. **"Tregu i organizuar i energjisë elektrike"** është platforma e organizuar për shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike në bazë të ditës në avante dhe/ose brenda të njëjtës ditë ditës;
 77. **"Tregu i energjisë elektrike"** është një sistem ku kryhen shitje dhe blerje efektive, përfshirë edhe derivativët të energjisë elektrike, nëpërmjet kërkesave dhe ofertave, të paraqitura në periudha afatgjata dhe afatshkurtra. **"Tregtar**

ose **klient Shumice**" është çdo person juridik i cili kryen aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike;

78. "**Tregtimi i energjisë elektrike**" është procesi që kryhet nga një person juridik që ble energji elektrike me qëllim rishitjen e saj brenda ose jashtë sistemit të vendit ku kryen veprimtarinë.
79. "**Vetprodhues**" është një person që prodhon energji elektrike, i cili konsumon kyesisht për nevojat e veta pjesën më të madhe të energjisë së prodhuar.

PJESA E DYTË

POLITIKAT E SEKTORIT të ENERGISË ELEKTRIKE

Neni 4

Politikat e sektorit të energjisë elektrike

1. Këshilli i Ministrave është përgjegjës për politikat e përgjithshme të zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike të Shqipërisë në përputhje me politikat e zhvillimit ekonomik dhe sektorët e tjerë të vendit.
2. Ministria përgjegjëse për energjinë:
 - a. Harton Strategjinë Kombëtare të Energjisë, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe përditësohet të paktën çdo pesë vjet. Strategjia Kombëtare e Energjisë përcakton objektivat e zhvillimit të sektorit të energjisë, si dhe rrugët e arritjes së tyre, duke siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë kombëtare për një periudhë afat-mesme dhe afat-gjatë;
 - b. Në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Energjisë harton programet afatmesme për zhvillimin e sektorit të energjisë elektrike, të cilat miratohen nga Këshilli i Ministrave.
 - c. Në përputhje me programet afatmesme vlerëson nevojën e ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese dhe fuqizimin e rrjeteve duke marrë parasysh:
 - i. bilancet e përgjithshme të pritshme të energjisë elektrike në të ardhmen;
 - ii. sigurinë dhe qëndrueshmerinë e furnizimit me energji elektrike;
 - iii. koston, duke përfshirë çdo mekanizëm të minimizimit të saj, për këto kapacitete të reja prodhuese.
 - d. Mbikqyr zbatimin e politikave dhe programeve të zhvillimit të sektorit energjetik, në përputhje me zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.

Neni 5

Të dhëna dhe informacione mbi bilancin e energjisë elektrike

1. Me qëllim zhvillimin e politikave të zhvillimit të sektorit energjetik dhe komunikimin me insitucionet e specializuara në kuadrin e angazhimeve ndërkombëtare të Shqipërisë, çdo person fizik ose juridik që prodhon, transmeton, shpërndan, importon, eksporton ose furnizon energji elektrike është i detyruar të paraqese pranë institucionit përgjegjës, për statistikën e energjisë të dhëna lidhur me veprimtarinë e tij, me qëllim përgatitjen dhe publikimin e bilancit vjetor energjetik.
2. Ministri përgjegjës për energjinë miraton llojin, formatin dhe shpeshësinë e raportimit të të dhënave pranë Ministrisë;

3. Ky nen nuk kufizon të drejtat e ERE për akses ndaj të dhënave në përputhje me dispozitatet e këtij ligji dhe akteve të tjera rregullatore.

PJESA E TRETË SIGURIA E FURNIZIMIT

Neni 6

Rregullat e sigurisë së furnizimit me energji elektrike

1. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit përgjegjës për energjinë, në bashkëpunim me institucionet ose entet e tjera që veprojnë në sektorin e energjisë elektrike, zhvillon dhe miraton rregullat për sigurinë e furnizimit me energji elektrike, të cilat përfshijnë të paktën:
 - a. masat për sigurinë e furnizimit me energji elektrike.
 - b. masat që ndermerren për rastet kur rrezikohet siguria e furnizimit;
 - c. masat që ndermerren për rastet e situatave emergjente.
 - d. rolin dhe detyrimet e pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike në lidhje me sigurinë e furnizimit me energji elektrike.
2. Masat dhe rregullat për sigurimin e furnizimit me energji elektrike duhet të marrin në konsideratë:
 - a. rëndësinë e sigurisë së furnizimit të vazhdueshëm me energji elektrike.
 - b. rëndësinë e një sistemi rregullator transparent dhe të qëndrueshëm
 - c. tregun e brendshëm dhe mundësinë e bashkëpunimit ndërkufitar lidhur me sigurinë e furnizimit me energji elektrike.
 - d. nevojën për mirëmbajtje të rregullt dhe kur është e nevojshme, përmirësimin e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes, me qëllim ruajtjen e sigurisë së performancës së rrjetit.
 - e. promovimin e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme.
 - f. nevojën e sigurimit të kapaciteteve transmetuese dhe prodhuese të mjaftueshme rezervë, për të ruajtur qëndrueshmërinë e rrjetit.
 - g. rëndësinë e inkurajimit të krijimit të një tregu të qëndrueshëm të shitjes me shumicë.
 - h. shumëllojshmërinë e burimeve të prodhimit të energjisë elektrike.
 - i. rëndësinë e zvogëlimin të efekteve afat-gjatë ndaj rritjes së kërkesës për energji elektrike;
 - j. rëndësinë e inkurajimit të efikasitetit të energjisë dhe përdorimit të teknologjive të reja, në veçanti lidhur me menaxhimin e kërkesës, burimet e rinovueshme dhe prodhimin e prej centraleve të lidhura në rrjetin e shpërndarjes;
 - k. Rëndësinë e shmangies së pengesave administrative ndaj investimeve në rrjete dhe kapacitete prodhuese.
3. Masat dhe rregullat e parashikuara në paragrafet (1) dhe (2) të këtij neni nuk duhet të jenë diskriminuese apo të parashikojnë detyrime të paarsyeshme ndaj pjesëmarrësve ekzistues e të rinj të tregut.
4. Në mënyrë që të promovohet eficientia e energjisë elektrike, ERE do të mbështesë nismat për optimizimin e përdorimit të saj, nëpërmjet nxitjes së shërbimeve efektive të menaxhimit të energjisë elektrike, aplikimit të formulave nxitëse të llogaritjes së çmimit, implementimin e sistemeve

inteligjente të matjes së energjisë elektrike. Këto nisma apo marrëdhënie financiare, do të jenë subjekt i miratimit nga ERE.

5. Pjesëmarrësit e tregut duhet të veprojnë në përputhje me masat dhe rregullat e sigurisë së furnizimit të parashikara në paragrafin (1) dhe (2), dhe do të jenë përgjegjës për sigurinë e furnizimit me energji elektrike në përputhje me aktivitetin që ushtrojnë.

Neni 7

Siguria e rrjetit dhe cilësia e furnizimit

1. Operatorëte sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjeshartojnë rregulla specifike që përmbajnë kërkesat minimale të sigurisë dhe operimit të rrjeteve të tyre, përfshi rregullat mbi cilësinë e furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit. Përpara propozimit të këtyre rregullave dhe kërkesave, operatorët e sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes, konsultohen me grupet e interesit vendas dhe të huaj. Rregullat dhe kërkesat miratohen dhe monitorohen nga ERE.
2. ERE mbikëqyr ruajtjen e një niveli të pershtatshem rezerve të kapacitetit teknik të transmetimit prej operatorit të sistemit të transmetimit, i cili bashkepunon edhe me operatorët e transmetimit të vendeve fqinje me të cilët është i ndërlidhur, me qëllim garantimin e sigurisë së operimit të rrjetit.
3. Operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes shkëmbejnë informacion mbi funksionimin e rrjeteve, në mënyrë efektive, në kohën e duhur, dhe në përputhje me kërkesat minimale operative të përmendura në paragrafin (1) të këtij neni, përfshirë shkëmbimin e informacionit me operatorët e huaj të sistemeve të ndërlidhura të transmetimit.

Neni 8

Balanca midis kërkesës dhe prodhimit

1. Me qëllim ruajtjen e balancës midis kërkesës për energji elektrike dhe disponueshmërisë së furnizimit të energjisë, merren masat si më poshtë vijon:
 - a. ERE do të përcaktojë rregulla në përputhje me Modelin e Tregut, që mundësojnë dhe nxisin krijimin dhe funksionimin e një tregu të hapur shumice, me çmime të përshtatshme për prodhimin, shitjen me shumicë dhe furnizimin;
 - b. Operatori i Sistemit të Transmetimi do të sigurojë disponueshmërinë e një kapaciteti rezervë të pershtatshem prodhimi, për qëllime balancimi në përputhje me kërkesat e operatorëve të rrjeteve evropiane të transmetimit të energjisë elektrike.
2. Me qëllim ruajtjen e balancës ndërmjet kërkesës për energji elektrike dhe kapacitetit të disponueshem prodhues, Këshilli i Ministrave mund të marrë masa të tjera shtesë, përfshirë, por pa u kufizuar në masat e mëposhtme:
 - a. përfshirjen e dispozitave në aktet përkatëse nënligjore që ndihmojnë në ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe futjen e shoqërive të reja prodhuese në treg;
 - b. eliminimin e pengesave që ndalojnë përdorimin e kontratave të furnizimit me ndërprerje;

- c. eliminimin e pengesave që ndalojnë përfundimin lidhjen e kontratave me afate të ndryshueshme, si për prodhuesit ashtu edhe për klientët;
 - d. inkurajimin e përdorimit të teknologjive të menaxhimit në kohë reale të kërkesës, si p.sh. sistemet e avancuara të matjes, etj;
 - e. inkurajimin e masave të kursimit të energjisë;
 - f. zbatimin e procedurave konkurruese, transparente dhe jodiskriminuese, mbi investimet e reja në kapacitetet prodhuese;
3. Masat e marra sipas këtij neni publikohen për të siguruar njohjen gjërësisht të tyre.
4. Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST), përveç përgjegjësive të tjera të përcaktuara në këtë ligj dhe në Modelin Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike përgatit një parashikim të përgjithshëm afat-shkurtër, afat-mesëm dhe afat-gjatë të kërkesës për energji elektrike dhe burimet mundshme të furnizimit, duke marrë parasysh kriteret dhe kërkesat e sigurisë së furnizimit.

PJESA E KATËRT ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË (ERE)

SEKSIONI I ORGANIZIMI

Neni 9

Organizimi i ERE

1. ERE është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit në Shqipëri.
2. ERE përbëhet nga Bordi i Komisionerëve (Bordi) dhe Personeli Teknik.
3. Bordi përbëhet nga Kryetari dhe katër anëtarë.

Neni 10

Pavarësia e ERE

1. ERE është një person juridik publik, ligjërish dhe funksionalisht i pavarur nga çdo institucion tjetër publik ose privat.
2. ERE dhe Komisionerët e tij ushtrojnë funksionet në mënyrë të paanshme dhe transparente. Të gjitha vendimet merren në menyrë autonome dhe të pavarura nga çdo subjekt politik, dhe çdo ent publik apo privat.
3. Bordi i Komisionerëve dhe Personeli Teknik i ERE, në çdo rrethane:
 - a) vepron në mënyrë të pavarur nga interesat e tregut ose private.
 - b) nuk kërkon ose pranon udhëzime nga asnjë institucion apo subjekt publik ose privat, në kryerjen e detyrave të tij.

Neni 11

Zgjedhja dhe emërimi i Anëtarëve të Bordit

1. Kryetari dhe Komisionerët do të emerohen nga Kuvendi i Shqipërisë, në përputhje me pikat (2), (3) dhe (4) të këtij neni.

2. Ekipi përzgjedhës i Komisionerëve përbëhet nga tre përfaqësues, dy prej të cilëve janë përfaqësues të Kuvendit të Shqipërisë, përkatësisht, Kryetari i Komisionit të Përherëshëm Parlamentar të Veprimtarive Prodhuese, Tregëtisë dhe Mjedisit, dhe kryetari i Komisionit të Përherëshëm Parlamentar të Ekonomisë dhe Financës, dhe i treti, është Ministri përgjegjës për energjinë. Ekipi përzgjedhës merr vendimet me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të tij. Jo më vonë se tre muaj përpara mbarimit të mandatit të njërit prej anëtarëve të Bordit, ekipi përzgjedhës me propozim të Ministrit përgjegjës për energjinë, përzgjedh paraprakisht dy kandidatë që plotësojnë kërkesat e pikes (4) më poshtë, për zgjedhjen dhe miratimin përfundimtar të anëtarit të ri të Bordit, prej Kuvendit të Shqipërisë.
3. Kur vendi i Kryetarit të Bordit mbetet vakant, anëtari i bordit me kohën më të gjatë në detyrë kryen funksionet e Kryetarit deri në emërimin e Kryetarit të ri. Vjetërsia llogaritet nga data kur është emëruar si anëtar Bordi. Kryetari dhe anëtarët e Bordit janë persona që kanë përfunduar studimet universitare dhe kanë eksperiencën e mëposhtme:
 - a. Kryetari është një person i shquar në fushën e energjisë. Ai/ajo duhet të ketë të paktën 15 vjet eksperiencë pune në sektorin e energjisë;
 - b. një nga anëtarët duhet të ketë jo më pak se 10 vjet eksperiencë pune në sektorin e energjisë elektrike dhe të jetë me profesion inxhinier;
 - c. një nga anëtarët duhet të ketë jo më pak se 10 vjet eksperiencë pune në sektorin e hidrokarbureve dhe të jetë me profesion inxhinier;
 - ç. dy anëtarët e tjerë, me profesion jurist ose ekonomist, duhet të kenë jo më pak se 10 vjet eksperiencë pune, prej të cilave të paktën 5 vjet duhet të jenë ekperiencë në sektorin energjetik.
4. Çdo anëtar i bordit emërohet për një mandat prej 5 vjetësh me të drejtë riemërimi vetëm të një mandati të dytë radhazi. Kryetari dhe Komisionerët të cilet kryejnë këtë funksion në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë ta kryejnë deri në përfundimin e mandatit të tyre.
5. Pagat dhe marrëdhëniet e tjera të punës, të punonjësve të ERE-s përcaktohen në përputhje me ligjin nr.9584, datë 17.07.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj." Bordi i ERE-s vendos mbi shpërblimet dhe kompensimet e tjera financiare dhe jo financiare të personelit teknik të saj. Pagat dhe kompensimet e tjera të stafit teknik të ERE, do të jenë të krahasueshme me nivelin e pagave dhe kompensimeve në shoqëritë, veprimtaritë e të cilave rregullohen nga ERE.
6. Pagat e anëtarëve të Bordit të Komisionerëve do të vendosen për periudhën e qëndrimit në detyrë dhe do të publikohen.

Neni 12

Shkarkimi dhe lirimi nga detyra i anëtarëve të Bordit

1. Çdo Anëtar i Bordit, përfshirë Kryetarin, mund të shkarkohet nga detyra nga Kuvendi vetëm në rast se:
 - a. nuk përmbush kriteret e pavarësisë të përcaktuara në Nenin 10 dhe 15 të këtij ligji;
 - b. denohet për kryerjen një vepre penale me një vendim gjykate të formës së prerë.
2. Çdo anëtar i Bordit, përfshi Kryetarin, lirohet prej detyres nga Kuvendi, kur:

- a. ai jep dorëheqjen;
 - b. bëhet ose kandidon për t'u bërë deputet i Kuvendit të Shqipërisë,
 - c. bëhet ose kandidon për tu bërë i zgjedhur i një njesie vendore;
3. Shkarkimi ose lirimi i anetarit të Bordit sipas pikave (1) dhe (2) të këtij neni bëhet me miratim të Kuvendit të Shqipërisë, me me propozim të ekipit përzgjedhës.

Neni 13

Kryetari i Bordit

1. Kryetari i ERE-s është administratori i përgjithshëm i ERE's dhe është përgjegjës për administrimin e institucionit, për drejtimin e mbledhjeve të Bordit, dhe për publikimin e vendimeve të tij.
2. Në rastet kur Kryetari mungon për një periudhë të caktuar kohore, atëherë cakton një nga anëtarët e Bordit që të ushtrorë funksionin e Kryetarit gjatë kësaj periudhe.

Neni 14

Personeli teknik dhe këshilltarët

1. Personeli teknik ndihmon Bordin në kryerjen e detyrave të tij. Personeli përzgjidhet, emërohet, ngrihet në detyrë dhe largohet nga detyra sipas kriterëve dhe procedurave të parashikuara në ligjin për statusin e nëpunësit publik. Personeli teknik gëzon statusin e nëpunësit publik.
2. Përveç personelit teknik të përhershëm, Bordi mund të marrë vendim për të punësuar kur e shih të arsyeshme, specialistë ose këshilltarë të jashtëm për të ndihmuar ERE-n në përmbushjen e funksioneve të saj.
3. Kostot lidhur me specialistët dhe këshilltarët e jashtëm, referuar pikës (2) të këtij neni mbulohen prej buxhetit të ERE.

Neni 15

Konflikti i interesit

1. Asnjë anëtar Bordi apo personel teknik i ERE-s nuk mund të jetë:
 - a. pronar, aksionar ose zotërues i pasurisë, ose një pjesë të saj, të një të licencuari që mban një licensë sipas kushteve të këtij ligji;
 - b. i punësuar ose nënkontraktor i një të licencuari, që mban një licensë sipas kushteve të këtij ligji;
 - c. anëtar i këshillit mbikqyrës apo organeve të tjera drejtuese të një të licencuari në sektorin e energjisë në Shqipëri;
 - d. drejtues, administrator, ose pozicion tjetër drejtues i një të licencuari që mban një licensë sipas kushteve të këtij ligji;
 - e. nuk mund të ketë interes të asnjë lloji në sektorin e energjisë.
2. Nëse gjatë procedurave aplikuese për dhënien e një licënce sipas këtij ligji, ose gjatë një procedure në të cilin përfshihen interesa financiare të një të licencuari, përfshirë por pa u kufizuar vetëm në çështje të tarifave, një anëtar Bordi ose personeli teknik gjendet në një situatë konflikti interesi, jashtë atyre të të përcaktuara në pikën (1) të këtij neni, atëherë nuk merr pjesë në shqyrtimin e aplikimit për dhënien e licencës apo procedura të tjera lidhur me të.
3. Anëtarit i Bordit ose personeli teknik mund të jetë klient i një të licencuari, por as i licencuari nuk i ofron dhe as anëtarit i Bordit apo personeli teknik nuk pranon, një

shërbim favorizues ose i ndryshëm nga shërbimi i përgjithshëm i ofruar me tarifa dhe kushte të njëjta për publikun.

4. Të gjithë anëtarët e Bordit dhe personeli teknik respektojnë legjislacionin në fuqi lidhur me konfliktin e interesit..

Neni 16

Mbledhjet dhe vendimet e Bordit të Komisionerëve

1. ERE harton dhe miraton rregullat e praktikës dhe procedurat e veta, dhe i publikon në faqen e saj zyrtare në internet.
2. Mbledhjet vendimmarrëse dhe seancat dëgjimore të Bordit janë të hapura. Në raste të veçanta Bordi mund të mbajë mbledhje me dyer të mbyllura, në përputhje me përcaktimet e rregullave dhe procedurave të ERE's.
3. Numri i nevojshëm i anëtarëve për të arritur kuorumin vendimarrës në një mbledhje të Bordit, është jo më pak se tre. Bordi merr vendimet me shumicë të anëtarëve të Bordit. Në rast të votave të barabarta, vota e kryetarit është përcaktuese.
4. Të gjitha vendimet e Bordit duhet të jenë qartësisht të arsyetuara.
5. Të gjitha vendimet e Bordit, përfshirë ato mbi tarifën e rregulluar dhe çmimet, përveç atyre që kanë të bëjnë me çështjet e brendshme të ERE-s, publikohen në Fletoren Zyrtare. ERE publikon në faqen zyrtare të internetit, një raport argumentues të hollësishëm, i cili përfshin bazën ligjore dhe provat për vendimin e Bordit të Komisionerëve, përfshirë sqarimin e pozicioneve thelbësore të palëve të përfshira në çështjen e shqyrtuar.
6. Çdo palë e përfshirë në një procedurë, mund t'i kërkojë ERE-s brenda 5 (pesë) ditë pune nga data e marrjes së vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi.
7. Të gjitha vendimet e Bordit të ERE-s nuk do të jenë objekt rishikimi ose të drejte veto-je nga asnjë organ tjetër publik, përveçse një rishikimi gjyqsor. Çdo vendim i Bordit të ERE-s mund të ankimohet në gjykatën administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike duke filluar nga data e publikimit të vendimit në Fletoren Zyrtare..

Neni 17

Financimi i ERE

1. ERE ka autonomi të plotë në përdorimin e buxhetit të saj.
2. Buxheti i ERE-s duhet të sigurojë të gjitha burimet financiare të nevojshme;
3. Burimet financiare të ERE-s përbëhen nga pagesat e rregullimit dhe pagesat e aplikimit të licencave, të miratuara nga ERE.
4. ERE-ja mban llogari të plota dhe të sakta mbi shpenzimet e kryera në përputhje me legjislacionin në fuqi mbi kontabilitetin.
5. ERE përcakton dhe miraton pagesën rregullatore që paguhet prej të licencuarve. Pagesa duhet të jetë në përpjestim të drejtë me të ardhurat vjetore që vijnë nga veprimtaria e licencuar.;
6. Kur ERE përcakton pagesën rregullatore, njofton të licencuarin mbi vlerën dhe afatet e pagesës. Nëse i licencuari nuk bën pagesën brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, ERE ka të drejtë të aplikojë masat administrative në përputhje me nenin 105 të këtij ligji.

7. Pagesat e rregullimit depozitohen në një llogari të veçante në një nga bankat që operojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Çdo fond në llogarinë e ERE-s, që nuk shpenzohet gjate një viti transferohet për vitin pasardhës, duke reduktuar proporcionalisht pagesat e rregullimit për vitin pasardhës.
8. ERE është e autorizuar të marrë kredi, nëse shpenzimet e saj kapitale ose operacionale nuk mund të mbulohen nga pagesat aktuale rregullatore. ERE-ja paguan kredinë përfshi interesat, prej pagesave të ardhshme të rregullimit.
9. Auditimi i veprimtarisë financiare të ERE-s kryhet nga ekspertë të miratuar kontabël, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

SEKSIONI II

OBJEKTIVAT, PËRGJEGJËSITË DHE TË DREJTAT E ERE's

Neni 18

Objektivat e Pergjithshme të ERE

Në kryerjen e funksioneve rregullatore të përcaktuara me këtë ligj dhe pa cenuar pavarësinë e tij, ERE konsultohet dhe bashkëpunon me autoritetet e tjera shtetërore, përfshirë autoritetin e konkurrencës. ERE merr të gjitha masat e nevojshme për të arritur objektivat e mëposhtme:

- a) nxitjen, në bashkëpunim të ngushtë me Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë, autoritetet e vendeve të tjera rregullatore si dhe Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, e krijimit të një tregu të brendshëm konkurrues të sigurve miqësor ndaj mjedisit brenda Komunitetit të Energjisë, dhe hapjen efektive të tregut për gjithë klientët dhe furnizuesit, duke siguruar kushtet e duhura për funksionimin efektiv dhe të qëndrueshëm të rrjeteve të energjisë elektrike, mbeshtetur në objektiva afatgjata;
- b) lehtësimin e futjes në rrjet të kapaciteteve të reja prodhuese, në veçanti heqjen e barrierave që mund të pengojnë futjen e pjesëmarrësve të rinj dhe atyre që prodhojnë nga burimet e rinovueshme;
- c) zhvillimin dhe funksionimin e një tregu rajonal konkurrues në Komunitetin e Energjisë me qëllim arritjen e objektivave të këtij ligji.
- d) eliminimin e kufizimeve në tregtimin e energjisë elektrike ndërmjet vendeve anëtare të Komunitetit të Energjisë, duke përfshirë zhvillimin e kapaciteteve ndërkufitare të transmetimit, me qëllim plotësimin e kërkesës dhe forcimin e integritetit të tregjeve të brendshme të cilët lehtësojnë qarkullimin e flukseve të energjisë ndërmjet vendeve anëtare të Komunitetit të Energjisë.
- e) ndihmon në arritjen në mënyrë efektive, të zhvillimit të një sistemi të sigurt, të besueshëm, jo diskriminues dhe në mbrojtje të konsumatorit, promovon funksionimin e një sistemi të përshtatshëm, në përputhje me objektivat e zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike, efikasitetit të energjisë elektrike si dhe integritetin në shkallë të gjërë të prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme.
- f) sigurimin e dhënies së stimujve të përshtatshëm ndaj operatorëve dhe përdoruesve të sistemit, në periudha afat shkurtra dhe afat të gjata, për rritjen e efikasitetit të performancës së sistemit dhe integritetin në tregun e energjisë;
- g) sigurimin e përfitimit të klientëve prej funksionimit efikas të tregut kombëtar, duke promovuar konkurrencën efektive dhe mbrojtjen e klientit.

- h) arrijtjen e standardeve të larta të shërbimit universal dhe atij publik në furnizimin me energji elektrike, mbrojtjen e klientëve në nevojë, dhe sigurimin e përpueshmërisë së nevojshme të procesit të shkëmbimit të të dhënave lidhur me ndryshimine furnizuesit.

Neni 19

Detyrat dhe kompetencat e ERE-s

1. ERE ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me këtë ligj dhe kuadrin ligjor në fuqi. ERE ka këto detyra:
 - a. së bashku me pjesëmarrësit e tjerë të sektorit të energjisë, bashkëpunon me Ministrinë në përgatitjen e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, i cili miratohet nga Këshilli i Ministrave.
 - b. në përputhje me kriteret e transparencës, miraton dhe publikon tarifat dhe metodologjitë e llogaritjes së tarifave të transmetimit, shpërndarjes, shërbimit universal ose shërbimeve të tjera publike;
 - c. Kur është e nevojshme, siguron shërbimin universal bazuar në detyrimet e shërbimit publik, të vendosura në përputhje me nenin 80 të këtij ligji, miraton metodologjinë dhe çmimet e konsumatorëve fundorë.
 - d. siguron ndarjen dhe detyrimet e tjera të operatorëve të sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, duke përfshirë edhe çështjet e transmetimit ndërkuftar.
 - e. Përbush dhe zbaton vendimet detyruese të Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë.
 - f. bashkëpunon për çështjet ndërkuftare me autoritetet rregullatore të vendeve të tjera fqinje si dhe me Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë, për harmonizimin e kuadrit rregullator për zhvillimin e tregut rajonal të energjisë elektrike, përfshirë edhe shkëmbimet ndër-kuftare të energjisë elektrike dhe rregullat për menaxhimin e kapaciteteve të interkoneksionit;
 - g. shmang ndër-subvencionimin ndërmjet veprimtarive të transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit;
 - h. respekton lirinë kontraktore mbi kontratat e furnizimit me ndërprerje dhe ato afatgjata, me kushtin që të jene në përputhje me legjislacionin mbi konkurrencën dhe ndihmën shtetërore;
 - i. siguron, në bashkëpunim me autoritete të tjera, zbatimin me efektivitet të masave mbrojtëse ndaj klientit, përfshirë ato të permendura në nenet 82 dhe 83 të këtij ligji;
 - j. siguron mundësinë e aksesit ndaj të dhënave të konsumit, për të bere të mundur përdorimin e një formati lehtësisht të kuptueshëm dhe të njehsuar në nivel kombëtar mbi të dhënat e konsumit, dhe akses të shpejtë të klientëve mbi këto të dhëna;
 - k. siguron mos-diskriminimin, konkurrencën dhe funksionimin efikas të tregut;
 - l. publikon metodologjitë e tarifave apo kushtet e shërbimeve të rregulluara;
 - m. kontribuon në përpueshmërinë e proceseve të shkëmbimit të të dhënave kryesore të tregut rajonal;
 - n. nxit masat mbi efijencën e energjisë dhe menaxhimin ekrësës, si dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit në sektorin e energjisë elektrike;
 - o. Publikon në faqen e tij të internetit raporte tre mujore në lidhje me funksionimin e tregut të energjisë elektrike. Permbajtja dhe afatet e publikimit të raporteve përcaktohen në modelin e tregut të energjisë elektrike.

- p. rishikon dhe rregullon tarifat e energjisë elektrike për veprimtaritë e rregulluara duke shmangur ndër-subvencionimin ndërmjet veprimtarive të prodhimit, shpërndarjes, transmetimit dhe furnizimit, si dhe ndërmjet kategorive të klientëve. Në përcaktimin e tarifave të aksesit në rrjet, ERE alokon incentivat përkatëse për liberalizimin e mëtejshëm të tregut të energjisë elektrike
- q. Miraton rregullat për shitjen, blerjen dhe shkëmbimin e energjisë elektrike për procedurat që zhvillohen nga të gjithë pjesëmarrësit e tregut që ushtrojnë funksionet e prodhuesit dhe furnizuesit të ngarkuar me kryerjen e shërbimit publik si dhe të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit në lidhje me sigurimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe transmetimit. Në hartimin dhe miratimin e ketyre rregulloreve, ERE do të bazohet në parimet e barazisë, konkurrencës dhe transparencës, sipas përcaktimit në modelin e tregut të energjisë elektrike.
2. ERE ka të drejtat e mëposhtme:
- a. merr vendime ta cilat janë të detyrueshme për zbatim prej gjithë të licencuarve që veprojnë në sektorin elektrik;
 - b. përcakton rregullat dhe kërkesat për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike.
 - c. harton dhe miraton metodologjitë e përdorura për të llogaritur dhe përcaktuar kushtet për;
 - i. lidhjen dhe aksesin në rrjetet kombëtare, përfshi tarifat e transmetimit dhe të shpërndarjes;
 - ii. kryerjen e shërbimeve të balancimit, të cilat kryhen në mënyrën më ekonomike të mundshme, dhe ofrojnë stimujt e përshtatshëm ndaj përdoruesve të rrjetit për të balancuar energjinë hyrese në rrjet dhe energjinë që konsumojnë prej rrjetit. Shërbimi i balancimit realizohet në menyre të drejtë, jo diskriminuese, bazuar në kritere objektive si dhe duke marrë në konsideratë koston e ofrimit;
 - iii. sigurimin e aksesit në infrastrukturat ndërkufitare, përfshi procedurat e alokimit të kapaciteteve dhe menaxhimin e kapaciteteve të kufizuara;
 - d. vendos detyrimin ndaj operatorëve të sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes, në rast se është e nevojshme, për të ndryshuar kushtet e shërbimit përfshi tarifat dhe metodologjitë e përmendura në këtë nen, për të siguruar zbatimin e tyre në mënyrë proporcionale dhe jo-diskriminuese. Në rast se operatorët e transmetimit ose shpërndarjes krijojnë vonesa në ndryshimin e tarifave, ERE ndryshon ose miraton tarifa apo metodologji tarifash të përkohshme transmetimi apo shpërndarje, dhe merr vendim mbi masat e përshtatshme kompensuese, në rast se tarifat apo metodologjitë përfundimtare rezultojnë të ndryshme nga ato të përkohshme;
 - e. kryen monitorime dhe vlerësime të funksionimit të tregut të energjisë elektrike, detyron të licencuarit të ndërmarrin masa të nevojshme dhe proporcionale, për nxitjen e konkurrencës efektive dhe sigurinë e funksionimit të tregut;
 - f. bashkepunon me autoritetin e konkurrencës dhe të mbikqyrjes së tregut për shqyrtimin e sjelljeve apo veprimeve të mundshme antikonkurrese prej pjesëmarrësve të tregut.

- g. kerkon informacion prej të licencuarve në kuadër të realizimit të detyrave të tij, përfshi arsyet mbi refuzimet e mundshme të dhënies së aksesit palëve të treta, si dhe çdo informacion mbi masat e nevojshme për të përforuar rrjetin;
 - h. vendos masa administrative efektive, proporcionale dhe parandaluese ndaj të licencuarve, të cilët nuk permbushin detyrimet e tyre, sipas dispozitave të nenit 105 të këtij ligji.
 - i. Shqyrton dhe miraton planet e investimeve të operatorëve të transmetimit dhe shpërndarjes, dhe monitoron zbatimin e tyre në përputhje me rregullat perkatese, si dhe siguron hartimin e tyre në përputhje me parimin e planifikimit me koston më të ulët;
 - j. vepron si autoritet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në lidhje me ankesat e paraqitura nga klientët dhe mosmarrëveshjet e lindura midis të licencuarve , në përputhje me rregullat dhe procedurat perkatese;
 - k. monitoron dhe kontrollon zbatimin e kontratave, performancën e shërbimeve të kryera nga të licencuarit, duke ushtruar të drejtën e kontrollit, aksesit mbi dokumentacionin dhe informacionin mbi të licencuarin, duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit të marrë.
 - l. kontrollon nëse furnizuesit kane respektuar kushtet e kontrates, ose nëse shërbimi është kryer në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kushtet e licencës së tyre apo rregulloret e miratuara nga ERE;
 - m. vendos ose miraton standarde dhe kërkesa mbi cilësinë e shërbimit të ofruar nga të licencuarit;
 - n. raporton, në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar në fuqi, në institucionet e Komunitetit të Energjisë dhe institucionet e tjera perkatese ndërkombëtare;
 - o. në rast mosmarrëveshje mbi ekzekutimin e një kontrate të rregulluar, ERE ka autoritet të detyrojëzbatiminesaj brënda një afati një (1) mujor.
 - p. Në rast se një pjesëmarrës i tregut të rregulluar refuzon të nënshkruajë një kontrate të miratuar nga ERE, atëherë ERE ka autoritetin të vendos hyrjen në fuqi të kontrates dhe detyrimin për zbatimin e saj prej palëve.
3. Pa cenuar pavarësinë dhe kompetencat e tyre të veçanta, në përputhje me parimet e një rregullimi më të mirë, ERE sipas rastit, bashkëpunon ngushtë me autoritetet e tjera kombëtare dhe grupet e interesit, në kryerjen e detyrave të përcaktuara në piken (2) të këtij neni.

Neni 20

Parimet e tarifave për operimin dhe shërbimet e rrjetit

1. Tarifat e aplikueshme për aksesin në rrjet, duhet të zbatohen në mënyrë jo diskriminuese ndaj të gjithë përdoruesve të rrjetit dhe duhet të jene transparente, të reflektojnë nevojën për garantimin e sigurisë së rrjetit dhe të reflektojnë kostot reale. . Niveli i tarifave të lidhjes në rrjet nuk duhet të këtë varësi nga distanca e përdoruesit me rrjetin e energjisë elektrikeNiveli i tarifave për prodhuesit dhe klientët, për lidhjen e tyre me rrjetin përcaktohet duke konsideruar nivelin e humbjeve në rrjet, kapacitetin e kufizuar që mund të shkaktohet nga këto lidhje dhe kostot e nevojshme të investimeve infrastrukturore që mundesojnë lidhjen me rrjetin. ERE në bashkëpunim me operatoret e rrjeteve, miraton rregullat që

- përcaktojnë kostot që do ti ngarkohen përdoruesit aplikant në lidhje me kushtet e veçanta të pikës së lidhjes.
2. Tarifat apo metodologjitë e përlogaritjes së tyre duhet të mundesojnë kryerjen e investimeve të nevojshme në rrjet, në mënyrë të tillë që të garantohet se këto investime do të sigurojnë qëndrueshmërinë e sistemit.
 3. Për përcaktimin e tarifave të aksesit në rrjet, do të konsiderohen:
 - a. pagesat dhe faturat që rezultojnë nga mekanizmi i kompensimit nder-kufitar i operatorit të sistemit të transmetimit.
 - b. pagesat e kryera prej dhe në favor të tij, si dhe pagesat e pritshme të periudhave të ardhshme, vlerësuar mbi bazën e periudhave të mëparshme.
 4. Vendosja e tarifave të aksesit në rrjet sipas këtij neni, do të behet pa paragjykuar detyrimet mbi eksportet dhe importet e deklaruar që rezultojnë prej menaxhimit të kapaciteteve të kufizuara, të referuar nenit 61.
 5. Nuk do të ketë pagesa të veçanta rrjeti lidhur me transaksionet individuale të tranziteve të deklaruar.
 6. Në vendosjen ose miratimin e tarifave apo metodologjive të tyre, si dhe në lidhje me shërbimet e balancimit, ERE siguron incentivat e duhura afat shkurtër dhe afat gjatë ndaj operatoreve të sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes, për rritjen e efektivitetit, rritjen e integritetit të tregut, sigurinë e furnizimit dhe mbështetjen e aktiviteve kërkimore.

Neni 21

Monitorimi

ERE monitoron veç të tjerave:

1. Hapjen e tregut dhe zbatimin e rregullave të tregut;
2. zbatimin e detyrimit të transparencës prej të licencuarve;
3. Nivelin e hapjes dhe efektivitetin e konkurrencës së tregut në nivel shitjeje me shumicë dhe pakicë, përfshi shkëmbimet, çmimet e klientëve përfshi sistemet e parapagesës, rregullat e ndryshimit të furnizuesit, rregullat e shkëputjes nga rrjeti, pagesat e shërbimeve të mirëmbajtjes, ankesat e klientëve dhe çdo shtrembërim apo kufizim të konkurrencës apo informacioneve të lidhura me të, si dhe informimin e autoriteteve kombëtare të konkurrencës mbi rastet e hasura;
4. Nënshkrimin e kontratave kushtëzuese, përfshirë ketu edhe kontrata me kushte të veçanta përjashtuese, të cilat mund të pengojnë klientet jo-familjare të mëdhenj, të kontraktojnë njëkohësisht me tepër se një furnizues, apo të kushtëzojnë zgjedhjen e këtij opsioni prej tyre. Në këto raste, ERE duhet të të informojë autoritetet kombëtare të konkurrencës;
5. Afatet brenda të cilave operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes, përfundojnë lidhjen e klientëve të rinj, apo kryejnë riparimet në rrjete;
6. Zbatimin e rregullave lidhur me rolet dhe përgjegjësitë e operatorit të sistemit të transmetimit, operatorit të sistemit të shpërndarjes, furnizuesve, klientëve dhe pjesëmarrësve të tjerë të tregut;
7. Investimet në kapacitetet e reja prodhuese lidhur me sigurinë e furnizimit;
8. Zbatimin e masave të sigurisë të përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji.

9. Sigurinë dhe qëndrueshmërinë e rrjetit, sigurinë e furnizimit përfshirë mbajtjen e nivelit të lartë të performancës, duke rritur nivelet e mëparshme të saj mbi sigurinë dhe qëndrueshmërinë;
10. Bashkëpunimin e operatorit të sistemit të transmetimit me operatorët e transmetimit të vendeve fqinje apo operatorëve të rrjeteve evropiane të transmetimit të energjisë elektrike, duke përfshirë sipas rastit, edhe monitorimin e zbatimit të mekanizmit të kompensimit ndër-transmetues të operatorit të sistemit të transmetimit, vendosur në kuadër të këtij bashkëpunimi. Rregullat mbi menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve të interkoneksioneve, në bashkëpunim me autoritetet rregullatore ose autoritetet kompetente të vendeve të tjera fqinje me të cilat është vendosur interkoneksioni;
11. Menaxhimin e kapacitetit të kufizuar në rrjetin e transmetimit përfshi interkoneksionet, dhe zbatimin e rregullave të menaxhimit të kapacitetit të kufizuar, përfshirë ndryshimin e këtyre rregullave kur është e nevojshme.
12. Publikimin e informacionit të duhur prej operatorit të sistemit transmetimit lidhur me interkonektorët, përdorimin e rrjetit dhe alokimin e kapaciteteve ndaj palëve të interesuara, duke ruajtur konfidencialitetin mbi informacionin e marrë.
13. Ndarjen efektive të llogarive, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, për të shmangur ndër-subvencionimet midis aktiviteteve të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit;
14. Kushtet dhe tarifat e lidhjes së prodhuesve të rinj, duke garantuar se janë objektive, transparente dhe jo-diskriminuese, duke konsideruar në veçanti kostot dhe përfitimet prej teknologjive të ndryshme të burimeve të rinovueshme.
15. Sigurinë e furnizimit me energji elektrike.

Neni 22

Regjimi rregullator për çështjet ndër-kufitare

1. ERE bashkëpunon me entet rregullatore të vendeve fqinje të rajonit dhe me Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë për:
 - a) krijimin e marrëveshjeve operative për menaxhimin optimal të rrjetit, promovimin e shkëmbimeve të ndersjellta dhe alokimin e kapaciteteve ndër-kufitare, si dhe rritjen e kapaciteteve të interkoneksionit nepermjet interkoneksioneve të reja, duke mundësuar rritjen e konkurrencës efektive dhe përmirësimin e sigurisë së furnizimit pa diskriminim të licencuarve dhe tregtareve të vendeve të ndryshme palë të Komunitetit të Energjisë;
 - b) koordinimin e hartimit, dhe zbatimit të kodit të rrjetit prej operatorit të rrjetit të transmetimit dhe aktorëve të tjerë të tregut;
 - c) koordinimin e hartimit të rregullave që rregullojnë menaxhimin e kapaciteteve të kufizuara.
2. Në bashkëpunim me autoritetet e tjera përkatëse kombëtare, ERE ka të drejtë të nenshkruajë marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet rregullatore të vendeve të rajonit për forcimin e bashkëpunimit rajonal rregullator.

Neni 23

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo palë e interesuar, që ka ankesandaj operatorit të transmetimit apo shpërndarjes, lidhur me zbatimin e detyrimeve të tyre përputhje me përcaktimet e këtij ligji apo akteve të tjera nenligjore të sektorit të energjisë elektrike, mund ti paraqesë për zgjidhje pranë ERE-s.
2. ERE vepron si autoritet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në lidhje me ankesat e paraqitura nga klientët ndaj të licensuarve dhe mosmarrëveshjet e lindura midis të licencuarve, në përputhje me rregullat dhe procedurat perkatese.
3. ERE si autoritet i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, merr vendim brenda një afati prej 2 (dy) muajsh nga marrja e ankesës. Kjo periudhe mund të zgjatet deri në 2 (dy) muaj të tjerë, në rastet kur ERE-s i nevojitet informacion shtesë. Çdo zgjatje përtej kësaj periudhe lejohet vetëm me miratimin e ankimuesit.
4. Vendimi i ERE-s është i detyrueshëm për zbatim prej paleve, përveç dhe vetëm nese ai anulohet me vendim gjykate të formës së prere.
5. Paraqitja e ankesës sipas parashikimeve të këtij neni, nuk i heq të drejtën palës së interesuar për tu drejtuar pranë organeve të tjera kompetente, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 24

Raportimi i ERE

1. ERE, brenda datës 31 Mars të çdo viti, paraqet në Kuvend një raport vjetor mbi situatën e sektorit të energjisë elektrike dhe veprimtaritë e ERE-s për vitin paraardhës. Ky raport, i hartuar në përputhje me piken (2) të këtij neni, publikohet në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
2. Raporti i përgatitur nga ERE në përputhje me piken 1 të këtij neni, përshkruan aftësinë e përgjithshme të sistemit të energjisë elektrike për të përmbushur kërkesën aktuale dhe atë të pritshme të energjisë elektrike, përfshirë në veçanti:
 - a. Sigurinë operative të rrjetit;
 - b. Balancën e parashikuar të kërkesës dhe furnizimit në tregun e brendshëm për një periudhë pesë-vjeçare;
 - c. Nivelin e pritshëm të kërkesës dhe perspektiven e sigurisë së furnizimit për një periudhë pesë deri pesëmbëdhjetë vjeçare nga data e raportit;
 - d. Kapacitetin shtesë prodhues të propozuar, planifikuar apo në faze ndërtimi;
 - e. Parashikimin e investimeve, për jo më pak se pesë vitet e ardhshme, që planifikohen të realizohen nga operatori i sistemit të transmetimit, apo çdo palë tjetër, lidhur me rritjen e kapacitetit ndër-kufitar të interkoneksionit;
 - f. Cilësinë dhe nivelin e mirëmbajtjes së rrjeteve;
 - g. Masat për mbulimin e kërkesës në pik dhe menaxhimi i mos realizimeve në furnizimin me energji elektrike; si dhe
 - h. Masat e përshtatshme, në rast nevojë, të rritjes së sigurisë së furnizimit.
3. Informacioni i i raportit vjetor, të përmendur në piken 2, germa (e) të këtij neni, bazohet në:
 - a) Parimet e menaxhimit të kufizimit të kapaciteteve në linjat ekzistuese dhe ato të planifikuara të sistemit të transmetimit;

- b) Modelet e pritshme të prodhimit, furnizimit, shkëmbimeve nder-kufitare dhe konsumit, duke mundësuar marrjen e masave për menaxhimin e kërkesës; dhe
 - c) Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel kombëtar, rajonal dhe European.
4. Në funksion të përgatitjes së raportit vjetor, Operatori i Sistemit të Transmetimit paraqet në ERE informacion të hollësishëm mbi:
- a) Investimet e parashikuara mbi linjat e interkoneksionit;
 - b) Investimet e parashikuara lidhur me ndërtimin e linjave të brendshme të rrjetit, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë në linjat e interkoneksioneve nderkufitare.

PJESA E PESTË DISPOZITAT E SISTEMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

SEKSIONI I DISPOZITAT E PERGJITHSHME TË SISTEMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE RREGULLAT MBI RRJETIN DHE INTERKONEKSIONET

Neni 25

Funksionimi i integruar i sistemit të energjisë elektrike

Sistemi i energjisë elektrike do të operojë si një sistem i integruar me procese të vazhdueshme prodhimi, transformimi, transmetimi, shpërndarje dhe konsumi të energjisë elektrike.

Neni 26

Lidhja me rrjetin

1. Operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes duhet të sigurojnë lidhjen me sistemin e transmetimit dhe shpërndarjes mbi kushte jo diskriminuese.
2. Operatori i sistemit të transmetimit nuk ka të drejte të refuzojë lidhjen në rrjet të një centrali të ri gjenerues bazuar në arsyetimin e kufizimeve të mundshme në të ardhmen, të kapaciteteve aktuale të rrjetit, apo krijimit të një kufizimi të kapacitetit në pjese të largëta të sistemit të transmetimit. Operatori i sistemit të transmetimit nuk ka të drejte të refuzojë një pikë lidhje të re, bazuar në arsyetimin së do të krijojë kosto shtese, lidhur me nevojën e krijimit të kapaciteteve shtese të elementeve të sistemit, në zonën përreth pikës së lidhjes.
3. ERE-ja do të miratojë rregullat dhe procedurat për lidhjet e reja, të hartuara nga operatori i rrjetit perkates, të cilat janë transparente dhe efiçente për të siguruar lidhjen në mënyrë jo-diskriminuese të çdo përdoruesi të sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes. Keto rregulla e procedura, specifikojnë edhe të drejtat dhe detyrimet e operatorit të rrjetit perkates dhe palës që kërkon lidhjen, në veçanti kushtet procedurale për lidhjen, afatet, pikat e matjes si dhe kufijtë e pronësisë midis sistemit dhe përdoruesit të sistemit,
4. Rregullat konsiderojnë në mënyrë të veçantë kostot dhe përfitimet që shoqërojnë lidhjen në rrjet të prodhuesve të burimeve të rinovueshme, si dhe rrethanat e veçanta të prodhuesve të vendodhur në zona të largëta dhe zona me dendësi të ulët të popullsisë. Lidhjet e prodhuesve të energjisë elektrike në rrjetet e transmetimit

dhe shpërndarjes, bëhen në bazë të një marrëveshje, sipas rregullave të miratuara nga ERE.

5. Operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes i japin çdo përdoruesi të ri që dëshiron të lidhet me rrjetin, informacion të plotë, përfshirë:
 - a. një vlerësim të plotë dhe të hollësishëm të kostove për realizimin e lidhjes së kërkuar.
 - b. afatin e nevojshem për përpunimin e kërkesës për lidhjen me rrjetin;
 - c. afatet e pritshme për propozimet e reja të lidhjes në rrjet.
6. Përdoruesit e rinj që dëshirojnë të lidhen në rrjet, pas miratimit të kërkesës për lidhje të re nga ana e operatorit përkatës të sistemit, mund të kontraktojnë pale të treta për kryerjen e punimeve për lidhjen në rrjet, në përputhje me dispozitat dhe specifikimet e përcaktuara në marrëveshjen e lidhjes, të nënshkruar ndërmjet përdoruesit të ri dhe operatorit të sistemit. Operatori i sistemit përcakton kriteret dhe kushtet teknike që duhet të plotësohen për lidhjen me rrjetin.

Neni 27

Kostot për lidhjen me rrjetin

1. Kostot e plota për lidhjen me rrjetin ekzistues, do të mbulohen nga pala kërkuese.
2. Kostot e lidhjes do të përcaktohen nga operatori i sistemit, në përputhje me metodologjinë e miratuar nga ERE. Metodologjia duhet të jetë jo diskriminuese, transparente dhe bëhet publike për palët e interesuara.
3. Kriteret për llogaritjen e pagesës së lidhjes marrin në konsideratë pikën e lidhjes dhe kapacitetin e saj, qëllimin e synuar dhe modelin e konsumit, ndonjë kërkesë të veçantë ose statusin e përdoruesit të rrjetit, si dhe karakteristika të tjera të lidhjes.
4. Kur lidhja kryhet prej operatorit të sistemit, kostot duhet të para-paguhën nga pala kërkuese. Këto kosto përfshijnë kostot e pajisjeve, mjetet e konsumit të nevojshme për instalimin të tilla si materiale pune dhe lëndë djegëse, amortizim i aseteve të përdorura për instalim, kostot e krahut të punës, shërbimeve të nenkontraktuara dhe kosto të tjera të lidhur me to.
Kostot e lidhjes, të ngarkuara palës kërkuese, përfshijnë gjithashtu edhe kostot që lidhen me përfundimin ose përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese ose përmirësimin e operimit të rrjetit që mund të nevojitet për lidhjen.
5. Operatori i sistemit të transmetimit ose i shpërndarjes në rast mungese të kapaciteteve të nevojshme për lidhjen e prodhuesve të rinj, mund të hyjë në marrëveshje me prodhuesin për përmirësimin e sistemit që të bëhet e mundur lidhja e kërkuar, ku specifikohen edhe afatet e rikthimit të investimit të parapaguar nga prodhuesi. Kjo marrëveshje miratohet nga ERE
6. Pavarësisht parashikimit të pikës (1) të këtij neni, për shfrytëzimin e burimeve të rëndësishme ujore ose zonave me rendesi energjetike, ku planifikohet të ndërtohen disa centrale prodhimi, ERE-ja mund të vendosë rast pas rasti, që investimet për lidhjen të kryhen prej operatorit të sistemit të shpërndarjes apo transmetimit, në përputhje me procedurat e përcaktuara në pikën (9) të nenit 59 të këtij ligji.
7. Në rast të lidhjes së njërive të reja prodhuese, lidhjet operohen respektivisht prej operatorit të sistemit të transmetimit ose shpërndarjes, përfshirë përgjegjësinë për mirëmbajtjen, kosto e se cilës mbulohet prej shoqërisë prodhuese, ndërsa pronësia e aseteve të lidhjes që i shtohen rrjetit ekzistues i mbetet prodhuesit, deri

në amortizim të plotë të aseteve apo deri në përfundimin e periudhës së koncesionit apo të autorizimit të dhënë, të përcaktuara në kontratën e miratuar nga ERE-ja.

Neni 28

Aksesi i palëve të treta

1. Operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes garantojnë aksesin në rrjet për gjithë klientët dhe përdoruesit e sistemit mbi baza jo-diskriminuese dhe bazuar në tarifën e miratuar nga ERE-ja.
2. Energjia e prodhuar prej burimeve të rinovueshme të energjisë, ka përparësi dhe i garantohet aksesin në rrjetet elektrike.
3. ERE-ja siguron që kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni zbatohen në mënyrë të vazhdueshme. Në rast se një palë të interesuar i është refuzuar aksesin në rrjet, ajo mund të ndjeke një procedurë për zgjidhje të mosmarrëveshjes, vetëm nëse nuk ka arritur të nenshkruajë një marrëveshje sipas përcaktimeve të pikës (3) të këtij neni.
4. Në rast refuzimi të aksesit në rrjet prej operatorit të sistemit të transmetimit ose shpërndarjes, ERE-ja, nëpërmjet operatorit të rrjetit, i siguron palëve të interesuara informacionin përkatës mbi masat e nevojshme për përfundimin e rrjetit. Në rastet kur kërkohet një informacion i tillë, operatori i rrjetit mund të aplikojë një tarifë të arsyeshme, e cila reflekton koston për sigurimin e këtij informacioni.

Neni 29

Interkoneksioni me sistemet e tjera elektro-energjetike

1. Sistemi kombëtar i transmetimit lidhet me sistemet e transmetimit të vendeve të tjera nëpërmjet linjave ekzistuese të interkoneksionit, atyre që do të ndërtohen nga operatori i sistemit të transmetimit në përputhje me planin e investimit të rrjetit të miratuar nga ERE, apo prej palëve të treta në përputhje me autorizimin e miratuar prej Këshillit të Ministrave, sipas parashikimeve të këtij ligji.
2. Operimi i sistemit të transmetimit, në paralel me sistemet e ndërlidhura të vendeve të tjera, kryhet në përputhje me marrëveshjet dy ose me shumë palëshe midis operatoreve të sistemeve të ndërlidhura të transmetimit, duke respektuar kërkesat teknike, kërkesat e operimit të sigurtë dhe standarde të tjera mbi interkoneksionet të përcaktuara nga ERE.

Neni 30

Detyrimet e operatoreve të rrjeteve

1. Operatori i sistemit të transmetimit dhe operatori i sistemit të shpërndarjes administrojnë rrjetet dhe marrin masa që gjatë ndërtimit dhe operimit të tyre, të respektojnë të gjitha kërkesat dhe kushtet teknike e të sigurisë, duke përfshirë edhe respektimin e distancave të sigurisë së rrjeteve në raport me objektet e tjera që u përkasin palëve të treta.

2. Operatori i sistemit të transmetimit apo operatori i sistemit të shpërndarjes, nuk ka asnjë detyrim ndaj pretendimeve të personave fizikë ose juridikë, për dëme të shkaktuara, si rezultat idistancës së rrjeteve të transmetimit apo shpërndarjes në raport me cdo objekt apo strukturë, në pronësi apo posedim të tyre, në rast se objekti ose struktura apo pjese të tij/saj, është ndërtuar apo vendosur pas ndërtimit të rrjetit

Neni 31

Interkonektorët e rinj në rryme të vazhduar

1. Interkonektorët e rinj në rryme të vazhduar dhe çdo rritje e konsiderueshme e kapacitetit të interkonektorëve ekzistues në rryme të vazhduar, të ndërtuar pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kërkesën e investitorit, mund të përjashtohen nga nga detyrimi për ti siguruar të drejtë aksesit palëve të treta mbi këtë linjë sipas parashikimeve të nenit 28 të këtij ligji, nëse permbushin kushtet e mëposhtme:
 - a) Investimi përmirëson konkurrencën në furnizimin e energjisë elektrike;
 - b) Niveli i riskut lidhur me investimin është i tillë, që investimi nuk do të mund të kryhej nëse nuk jepet përjashtimi nga detyrimi për ti siguruar të drejtë aksesit palëve të treta;
 - c) Interkonektori është pronë e një personi, i cili është i ndarë nga pikëpamja ligjore nga operatori i transmetimit;
 - d) Ndaj perdoruesve të interkonektorit aplikohen pagesa për shfrytëzimin e kapaciteteve të tij;
 - e) Asnjë pjese e kapitalit ose kostove operacionale të interkonektorit, nuk është shlyer prej ndonjë komponenti tarifash të aplikuar ndaj përdorimit të rrjetit të transmetimit apo shpërndarjes, të lidhur nga interkonektori;
 - f) Përjashtimi nga detyrimi për ti siguruar të drejtë aksesit palëve të treta, nuk dëmton konkurrencën ose funksionimin efektiv të tregut të brendshëm apo të tregut të vendit tjetër me të cilin është lidhur interkonektori.
2. Në raste të veçanta, pika 1, është e zbatueshme edhe për interkonektorët në rryme alternative, me kushtin që kostot dhe rrëzimet e investimit në fjalë, të jenë veçanërisht të larta krahasuar me kostot dhe rrëzimet e hasura normalisht për lidhjen me rrjetin e transmetimit të një vendi fqinj nëpërmjet një interkonektori me rryme alternative.
3. Përjashtimi mund të përfshijë një pjese ose të gjithë kapacitetin e interkonektorit të ri ose kapacitetit shtese të interkonektorit ekzistues, siç përcaktohet në pikën 1 të këtij neni.
4. Në marrjen e vendimit për dhënien e përjashtimit rast pas rasti, dhe në përputhje me vendimin e autoriteteve rregullatore të shteteve të përfshira, vendosen kushte lidhur me kohëzgjatjen e përjashtimit dhe aksesin jo-diskriminues në interkonektor, si dhe mënyrën e funksionimit të interkonektorit gjatë dhe pas periudhës së përjashtimit. Në vendosjen e këtyre kushteve, merren në konsideratë të vecantë kapacitetet e reja transmetuese që do të ndërtohen, rritja e kapaciteteve ekzistuese, afatet kohore të projektit dhe rrethanat specifike të vendeve të interesuara. Vendimi mbi përjashtimin, merret në bashkërendim me autoritetet rregullatore të vendeve të përfshira.
5. Para dhënies së përjashtimit, ERE vendos mbi rregullat dhe mekanizmat për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve, në marrëveshje të përbashkët me autoritetin rregullator të vendit të interesuar. Rregullat e menaxhimit të

- kapaciteteve te kufizuarado të përfshijnë detyrimin e ofrimit të kapaciteteve të papërdorura në treg. Në vlerësimin e kriterëve të përmendura në gërmata a), b) dhe f) të pikës 1 të këtij neni, merren në konsideratë rezultatet e procedurës së alokimit të kapaciteteve.
6. Kur ERE së bashku me autoritetet rregullatore të vendeve të interesuara kanë arritur një marrëveshje për vendimin e përjashtimit, brenda gjashtë muajve, ata informojnë Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë mbi këtë vendim, i cili në veçanti përmban:
 - a. arsyet mbi bazën e të cilave është dhënë ose refuzuar përjashtimi, përfshirë informacionin financiar që justifikon nevojën për përjashtim;
 - b. analizën e bërë për efektin mbi konkurrencën dhe funksionimin efektiv të tregut të brendshëm që rezulton nga dhënia e përjashtimit ;
 - c. arsyet për periudhën kohore dhe kapacitetin për të cilin është dhënë përjashtimi.
 - d. rezultatet e procesit të konsultimit të ERE.
 7. Jo më vonë se 2 muaj nga dita pasardhëse e marrjes së njoftimit, sipas pikës 6 të këtij neni, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë mund të nxjerrë një opinion mbi bazën e të cilit i kërkon ERE-s, të ndryshojë ose të shfuqizojë vendimin për përjashtim. Afati 2 mujor mund të zgjatet nëse del e nevojshme marrja e informacioneve shtesë nga ana e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Gjithashtu ky afat mund të zgjatet me përlqimin e ERE-s dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.
 8. ERE duhet të marrë në konsideratë opinionin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë që rekomandon ndryshimin apo shfuqizimit të vendimit për përjashtim. Në rastet kur vendimi përfundimtar i ERE-s është i ndryshëm nga opinioni i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, ERE duhet të sigurojë e të publikojë së bashku me këtë vendim, edhe arsyet mbi të cilat është mbështetur ky vendim.
 9. Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë do të marrë vendimin e përjashtimit në rastet kur:
 - kur autoritetet rregullatore të përfshira, nuk arrijnë në një vendim brenda 6 muajve nga data e fundit e depozitimit të kërkesës për përjashtim pranë autoriteteve rregullatore përkatëse;
 - mbi bazën e kërkesës së autoriteteve rregullatore të përfshira.
 10. Vendimi i përjashtimit, përfshire dhe çdo kusht të vendosur duhet të jetë i arsyetuar dhe duhet të publikohet.
 11. Këshilli i Ministrave, brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji miraton rregullat për dhënien e autorizimeve për ndërtimin e interkonektorëve të rinj, sipas parashikimeve të këtij neni. Autorizimi hyn në fuqi me marrjen e gjithë lejeve dhe autorizimeve të nevojshme të parashikuara nga legjislati në fuqi për ndërtimin e linjës, përfshirë të drejtat mbi titullin e truallit të nevojshëm ku do të ndërtohet linja, por në çdo rast, autorizimi nuk mund të jetë i vlefshëm në rast se kanë kaluar se 3 (tre) vjet nga data e lëshimit të tij. Autorizimi do të revokohet, në rast se pas 2 (dy) vjetësh nga momenti i hyrjes në fuqi të tij, investitori nuk ka filluar punën për ndërtimin e linjës ose në rast se pas 5 (pesë) vjetësh nga momenti i hyrjes në fuqi të tij interkonektori nuk është ndërtuar dhe nuk është vënë në shfrytëzim.
 12. Pas periudhës së përjashtimit, nëse pronari nuk do të përdorë linjën e interkonektorit në regjimin e aksesit të lirë prej palëve të treta sipas rregullave dhe

kërkesave që rregullojnë funksionimin e rrjetit kombëtar, fillimisht i ofron të drejtën e parablerjes për vlerën e mbetur të asetit, për pjesën e ndodhur brenda territorit kombëtar, Operatorit të Sistemit të Transmetimit. Në rast se Operatori i Sistemit të Transmetimit, refuzon ofertën, atëherë pronari mund të ofrojë shitjen e aseteve që gjenden brenda territorit të vendit ndaj palëve të treta, të cilat do të përdorin linjën në përputhje me rregullat dhe kërkesat që rregullojnë veprimtarinë e rrjetit kombëtar të transmetimit.

Neni 32

Linjat direkte

1. Linjat direkte, që ndërtohen për eksportimin e energjisë elektrike nga prodhuesi vendas drejt një konsumatori jashtë vendit, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Linjat direkte të cilat do të ndërtohen për lidhjen e një prodhuesi brenda vendit me një konsumator brenda vendit, apo një shoqëri furnizimi që furnizon mjediset e veta apo klientet e vet të kualifikuar, miratohet nga Ministriapërgjegjëse për energjinë.
3. Këshilli i Ministrave miraton kriteret për autorizimin e ndërtimit të linjave direkte, të cilat duhet të jenë objektive dhe jo-diskriminuese.
4. Ministria mund të autorizojë ndërtimin e një linje direkte nëse aplikuesit i është refuzuar aksesit në rrjet për rastet e parashikuara në nenin 28 të këtij ligji, ose nëse është iniciuar një procedure për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeve sipas parashikimeve të nenit 23 të këtij ligji.
5. Ministria, pas marrjes së mendimit të ERE-s, mund të refuzojë dhënien e autorizimit për ndërtimin e një linje direkte në rast se dhënia e një autorizimi të tillë pengon përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik dhe mbrojtjen e klientit, të përcaktuara sipas dispozitave të këtij ligji. Argumentat për një refuzim të tillë duhet të jenë plotësisht të arsyetuara;
6. Mundësia e furnizimit me energji elektrike nëpërmjet një linje direkte, sikurse përcaktohet në pikën 2 të këtij neni, nuk pengon të drejtën e klientit për të lidhur marrëveshje furnizimi me energji elektrike nga një furnizues tjetër i zgjedhur prej tij.
7. Shpenzimet për ndërtimin dhe operimin e linjave direkte do të përballohen nga mbajtësi i autorizimit.
8. Për krijimin, ushtrimin dhe përfundimin e të drejtave lidhur me ndërtimin dhe operimin e linjave direkte që kalojnë nëpërmjet pasurisë së një pale të tretë do të jepen të zbatueshme dispozitat e Kodit Civil.

Neni 33

Standardet teknike dhe të sigurisë në sektorin elektrik

1. Me propozim të Ministrisë përgjegjëse për energjinë, Këshilli i Ministrave miraton dhe publikon rregullat dhe kriteret teknike të zbatueshme, të cilat paraqesin

- kërkesat minimale të nevojshme për projektimin ndërtimin dhe operimin e lidhjeve me sistemin elektrik të njërive të prodhimit, sistemit të transmetimit, sistemit të shpërndarjes, instalimeve të brendshme dhe pajisjeve të klientëve të lidhur direkt, të interkonektoreve dhe të linjave direkte;
2. Rregullat dhe kriteret teknike të përmendura në pikën 1 të këtij neni duhet të jenë objektive, jo diskriminuese dhe të sigurojnë një operim të qëndrueshëm e të sigurt të sistemit të energjisë elektrike, përfshirë edhe ndërveprimin me sistemet e energjisë elektrike të vendeve fqinje.
 3. Centralet e prodhimit të energjisë elektrike, sistemi i transmetimit, sistemi i shpërndarjes, linjat e interkoneksionit ose ato direkte, konsiderohet se plotësojnë rregullat dhe kriteret teknike të aplikueshme ndaj tyre, kur ato janë në përputhje me standardet e harmonizuara Shqiptare.
 4. Ministria përgjegjëse për energjinë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Standardeve përgatit dhe i propozon Këshillit të Ministrave listën e standardeve të harmonizuara shqiptare që shërbejnë si standarde referuese për plotësimin e kushtit të përputhshmërisë me kriteret/rregullat teknike, sikurse përcaktohet në pikat(1) dhe (2) të këtij neni.
 5. Kontrolli i zbatimit dhe mbikëqyrja e kritereve dhe rregullave teknike të parashikuara në pikën 1 të këtij neni për sektorin e energjisë elektrike, do të kryhet nga strukturat përkatëse inspektuese në varësi të ministrit përgjegjës për energjinë , në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 34

Ndarja e llogarive të shoqërive të sektorit elektrik

1. Çdo i licencuar mban llogari të veçanta në librat e kontabilitetit për secilën nga veprimtaritë e licencuara që ushtron, sikur këto veprimtari të kryheshin nga të licencuar të veçante, me qëllim shmangien e diskriminimit, ndër-subvencionimit dhe shtrembërimit të konkurrencës. Ata gjithashtu mbajnë llogari, të cilat mund të jenë të konsoliduara, për aktivitetet e tjera të energjisë që nuk lidhen me shpërndarjen apo transmetimin. Çdo i licencuar që kryen veprimtari transmetimi apo shpërndarje të energjisë elektrike, mban llogari të veçanta nëse kryen aktivitete të tjera që nuk lidhen me energjinë elektrike.
2. Llogaritë e brendshme të të licencuarit, duhet të përfshijnë bilancin dhe pasqyrat financiare fitim-humbje për secilën veprimtari. Të ardhurat nga pronësia e sistemit të transmetimit ose shpërndarjes duhet të specifikohen në llogaritë e shoqërisë
3. Cdo i licencuar, do të përgatisë, paraqesë për auditim, dhe do të publikojë pasqyrat financiare vjetore në përputhje me legjislacionin për standardet e kontabilitetit në fuqi. Auditimi, në veçanti duhet të verifikojë nëse është respektuar detyrimi për shmangien e ndër-subvencionimit ndërmjet veprimtarive të licencuara.
4. Të licencuarit, të cilet nuk kane detyrimin ligjor për publikimin e pasqyrave financiare të tyre vjetore, do të mbajnë në selinë e tyre qendrore,një kopje në dispozicion të publikut.

Neni 35

Zonat e mbrojtura dhe të sigurisë

1. Për mbrojtjen dhe operimin normal të objekteve elektrike dhe të aseteve të tyre ndihmëse, si dhe për shmangien e rrezikut ndaj njerëzve, pasurisë dhe mjedisit, krijohen zona të mbrojtura dhe të sigurisë.
2. Këshilli i Ministrave brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton aktet nënligjore që përcaktojnë shtrirjen e zonave të mbrojtura dhe të sigurisë, si dhe ndalimet dhe kufizimet e aplikueshme për këto zona.

SEKSIONI II LIÇENCIMI

Neni 36

Veprimtaritë e liçencuara dhe përjashtimet

1. Çdo person juridikë kryen një veprimtari në sektorin e energjisë elektrike sipas pikës (2) të këtij neni, duhet të pajiset me liçencën përkatëse të lëshuar nga ERE, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.
2. ERE-ja lëshon liçencë për veprimtaritë e mëposhtme:
 - a) prodhimin e energjisë elektrike;
 - b) operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike;
 - c) operimin e sistemit të shpërndarjes të energjisë elektrike;
 - d) furnizimin e energjisë elektrike;
 - e) tregtimin e energjisë elektrike
 - f) operimin e tregut të energjisë elektrike
3. Forma, mënyra dhe tarifat e aplikueshme për dhënien e liçencave përcaktohen në rregulloren e procedurave të licencimit, e cila hartohet dhe miratohet nga ERENë në përputhje me nenin 37 të këtij ligji.
4. ERE jep liçencë për operimin e sistemit të transmetimit dhe operimin e tregut të energjisë elektrike vetëm një personi juridik publik.
5. Për kryerjen e secilit aktivitet, objekt i liçencimit nga ERE, do të jepen liçenca të veçanta, edhe në rastin kur i jepen të njëjtës shoqëri. Në vendosjen e kushteve të liçencave, ERE shmang mospërputhjet e mundshme ndaj kushteve të veprimtarive të ndryshme të kryera nga e njëjta shoqëri.
6. Njesite e pushtetit vendor mund të kryejnë secilën prej veprimtarive të përcaktuara në pikën (1) të këtij neni, nëse ato pajisen me liçencën përkatëse nga ERE, me përjashtim të aktivitetit të renditur në germen b) dhe f) të pikës 2 të këtij neni.
7. Për ndërtimin dhe operimin e një linje direkte nuk nevojitet liçencë transmetimi apo shpërndarje.

Neni 37

Procedurat e liçencimit

1. Liçencat jepen nga ERE-ja, sipas procedurave të cilat janë transparente dhe sigurojnë trajtim të barabartë, eficient dhe jo-diskriminues. Këto procedura miratohen nga ERE dhe përcaktojnë afatet, kushtet lidhur me dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e liçencave, pagesat e aplikimeve për liçencë, si dhe informacionin që duhet paraqitur në kërkesën për aplikimin për secilën lloj liçence.

2. ERE miraton procedura të thjeshta dhe të shpejta liçencimi për prodhuesit e lidhur në rrjetin e shpërndarjes, përfshirë edhe heqjen e detyrimit për tu pajisur me liçencë të prodhuesve dhe vetë-prodhuesve me kapacitet të instaluar deri në 1 (një) MË.

3. Një liçensë për furnizimin e energjisë elektrike përfshin edhe liçensën e tregtimit. Dhënia e një liçense të vecantë të tregtimit të energjisë elektrike, do të jetë subjekt i procedurave dhe kërkesave të thjeshtuara që do të përcaktohen nga ERE sipas parashikimeve të pikës 1.

Neni 38

Kushtet e liçencimit

1. ERE-ja përcakton kushtet që duhet të përmbushen për marrjen e e çdo liçence, duke marrë në konsideratë ndër të tjera:
 - a. afatin evlefshmërisë së liçencës, i cili për veprimtaritë e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes, nuk mund të jetë më shumë se 30 (tridhjetë) vjet;
 - b. vendndodhjet dhe zonat në të cilat do të kryhen veprimtaritë e liçencuara të energjisë elektrike.
 - c. sigurinë operative dhe qëndrueshmërinë e objekteve, pajisjeve apo rrjetit;
 - d. kërkesat mbi natyrën e burimeve parësore të energjisë;
 - e. kërkesat lidhur me sigurinë kombëtare, jetën e njerëzve, pasurinë, shëndetin e qytetarëve si dhe rendin publik;
 - f. kërkesat financiare;
 - g. mbrojtjen e mjedisit;
 - h. nxitjen e efikasitetit të energjisë në sektorin e energjisë elektrike;
 - i. detyrimet e shërbimit publik siç parashikohet në këtë ligj;
 - j. nxitjen e një tregu konkurrues të energjisë elektrike;
 - k. nëse aplikuesi është i organizuar në përputhje me parimin e ndarjesse veprimtarive dhe ndarjes strukturore të përcaktuara në këtë ligj.
2. Liçensa për operimin e sistemit të transmetimit, i jepet vetëm një subjekti, i cili certifikohet në përputhje me parashikimet e nenit 55 të këtij ligji.
3. ERE-ja ka të drejtë të kërkojë prova, të dhëna dhe dokumenta përkatës që nevojiten për të verifikuar kualifikimet dhe aftësitë e aplikuesit për një liçencë.

Neni 39

Njoftimi për aplikimet për liçencë dhe vërejtjet

1. Për çdo aplikim për marrjen e një liçence ,në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, ERE-ja publikon brënda 14 ditëve nga kryerja e aplikimit, njoftimin për aplikimin e bërë për dhënie liçence, në përputhje me mënyrën e përcaktuar në Rregulloren për Procedurat e Liçencimit.
2. Gjatë marrjes së vendimit, ERE duhet të marrë në shqyrtim dhe të vlerësojë vërejtje ose kundërshtimet e arsyeshme e të bazuara, të paraqitura nga ana e publikut në lidhje me kërkesën për liçencë. Kur një vërejtje apo ankesë është paraqitur nga një autoritet vendor dhe ERE konsideron se vërejtja ose ankesa është e pabazuar, ajo njofton autoritetin vendor me shkrim, duke dhënë arsyet për këtë vendim;
3. ERE-ja merr vendim për dhënien ose jo të një liçence prodhimi të energjisë elektrike brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e aplikimit, dhe brenda 30

(tridhjetë) ditëve nga data e aplikimit për licencat e tjera, përveç rastit kur mund të vendosë zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit, në përputhje me rregullat e praktikës dhe procedurat veta, të përcaktuara sipas nenit 16 të këtij ligji. Në cdo rast, zgjatja e afatit të marrjes së vendimit nuk mund të jetë më shumë se 30 (tridhjetë) ditë.

Neni 40

Refuzimi i një liçence

1. ERE-ja refuzon dhënien e një liçence, nëse aplikuesi nuk përmbush ndonjë nga kushtet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 38 të këtij ligji, ose në qoftë se dhënia e liçencës mund të shkaktojë dëmtim të pashmangshëm të shëndetit publik dhe mund të çenojë sigurinë publike. Vendimi i ERE-s specifikon arsyet për refuzimin. Kur ERE gjykon se ndonjë mosplotësim i kërkesave të mësipërme, nuk është thelbësor dhe mund të korrigjohet, ajo mund të japë licencën, me kusht që i liçencuari të përmbushë kushtin e paplotësuar brenda një periudhe të caktuar kohore të përcaktuar nga ERE.
2. Liçenca nuk i jepet një personi:
 - a. i cili është në proces falimentimi ose likuidimi siç parashikohet në legjisllacionin për falimentin;
 - b. të cilit i është revokuar ose hequr liçenca, dhe nuk ka perfunduar periudha brenda të cilës është i ndaluar riaplikimi për liçence, siç është përcaktuar në vendimin përkatës të ERE-s për heqjen e liçencës.

Neni 41

Heqja e një liçence

1. ERE heq një liçencë kur i liçencuari:
 - a. nuk përmbush kushtet thelbësore të liçencës të dhënë sipas këtij ligji;
 - b. shkel dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij;
 - c. rrezikon jetën, shëndetin dhe pasurinë e qytetarëve;
 - d. nuk kryen pagesat e rregullimit të vendosura nga ERE, siç kërkohet nga neni 17 i këtij ligji;
 - e. bëhet financiarisht i paaftë ose kërkon shpalljen e falimentimit;
 - f. me kërkesë të vetë liçencuarit;
 - g. ka pushuar së kryeri funksionet e caktuara për tu kryer sipas liçencës.
2. ERE-ja miraton rregulloren, ku përcakton procedurat e heqjes së një liçence në përputhje me nenin 16 të këtij ligji. Përveç rasteve të heqjes së liçencës në përputhje me përcaktimet e gërmave f) dhe g) të pikës (1) të këtij neni, këto procedura duhet të përcaktojnë detyrimisht që ERE:
 - a. të njoftojë me shkrim të liçencuarin mbi propozimin e ERE-s për heqjen e liçencës, të paktën 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara se vendimi të hyjë në fuqi, dhe në njoftim duhet të shprehë qartësisht arsyet për heqjen e liçencës.
 - b. t'i japë mundësinë të liçencuarit të përgjigjet me shkrim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit;
 - c. kur është në interesin e përgjithshëm, ERE mund t'i japë të liçencuarit 30 ditë kohë pas përgjigjes së tij me shkrim, që të veprojë në përputhje me termat dhe kushtet e liçencës dhe të shmangë shkakun për heqjen e propozuar.

3. Kur ERE heq një liçensë prodhimi, transmetimi, shpërndarje ose furnizimi subjekt i detyrimit të shërbimit publik, në mënyrë që pajisjet dhe pasuria pronë e të liçencuarit, të mund të vazhdojë të shfrytëzohen për sigurinë e furnizimit të energjisë elektrike ndaj konsumatorëve, ERE vendos një nga kushtet e përkohshme të përcaktuara më poshtë:
 - a. cakton një shoqëri tjetër për kryerjen e veprimtarisë së liçencuar;
 - b. i propozon Ministrin përgjegjës për energjinë të emërojë një administrator të përkohshëm publik për të marrë përsipër administrimin dhe operimin e shoqërisë, të cilës i është hequr liçenca sipas kushteve përkatëse të miratuara nga ERE. Në këtë rast, të gjitha të drejtat dhe detyrimet të krijuara deri në momentin e heqjes së liçensës dhe përcaktimit të administratorit të përkohshëm publik, i mbeten shoqërisë së cilës i hiqet liçenca.
4. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrin përgjegjës për energjinë, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton procedurën dhe kriteret për emërimin e administratorit publik të përkohshëm sipas pikës (3), gërma (b) e këtij neni.
5. Derisa liçenca të transferohet tek një shoqëri tjetër do të aplikohen kushte të përkohshme, për një periudhë jo më të gjatë se 12 muaj nga data e heqjes së liçencës.
6. Rregullat, procedurat dhe kriteret për zbatimin e kërkesave të sipas pikave (2) dhe (3) të këtij neni, përcaktohen nga ERE-ja në rregulloren përkatëse të procedurave të heqjes së liçencës.
7. Kur ERE heq liçencën e transmetimit apo shpërndarjes, Këshilli i Ministrave brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e heqjes së liçencës nis procedurën e shpronësimit me një kompensim të arsyeshëm të aseteve të të liçencuarit, bazuar në legjislacionin në fuqi.

Neni 42

Modifikimi i një liçence

1. Çdo i liçencuar mund të kërkojë modifikimin e kushteve të liçencës. ERE mund të modifikojë kushtet e një liçence, me kërkesën e të liçencuarit, pasi ka marrë në konsideratë ndikimet e pritshme që modifikimet e propozuara sjellin ndaj detyrimeve që i liçencuari ka, në përputhje me këtë ligj dhe kushtet e liçencës së tij.
2. Përpara miratimit të modifikimit të një liçence, me kërkesën e të liçencuarit, ERE publikon modifikimet e propozuara dhe shqyrton vërejtjet ose ankesat e mundshme të paraqitura nga publiku lidhur me këtë proces.
3. ERE mund të kërkojë modifikimin e kushteve dhe termave të një liçence kur ndryshojnë aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë në sektorin e energjisë elektrike, por pa shkaktuar ndonjë barrë financiare shtesë tek i liçencuari, bazuar në parimin e mosdiskriminimit.
4. Për modifikimin e një liçence zbatohen procedurat e mëposhtme:
 - a. ERE publikon një njoftim për aplikimin e të liçencuarit në formatin e përcaktuar në rregulloren për procedurat e liçencimit;
 - b. ERE nuk bën asnjë modifikim të liçencës pa shqyrtuar vërejtjet ose ankesat e mundshme lidhur me këtë aplikim sipas rregullores së procedurave të liçencimit.

Neni 43

Ndalimi i transferimit të një liçence ose asetëve

1. Asnjë i liçencuar nuk mund të transferojë liçencën ose ndonjë prej asetëve të tij të përdorura për kryerjen e veprimtarive të liçencuara, nëpërmjet shitjes, hipotekimit, lënies peng, dhënies me qira, shkëmbimit ose formave të tjera, pa miratimin paraprak me shkrim të ERE-s.
2. ERE, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton rregulloren mbi procedurat për shqyrtimin e shitjes, dhënies me qira, transferimit, hipotekimit, barrës ose çfarëdo lloj disponimi tjetër të paisjeve ose asetëve fikse të të liçencuarit, të përdorura për kryerjen e veprimtarisë së prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes, duke përfshirë edhe rastet përjashtimore të dhënies së miratimit për transferimin e asetëve me vlerë minimale.

Neni 44

Standardet e njehsuara të llogarive

1. ERE-ja brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, harton dhe miraton një sistem të njehsuar dhe standard të llogarive për gjithë të liçencuarit që veprojnë në tregun të energjisë elektrike, mbështetur në legjislacionin në fuqi dhe standartet e pranuar ndërkombëtare mbi kontabilitetin.
2. Raportimi vjetor financiar i të liçencuarve tek ERE-ja bëhet sipas këtij sistemi.

Neni 45

Aksesi ndaj llogarive të të liçencuarve

1. Të liçencuarit që operojnë në tregun e energjisë elektrike, brenda tre muajve të parë të vitit pasardhës, janë të detyruar të paraqesin në ERE, pasqyrat e plota financiare për vitin përkatës ushtrimor. Pasqyrat financiare që depozitohen në ERE, hartohen në përputhje me sistemin standard të llogarive sipas përcaktimeve të nenit 44 të këtij dhe duhet të jenë të audituara .
2. Në kryerjen e funksioneve të saj, ERE ka të drejtë aksesi ndaj llogarive të shoqërive që operojnë në tregun e energjisë elektrike.
3. ERE-ja ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar të marrë nga shoqëritë e liçencuara që veprojnë në tregun e energjisë elektrike. ERE-ja mund të transmetojë këtë informacion të ndjeshëm tregtar kur kërkohet nga autoritetet kompetente, në përputhje me funksionet e tyre të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 46

Detyrimet e shërbimit publik

1. Këshilli i Ministrave, duke marrë në konsideratë interesin e përgjithshëm kombëtar, mund të vendosë ndaj të liçencuarve në sektorin e energjisë elektrike që ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe shërbimit universal të furnizimit, një detyrim të shërbimit publik që lidhet me
 - i. sigurinë e furnizimit,

- ii. cilësinë e shërbimit,
 - iii. çmimin e energjisë elektrike për furnizimin e një kategorie të caktuar klientësh ;
 - iv. mbrojtjen e mjedisit, duke përfshirë efikasitetin e energjisë, energjinë nga burimet e rinovueshme dhe ndryshimet klimaterike.
2. Për të gjithë të licensuarit që ushtrojnë aktivitete të tjera, përveç atyre të përcaktuara në pikën 1 të këtij Neni, vendimi për përcaktimin e një detyrimi të shërbimit publik merret nga ERE.

2. Çdo detyrim i shërbimit publik i vendosur nga ERE-ja ose nga Këshilli i Ministrave, përfshihet në liçencën e të liçencuarit, duke ndjekur procedurën për dhënien e një liçence të re ose një modifikim të një liçence aktuale që disponohet nga i licensuari. 3. Detyrimet e vendosura të shërbimit publik , përcaktohen në mënyrë të qartë, transparente, jo-diskriminuese, të verifikueshme duke mos penguar hapjen e tregut.

Për të përmbushur kërkesën për transparencë, detyrimet e shërbimit publik të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe nga ERE, publikohen në fletoren zyrtare.

- a. Vendimi që vendos detyrimin e shërbimit publik duhet të:
 - i. përcaktojë në mënyrë të qartë detyrimin në fjalë trajtim të barabartë të tyre, duke siguruar furnizim të vazhdueshëm dhe me efektivitet ekonomik të energjisë elektrike, duke marrë në konsideratë mbulimin e kostove, etj.;
 - ii. Të përcaktojë qartësisht të liçencuarit në sektorin e energjisë elektrike, që do të jenë të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, duke konsideruar se ky detyrim mund të mos vendoset ndaj të gjithë të licensuarave në sektorin e energjisë elektrike;
 - iii. të specifikojë natyrën e çdo të drejte ekskluzive ose të veçantë që i është caktuar të liçencuarit në fjalë;
 - iv. të përcaktojë kategoritë e klientëve, zonën dhe periudhën për të cilën është vendosur detyrimi i shërbimit publik;
 - v. të përcaktojë qartësisht mënyrën e financimit dhe kriteret për përlllogaritjen e kompensimit do të merren nga të licensuarit, të cilëve u është ngarkuar realizimi i detyrimit të shërbimit publik .
 - vi. Të përcaktojë dhe të argumentojë qartësisht se masa e vendosur nëpërmjet vendimit, përbën kufizimin më të vogël dhe se është proporcionale dhe e domosdoshme për sigurinë e ofrimit të shërbimit publik në fjalë
 - b. Detyrimi i vendosur i shërbimit publik nuk do të krijojë diskriminim midis të liçencuarve të të njëjtës kategori, brënda vendit.
4. Asnjë i liçencuar nuk ka detyrim të ofrimit të shërbimit publik në një zonë në të cilën nuk e ka ofruar këtë shërbim para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç rastit kur përcaktohet nga Këshilli i Ministrave apo kërkohet nga rregullat e miratuara nga ERE-ja, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.
5. Kompensimi financiar, format e tjera të kompensimit dhe e drejta ekskluzive për realizimin e shërbimit publik do të vendosen në mënyrë transparente dhe jo

diskriminuere. Kostot e shkaktuara për realizimin e detyrimit të shërbimit publik, do të njihen nga ERE në momentin kur do të miratohen tarifat për shërbimet e realizuara, në përputhje me parashikimet e këtij ligji. ERE do të përcaktojë alokimin e kostove të përmbushjes së detyrimit të shërbimit publik tek klientët fundorë, në mënyrë transparente dhe jodiskriminuere.

Kompensimi për këto kosto, nuk duhet të tejkalojë kostot e shkaktuara për kryerjen e detyrimit të shërbimit publik, si rezultat i realizimit të të cilit, të licensuarit i ulen të ardhurat që do të siguronte. Kompensimi mund të përfshijë një fitim të arsyeshëm. Cdo kompensim që i bëhet të licensuarit për realizimin e detyrimit të shërbimit publik, do të jetë objekt vlerësimi në komisionin e ndihmës shtetërore.

6. Gjate kryerjes se veprimtarive të tyre, të licencuarit të cilët i nënshtrohen detyrimit të shërbimit publik respektojnë keto detyrime, dhe ofrimi i këtyre shërbimeve monitorohet nga ERE.
7. ERE, pas vendosjes së detyrimit të shërbimit publik ndaj një të licencuari të sektorit të energjisë elektrike, informon Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë lidhur me të gjitha masat e marra për të plotësuar detyrimet e shërbimit universal dhe të shërbimit publik, përfshirë mbrojtjen e klientit dhe të mjedisit.
8. ERE do të njoftojë Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë periodikisht cdo dy vjet, për cdo ndryshim në këto masa, pavarësisht nëse ato kërkojnë ose jo ndonjë devijim nga ndonjë dispozitë e këtij ligji.

SEKSIONI III

PRODHIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 47

Të licencuarit në prodhimin e energjisë elektrike

1. Prodhimi i energjisë mund të kryhet vetëm nga persona fizik ose juridik që janë pajisur me licencën e prodhimit të energjisë elektrike, përveç kur përcaktohet ndryshe nga dispozitat e tjeratë këtij ligji.
2. Këshilli i Ministrave përcakton autoritetin publik që do të përfaqësojë pronarin shtet të aksioneve të prodhuesit, i cili duhet të jetë i pavarur nga pronari i sistemit të transmetimit në kuptimin e nenit 52 të ligjit.

Neni 48

Procedurat e autorizimit dhe tenderimit për kapacitete reja prodhuese

1. Për përmbushjen e objektivave kombëtare të kapacitetit të instaluar prodhues, kapacitetet e reja mund të sigurohen nëpërmjet një procedure autorizimi, procedure të hapur apo ekuivalente, transparente dhe jodiskriminuere, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit përgjegjës për energjinë, miraton brenda 6 (gjashtë) muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, procedurat e autorizimit për ndertimin e kapaciteteve të reja prodhuese që, pavarësisht nga

- natyra e burimit parësor të energjisë nuk do të jenë objekt konçensionit, , procedura të cilat duhet të jenë objektive, transparente dhe jodiskriminuese.
3. Autorizimi për ndërtimin e burimeve të reja gjeneruese me fuqi të instaluar më të madhe se 1 MË, jepet nga Këshilli i Ministrave ndërsa autorizimi për ndërtimin e burimeve të reja gjeneruese me fuqi të instaluar më të vogël ose të barabartë me 1 MË jepet nga Ministria përgjegjëse për energjinë. Miratimi i autorizimeve do të bëhet në përputhje me procedurat e miratatuara sipas pikës 2 të këtij neni.
 4. Gjatë procesit të miratimit të autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese, duhet të merren në konsideratë rrethanat që kanë të bëjnë me:
 - a. Sigurinë e sistemit të energjisë elektrike, instalimeve dhe pajisjeve të lidhura me to;
 - b. mbrojtjen e shëndetit dhe të sigurisë publike
 - c. mbrojtjen e mjedisit;
 - d. përdorimin e truallit dhe vendndodhjen;
 - e. përdorimin e truallit publik;
 - f. eficientë e energjisë;
 - g. natyrën e burimeve parësore të energjisë;
 - h. karakteristikat e vaçanta të aplikuesit, të tilla si aftësitë teknike, ekonomike dhe financiare;
 - i. përputhjen me masat e marra për shërbimin publik dhe mbrojtjen e klientëve;
 - j. kontributin e kapacitetit prodhues në përmbushjen e objektivit të vënë për energjinë që duhet të prodhohet nga burimet e rinovueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi; dhe
 - k. kontributin e kapacitetit gjenerues në reduktimin e emetimeve të gazrave të efektit serë.
 - l. Shitjen e energjisë elektrike në tregun e parregulluar.
 - m. Vlera e royalty.

Neni 48/a

Procedurat e prokurimit i kapaciteteve të reja prodhuese ose i masave menaxhuese të kërkesës dhe eficientë së energjisë

1. Kapacitetet e reja dhe masat menaxhuese të kërkesës për energji apo eficientë së energjisë, duhet të sigurohen nëpërmjet një procedure prokuruese ose çdo procedure ekuivalente në aspektin e transparencës dhe mos diskriminimit, mbi bazën e kritereve të publikuara paraprakisht. Megjithatë, këto procedura prokuruese, mund të aplikohen vetëm në rastin kur kapacitetet e reja apo masat menaxhuese të kërkesës për energji dhe eficientë së energjisë, të cilat do të ndërtohen apo do të ndërmerren mbi bazën e procedurës së autorizimeve, janë të pamjaftueshme të garantojnë sigurinë e furnizimit me energji.
2. Kriteret e prokurimit për kapacitete të reja apo masat menaxhuese të kërkesës për energji dhe eficientë së energjisë duhet të reflektojnë interesat e mbrojtjes së mjedisit dhe promovimin e teknologjive të reja.
3. Të dhënat e procedurës së prokurimit, për kapacitete të reja prodhuese apo masat menaxhuese të kërkesës për energji dhe eficientë së energjisë duhet të

publikohen në një seksion të vecantë, në faqen e internetit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Specifikimet e procedurës së prokurimit, duhet të vihen në dispozicion të çdo shoqërie të interesuar, të themeluar në territorin e Republikës së Shqipërisë, në mënyrë që të kenë kohë të mjaftueshme, brenda së cilës të paraqesin një ofertë. Për të siguruar transparencë dhe jo diskriminim, specifikimet e procedurës së prokurimit duhet të përmbajnë një përshkrim të detajuar të të dhënave të kontratës përfshirë edhe incentivat përkatëse të aplikueshme, si dhe një listë shteruese të kritereve e kushteve përzgjedhëse, që duhet të përmbushen nga shoqëritë e interesuara.

4. Procedura e prokurimit i nënshtrohet kushteve të përcaktuara në këtë nen si dhe në legjislacionin në fuqi.

Neni 49

Të drejtat dhe përgjegjësitë e prodhuesit

1. Prodhuesit kanë të drejtë:
 - a. të përdorin në centralet e tyre elektrike burimet parësore të energjisë që ata i konsiderojnë me të përshtatshëm, duke garantuar prodhimtarinë, në përputhje me teknologjinë e prodhimit, karakteristikat teknike dhe kushtete mbrojtjes së mjedisit që përmbahen në liçencat e tyre.
 - b. të shesin energjinë elektrike dhe të sigurojnë shërbimet e balancimit dhe shërbimeve ndihmëse në tregjet e energjisë elektrike në përputhje me rregullat e tregut dhe rregulloret tjera të ERE's;
 - c. të krijojnë dhe mbajnë sistemin e tyre të telekomunikimit për lidhjen me objektet e tyre prodhuese, me klientet ose me nivelet operative të kontrollit.
 - d. të transmetojnë energjinë e tyre elektrike nepermjet Sistemit të Transmetimit ose Sistemit të Shpërndarjes;
 - e. të kenë akses në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes duke paguar tarifën përkatëse të miratuara nga ERE.
2. Prodhuesit janë të detyruar:
 - a. të respektojnë kushtet e liçencës së tyre të prodhimit;
 - b. të veprojnë në përputhje me urdhrat e lëshuara nga operatori i sistemit të transmetimit në përputhje me këtë ligj;
 - c. të sigurojnë shërbimet e balancimit në tregjet e energjisë elektrike në përputhje me rregullat e tregut dhe rregulloret e tjera të ERE's;
 - d. të njoftojë operatorin e sistemit menjëherë për çdo situatë të rrezikshme, aksident ose rrethana të tjera të cilat e rrezikojnë apo do të rrezikojnë sigurinë e furnizimit ose përmbushjen e ndonjë detyrimi tjetër kontraktor.
 - e. të respektojnë kodet e transmetimit ose shpërndarjes, rregullat e tregut dhe rregulloret e tjera të miratuara në përputhje me këtë ligj, përfshirë çdo detyrim mbi shërbimet ndihmëse;
 - f. të përmbushin të gjitha detyrimet e tjera që mund të lindin nga zbatimi i këtij ligji, rregulloreveveperkatëse dhe legjislacionit në fuqi, të cilat vendosin detyrime lidhur me operimin e centraleve prodhuese.
 - g. të japin të dhëna në përputhje me detyrimin e transparencës dhe monitorimit të tregut;

Neni 50

Rezerva e lëndës djegëse ose e kapacitetit prodhues

1. Subjektet të cilët prodhojnë energji elektrike duke përdorur lëndë djegëse janë të detyruar të mbajnë rezerva të veçanta të lendeve djegëse ose kapacitete rezervë prodhuese të energjisë elektrike, në mënyrë që të sigurojnë një furnizim të qëndrueshëm të klientëve.
2. Lloji dhe sasia e rezervës së lëndës djegëse ose e kapacitetit rezervë hidrik për tipe të ndryshme të centraleve prodhuese përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Çdo vendim sipas kësaj pike do të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe praktikat më të mira ndërkombëtare të industrisë.
3. Kostot e rezervës së lëndës djegëse dhe të kapacitetit rezervë të nje prodhuesi do të konsiderohen si kosto operimi.

SEKSIONI IV

TRANSMETIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 51

Operatori i sistemit të transmetimit

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit është personi juridik i licensuar për kryerjen e veprimtarisë së transmetimit të energjisë elektrike, i cili zotëron sistemin e transmetimit dhe përmbush kriteret e pavarësisë të përcaktuara sipas nenit 52 të këtij ligji.
2. Licenca për operatorin e sistemit të transmetimit e lëshuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të jetë e vlefshme për kryerjen e aktiviteteve të licencuara, deri në lëshimin e nje liçence të re sipas procedurës së certifikimit të përcaktuar në këtë ligj.
3. ERE-ja do të japë liçencën e re për operatorin e sistemit të transmetimit jo më vonë se data 1 qershor 2016.
4. Këshilli i Ministrave përcakton autoritetin publik që do të përfaqësojë pronarin shtet të Operatorit të Sistemit të Transmetimit me aset publike.

Neni 52

Ndarja e pronësisë së operatorit të sistemit të transmetimit

1. Operatori i sistemit të transmetimit është i organizuar si një subjekt i pavarur juridik, i ndarenga aktivitetet e tjera në sektorin e energjisë elektrike si prodhimi, shpërndarja, tregtia dhe furnizimi me energji elektrike, si dhe nga interesat tregtare, në përputhje edhe me parimet dhe kërkesat e përcaktuara në dispozitat e këtij ligji.
2. Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a administron sistemin e transmetimit të përbërë nga linjat dhe nënstationet 400 kV, 220 kV, linjat 110 kV dhe pjesën e

nenstacioneve 110/TM kV,perfshire zbarrat 110 kV deri ne ndaresin e anes 110 kV te transformatorit 110/TM kV.

3. Duke filluar nga data 1 janar 2016, i njejt person ose të njejtet persona nuk kanë të drejtë që në të njëjtën kohë:
 - a. në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të ushtrojnë kontroll mbi një të licensuar që kryen ndonjë nga veprimtarite e prodhimit apo furnizimit, dhe që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të ushtrojnë kontroll ose ndonjë të drejtë tjetër ndaj operatorit të sistemit të transmetimit ose rrjetit të transmetimit;
 - b. në menyre të drejtpërdrejt ose tërthorazi të ushtrojnë kontroll mbi operatorin e sistemit të transmetimit ose mbi rrjetin e transmetimit, dhe drejtpërdrejt ose tërthorazi të ushtrojnë kontroll ose të ushtrojnë ndonjë të drejtë mbi një të licensuari që kryen ndonjë nga veprimtarite e prodhimit apo furnizimin
 - c. të emërojnë anëtarët e keshillitmbikëqyrës, bordit drejtuesose organe që përfaqësojnë ligjërisht operatorin e sistemit të transmetimit aporrjetin e transmetimit, dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të ushtrojnë kontroll apo ndonjë të drejtë mbi një të licensuar që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit;
 - d. të jetë anëtar i keshillitmbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve të tjera që përfaqësojnë të licensuarin, që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit osefurnizimit,apo të një operatori të sistemit të transmetimit ose rrjeti transmetimi.
4. Ndalimet e parashikuara në pikën (3) te këtij neni do të zbatohen në mënyrë të veçantë për:
 - a. fuqinë për të ushtruar të drejtën e votës;
 - b. kompetencën për të emëruar anëtarët e keshillitmbikëqyrës, bordit drejtuesose organeve që përfaqësojnë të licensuarin, ose
 - c. mbajtjen e një pjese të shumicës së aksioneve.
5. Kur personi ose personat e përmendur në pikën 3 të këtij neni, është Shteti ose një tjetër organ publik, dy organe të veçanta publike që ushtrojnë kontroll njeri mbi operatorin e sistemit të transmetimit ose mbi rrjetin e transmetimit, dhe tjetri mbi nje shoqëri të energjisë elektrike që kryen funksionin e prodhimit apo furnizimit, do të konsiderohen sikur nuk jane i njëjti person ose persona.
6. Operatori i sistemit të transmetimit, i cili ka qene pjese e nje shoqerie të integruar vertikalisht, ose stafi i tij, duhet që në përputhje me kerkesat e ketij ligji, të mos transferoje informacione të ndjeshme tregtaretek njesite e tjera të shoqërisë së mëparshme të integruar vertikalisht që kryejnë ndonjë nga veprimtarite e prodhimit apo furnizimit me energji elektrike.

Neni 53

Të drejtat e operatorit të sistemit të transmetimit

1. Operatori i sistemit të transmetimit ka të drejtë të mbledhë dhe perdoretarifën e transmetimit të miratuar nga ERE, ne perputhje me metodologjinee miratuar paraparakisht dhe publikuar nga ERE-ja.

2. Operatori i sistemit të transmetimit nuk ka të drejtë të blejë dhe të shese energji elektrike, me përjashtim të rastit për mbulimine humbjeve te energjise në rrjetin e transmetimit dhe të sigurimit të shërbimeve të sistemit.
3. Operatori i sistemit të transmetimit mund të shkëmbejë ose të ndajë rezervat e kontraktuara me OST-te e tjera të vendeve fqinje, për te ruajtur stabilitetin e frekuencave në rrjetin kombëtar, në përputhje me dispozitatë marrëveshjeve operative me OST-të e rajonit.

Neni 54

Detyrat e Operatorit të Sistemit të Transmetimit

Detyrat e Operatorit të Sistemit të Transmetimit përfshijnë në veçanti:

1. përdorimin e pajisjeve të rrjetit të transmetimit në përputhje me rregullat dhe standardet teknike, objekt i inspektimit teknik nga organe të autorizuar të përcaktuara me ligj.
2. sigurinë e ofrimit të shërbimeve të sistemit në bazë të parimit të kostos dhe ndikimit mjedisor me të ulet, në mënyre transparente dhe jo-diskriminuese.
3. menaxhimi e flukseve të energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit, duke marrë parasysh shkëmbimet e energjisë elektrike me sistemet e tjera të ndërlidhura dhe sigurimine gjithë shërbimeve ndihmëse te nevojshme;
4. sigurimin e mos-diskriminimit midis gjithë përdoruesve të sistemit të transmetimit;
5. ofrimin e informacionit të nevojshëm ndaj përdoruesve te sistemit për përdorimin efiçent të rrjetit.
6. lidhjen e përdoruesve të sistemit me rrjetin e transmetimit dhe krijimin e kushteve teknike paraprake për lidhjen e përdoruesve në bazë të këtij ligji dhe akteve nenligjorene fuqi që rregullojnë procesin e lidhjes në rrjet;
7. përcaktimin dhe publikimin e procedurave transparente, efiçente dhe jo diskriminuese për lidhjen e centraleve të reja të prodhimit të energjisë me sistemin e transmetimit, me miratimin paraprak të ERE.
8. lidhjen e kontratave me qëllim sigurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, si dhe rezervën e energjisë dhe shërbimet e tjera ndihmëse të kërkuara për operimin e sigurt të sistemit, bazuar në parimet e transparencës mos-diskriminimit rregullave te tregut dhe koston minimale
9. hartimine Kodit të Transmetimit që miratohet nga ERE-ja dhe publikimin e tij në faqen e internetit;
10. kryerjen e balancimit të sistemit të mbështetur në parime objektive, transparente, e jo-diskriminuese, në përputhje me Kodin e Transmetimit dhe Rregullat e Tregut të miratuara nga ERE;
11. zbatimin, pas miratimit paraprak nga ERE, të rregullave objektive, transparente dhe jo-diskriminuese për alokimin e kapaciteteve transmetuese ndërkufitare.
12. shkëmbimin e informacionit të kërkuar me operatorët e transmetimit të sistemeve fqinje me qëllim sigurinë e funksionimit të sigurt dhe efikas, zhvillimin e koordinuar dhe ndërveprimin e sistemeve të ndërlidhura;

13. krijimin e një mekanizmi të trajtimit të ankesave për çështjet që kanë të bëjnë me aksesin dhe përdorimin e rrjetit të transmetimit;
14. alokimin e kapaciteteve të interkoneksionit dhe menaxhimin e kapacitetit të kufizuar me operatorët e rrjeteve të transmetimit fqinje, në bazë të kritereve objektive, transparente dhe jo diskriminuese, dhe publikimin e informacionit në lidhje me kapacitetet ndërkufitare në përputhje me dispozitat e nenit 61 të këtij ligji..
15. ruajtjen e informacionit të nevojshëm për vlerësimin e parametrave të cilësisë së furnizimit me energji elektrike në sistemin e transmetimit, bazuar në rregullat për cilësinë e furnizimit me energji elektrike, përfshi informacionin mbi sigurimin e furnizimit, cilësinë e tensionit, cilësinë e shërbimit dhe informacione të tjera të përcaktuara nga ERE-ja;
16. kryerjen e një analize vjetore të humbjeve në rrjetin e transmetimit, si dhe hartimin dhe zbatimin e masave të reduktimit të humbjeve dhe masa të tjera të efikasitetit të energjisë;
17. raportimin çdo tremujor në ERE, në përputhje me kërkesat e licencës, për sa më poshtë:
 - a. ndërprerjet e planifikuara, të nevojshme për mirëmbajtjen e rrjetit të transmetimit;
 - b. kërkesat e përdoruesve të sistemit dhe operatorit të sistemit të transmetimit për zhvillimin e rrjetit të transmetimit;
 - c. funksionimin e sistemit të transmetimit;
 - d. alokimin dhe përdorimin e kapaciteteve ndërkufitare në përputhje me detyrimet kontraktuale me OST-të e vendeve fqinje.
 - e. përdorimin dhe menaxhimin aktual të të ardhurave të siguruara nga konxhëstionet ndërkufitare;
 - f. kontratat mbi sigurinë e shërbimeve ndihmëse lidhura me ofruesit e këtij shërbimi; dhe
 - g. kontratat për prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit.
18. Operatori i Sistemit të transmetimit mban tregues të cilësisë të sistemit të transmetimit dhe paraqet raporte vjetore pranë ERE, në përputhje me rregulloren mbi cilësinë e furnizimit me energji elektrike të miratuar nga ERE;

Neni 55

Caktimi dhe çertifikimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit

1. Operatori i sistemit të transmetimit, për kryerjen e veprimtarisë së operimit të sistemit të transmetimit, çertifikohet sipas procedurës së përcaktuar në këtë nen.
2. ERE brenda 6- muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton një procedurë të hollësishme, që përcakton kërkesat për aplikimin dhe certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit sipas dispozitave të këtij neni, dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm për të provuar pavarësinë e përputhjes me nenin 52 të këtij ligji. I licensuari duhet të aplikojë me shkrim pranë ERE, duke

paraqiturdokumentacionin dhe informacionin e kërkuar nga procedura e miratuar nga ERE.

3. ERE-ja merr një vendim lidhur me certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit brenda 4 (katër) muajve nga data e aplikimit nga operatori i sistemit të transmetimit dhe dorëzimit të të gjithë dokumantacionit dhe informacionit të kërkuar.
4. ERE njofton Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë mbi projekt vendimin për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit.
5. Në çdo kohë gjatë procedurës së certifikimit, ERE-ja mund të kërkojë nga operatori i sistemit të transmetimit çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e këtij detyrimi sipas këtij neni. ERE ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar.
6. Vendimi përfundimtar i ERE për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit si dhe relacionin perkates, publikohet në faqen e internetit të ERE-s.
7. Operatori i sistemit të transmetimit njofton ERE-n për çdo veprimtari që planifikon të kryejë, e cila mund të kërkojë një rivlerësim prej ERE mbiperputhshmerine me kriteret e pavarësisë të parashikuara në nenin 52 të këtij ligji.
8. ERE-ja monitoron përputhshmërinë e operatorit të sistemit të transmetimit me kërkesat e pavarësisë të përcaktuara në këtë ligj. ERE-ja rishikon procedurën e certifikimit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, në rastet e mëposhtme:
 - a) pas njoftimit nga ana e operatorit të sistemit të transmetimit në përputhje me pikën 7 të këtij neni;
 - b) me nismën e saj, kur ka një dyshim të arsyeshëm, se një ndryshim i planifikuar në të drejtat ose ndikimet mbi pronësinë e sistemit të transmetimit ose operatorin e sistemit të transmetimit mund të çojë në shkelje të dispozitave të nenit 60, ose kur një shkelje e tillë mund të ketë ndodhur;

Neni 56

Zhvillimi i rrjetit të transmetimit

1. Çdo vit brenda datës 30 shtator, operatori i sistemit të transmetimit, pasi të jetë konsultuar me palët e interesuara, i paraqet ERE-s një plan dhjetë-vjeçar të zhvillimit të rrjetit, duke u mbështetur në kriterin e furnizimit dhe kërkesës ekzistuese dhe atë të parashikuar. Ky plan zhvillimi i rrjetit duhet të përmbajë masa efikase në mënyrë që të garantojë përshtatshmërinë e sistemit dhe sigurinë e furnizimit. Plani duhet të përfshijë edhe mjetet financiare të parashikuara për investimet në sistemin e transmetimit, duke marrë gjithashtu në konsideratë planifikimin urban dhe rajonal për zonën ku kalojnë instalimet e transmetimit dhe në përputhje me legjislacionin e mbrojtjes së mjedisit.
2. Plani dhjetë-vjeçar i zhvillimit të rrjetit në veçanti:
 - a. informon pjesëmarrësitë tregut mbi infrastrukturën transmetuese kryesore që duhet të ndërtohet ose përmirësohet gjatë dhjetë viteve të ardhshme;
 - b. përmban të gjitha investimet e miratuara, dhe identifikon investimet e reja të cilat duhet të zbatohen në tre vitet e ardhshme;

- c. vendos një afat për të gjitha projektet e investimeve.
3. Në përgatitjen e planit dhjetë-vjeçar të zhvillimit të rrjetit, operatori i sistemit të transmetimit bën projekttime të argumentuara mbi zhvillimin e prodhimit, furnizimit, konsumit dhe shkëmbimeve me vendet e tjera, duke marrë parasysh edhe planet e investimeve për rrjetet rajonale të Komunitetit të Energjisë.
 4. ERE-ja konsultohet në mënyrë të hapur dhe transparente, me të gjithë përdoruesit aktual ose të mundshëm të sistemit për planin dhjetë vjeçar të zhvillimit të rrjetit. Personave ose shoqërive që planifikojnë do të jenë përdorues të ardhshëm të sistemit mund tu kërkohej të paraqesin fakte për të mbështetur kërkesat tyre. ERE publikon rezultatin e procesit të konsultimit, duke paraqitur në mënyrë të veçantë nevojën e mundshme për investime.
 5. ERE do të shqyrtojë nëse plani dhjetë-vjeçar i zhvillimit të rrjetit mbulon të gjitha nevojat për investime të identifikuara gjatë procesit të konsultimit. Në rast se nevojat nuk pasqyrohen, ERE-ja mund të kërkojë nga operatori i sistemit të transmetimit të ndryshojë planin e tij dhjetë-vjeçar të zhvillimit të rrjetit.
 6. ERE monitoron dhe vlerëson zbatimin e planit dhjetë vjeçar të zhvillimit të rrjetit.
 7. Operatori i sistemit të transmetimit paraqet pranë ERE-ës, së bashku me aplikimin për miratimin e tarifës, planin e përditësuar të investimeve për vitin pasardhës. Në rast se operatori i sistemit të transmetimit aplikon për një tarifë për një bazë rregullatore më të madhe se 1 (një) vit, programi i investimeve do të përmbajë një analizë të investimeve të planifikuara për periudhën rregullatore përkatëse.
 8. Në rastet kur operatori i sistemit të transmetimit nuk përmbush një investim të parashikuar, i cili sipas planit 10 vjeçar të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, duhej realizuar në tre vitet pasardhëse, dhe nëse ERE-ja duke u mbështetur në parashikimet e kërkesës, gjykon se investimi është i nevojshëm dhe mund të financohet pa penguar operimin normal të rrjetit, atëherë ERE-ja merr të paktën një nga këto masa:
 - a. kërkon nga operatori i sistemit të transmetimit të zbatojë investimin në fjalë;
 - b. kërkon nga operatori i sistemit të transmetimit organizimin e një procedure prokuruese për realizimin e investimit në fjalë, të hapur ndaj çdo investitori ;
 9. Kur ERE-ja ushtron autoritetin e vetersipas pikës 8, gërma (b) e këtij neni, mund të detyrojë operatorin e sistemit të transmetimit të zbatojë një ose më shumë nga alternativat e mëposhtme :
 - a . financimin nga ndonjë palë e tretë ;
 - b . ndërtimin nga ndonjë palë e tretë ;
 - c .
 - d . pas ndërtimit, të administrojë asetet e reja.
 10. Operatori i sistemit të transmetimit i siguron investitorëve të gjithë informacionet e nevojshme për realizimin e investimit dhe bën përpjekjet maksimale për të lehtësuar kryerjen e këtij investimi.
 11. Kur ERE-ja ka ushtruar kompetencat e saj sipas pikës 9, tarifat përkatëse do të mbulojnë kostot e investimeve në fjalë.
 12. Çdo investim i ri në rrjetin e transmetimit i bërë nga një palë e trete sipas pikës 9 duhet të jete në përputhje me standardet teknike dhe normat e sigurisë në fuqi.

13. Vendimet e parashikuara në pikën (1) (8) dh (9) të këtij neni, miratohen nga ana e ERE-s pasi të jetë dhënë pëlqimi nga Ministri përgjegjës për energjinë ne perputhje me politikat dhe programin e zhvillimit te sektorit sipas nenit 4 te ketij ligji.
14. ERE-ja, brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, harton dhe miraton një rregullore për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planeve të zhvillimit dhe te investimeve.

Neni 57

Dispeçerimi dhe balancimi

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit është përgjegjës për dispeçerimin e energjisë elektrike nga centralet prodhuese dhe përdoriminelinajve te interkoneksionit,pa ndikuar nedetyrimet kontraktuale te furnizimit me energji elektrike, përfshirë edhe ato te specifikuarane procedurat tenderuese.
2. Dispeçerimi i energjisë elektrike nga centralet prodhuese dhe përdorimi i linjave te interkoneksionitbehetmbështetur në kriteret e përcaktuara në Kodin e Transmetimit, Rregullat e Tregut dhe rregulloret e tjera në fuqi të miratuara nga ERE.
3. Kriteret referuar në pikën 2 të këtij neni duhet të jenë objektive, të publikuara dhe të aplikuara në mënyrë jo-diskriminuese, që të sigurojnë një funksionim të drejtë të tregut të brendshëm të energjisë elektrike. Kriteret marrin në konsideratë renditjen e njësive prodhuese sipas kostos ekonomike të njësive, tranzitimit nëpërmjet interkoneksioneve, dhe kufizimet teknike të sistemit.
4. Operatori i sistemit të transmetimit, duhet t'i japë prioritet energjisë elektrike te prodhuar prej centraleve që përdorin burime të rinovueshme të energjisë elektrike, për aq sa mund të lejojë siguria e operimit të rrjetit kombëtar të energjisë duke u bazuar në kriteret transparente dhe jo diskriminuese. Operatori i sistemit të transmetimit siguron marrjen e masave operacionale të përshtatshme mbi rrjetin dhe tregun, me qëllim shmangien e kufizimit të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme.
5. Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet te përmbushi kërkesat minimale për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, përfshirë edhe kapacitetet e interkoneksionit.
6. Operatori i Sistemit të Transmetimit prokuron energji për të mbuluar humbjet në rrjetin e transmetimit dhe shërbimet e balancimit apo ndihmese, sipas procedurave transparente, jo diskriminuese dhe sipas rregullave të tregut.
7. Rregullat për balancimin e sistemit elektrik duhet të jenë objektive, transparente dhe jo diskriminuese, përfshirë dhe rregullat për pagesat prej përdoruesve të sistemit për disbalancat e energjisë.
8. Termat dhe kushtet, përfshirë rregullat dhe tarifatqë reflektojnë kostot, për realizimin e këtyre shërbimeve prejoperatoritesistemit të transmetimit, vendosen sipas metodologjisë së miratuar nga ERE në mënyrë jo diskriminuese, , dhe behen publike.

Neni 58

Prokurimi i humbjeve të energjisë në rrjetin e transmetimit, shërbimet e balancimit dhe shërbimet ndihmese

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit nëpërmjet një procedure konkurruese, jo diskriminuese, dhe transparente prokuron energjinë elektrike për të mbuluar humbjet në rrjet, shërbimet e balancimit ose ato ndihmëse të nevojshme për funksionimin e sistemit.
2. Procedurat e parashikuara në pikën (1) të këtij neni, miratohen nga ana e ERE-s pas propozimit të operatorit të sistemit të transmetimit.
3. Këto procedura, mund ti lejojnë operatorit të sistemit një periudhe tranzitore, jo me të gjatë se 12 muaj nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji, gjatë së cilës, energjia për mbulimin e humbjeve në rrjet, shërbimet e balancimit dhe ato ndihmese të mund të sigurohen me anë të kontratave bilaterale të miratuara nga ERE-ja.
4. ERE-ja është përgjegjëse për monitorimin dhe kontrollin e procedurave të prokurimit të parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni.

Neni 59

Kodi i Transmetimit

1. Operimii sistemit të transmetimit kryhet në përputhje me dispozitat e Kodit të Transmetimit.
2. Kodi i Transmetimit hartohet nga operator i sistemit të transmetimit në përputhje me Kodin e Rrjetit të ENTSO-E dhe miratohet nga ERE.
3. Kodi i Transmetimit përcakton:
 - a. metodat dhe kriteret për planifikimin dhe zhvillimin e sistemit;
 - b. kushtet dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikimin për akses në sistemin e transmetimit;
 - c. specifikimet minimale teknike dhe funksionale, për dhënien e aksesit dhe lidhjes me Sistemin e Transmetimit të centraleve prodhuese, shoqërive shpërndarëse, konsumatorëve fundorë si dhe interkonektorëve;
 - d. afatin në të cilin operatori i sistemit të transmetimit duhet t'i përgjigjet aplikimit të paraqitur, si dhe pasojat në rast se përgjigja nuk jepet brenda afatit të parashikuar;
 - e. shërbimet ndihmëse;
 - f. planin operacional dhe rregullat e planifikimit;
 - g. administrimin dhe kontrollin e sistemit në kushtet normale dhe ato emergjente të operimit;
 - h. rregullat e matjes;
 - i. kriteret e aplikuara nga operator i sistemit të transmetimit për dispeçerimin e instalimeve prodhuese në dispozicion, si dhe për përdorimin e interkonektorëve;

- j. mënyrën, afatin, kushtet dhe detyrimet sipas të cilave Operatori i Sistemit të Transmetimit, kur dispeçeron energjinë prej centraleveprodhuese, i jep përparësi centraleveprodhuese që përdorin burime të rinovueshme të energjisë elektrike dhe centraleveko-gjeneruese, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- k. çdo veprimtari tjetër të nevojshme për administrimin e besueshëm dhe të sigurtë të sistemit të transmetimit.

Neni 60

Konfidencialiteti i Operatorit të Sistemit të Transmetimit

1. Operatori i sistemit të transmetimit ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar të përftuar gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe parandalon çdo publikim informacioni mbi veprimtarinë e tyre që mund të krijojë avantazh tregtar nga publikimi në mënyrë diskriminuese, panvaresisht percaktimeve të nenit 45 të këtij ligji, apo ndonjë detyrimi tjetër ligjor për dhënie informacioni.
2. OST-ja nuk publikon të dhënat e ndjeshme tregtare të të licencuarve të tjerë, përveçse kur kjo është e nevojshme për kryerjen e një transaksioni tregtar. Për të siguruar respektimin e plotë të rregullave të informacionit dhe ndarjes së veprimtarive, ERE-ja merr masa që operatorii sistemit të transmetimit dhe të licencuarit e tjerë të sektorit nuk përdorin shërbime të përbashkëta, përveç funksioneve të thjeshta administrative apo të teknologjisë së informacionit (IT).
3. Operatori i sistemit të transmetimit në kuadër të kryerjes së veprimtarisë së tij, nuk keqpërdor informacionin e ndjeshëm tregtar të përftuar nga palët e treta në kuadër të ofrimit apo negocimit të aksesit në sistem.
4. Informacioni i nevojshëm për realizimin e konkurrencës efektive dhe funksionimin efikas të tregut, bëhet publik.

Neni 61

Menaxhimi i kapacitetit të kufizuar dhe alokimi i kapaciteteve të interkonjeksionit

1. Rastet e kapacitetit të kufizuar të rrjetit trajtohen në mënyrë jo-diskriminuese, duke u siguruar pjesëmarrësve të tregut dhe operatorit të sistemit të transmetimit trajtimin e tyre mbështetur në parimet e tregut. Kur është e mundur problemet e kapaciteteve të kufizuar në rrjet, zgjidhen me mënyra të thjeshta e të shpejta të cilat nuk përfshijnë transaksione financiare apo detyrimesh.
2. Operatori i sistemit të transmetimit harton rregullore specifike për menaxhimin e kapacitetit të kufizuar dhe alokimin e kapaciteteve të interkoneksionit, të cilat miratohen nga ERE-ja brenda 12 (dymbëdhjete) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
3. Rregullorja mbi alokimin e kapaciteteve të interkoneksionit parashikon në mënyrë të veçantë:
 - a) publikimin e informacionit mbi kapacitetet e interkoneksionit;

- b) shkëmbimin e informacionit mbi kapacitetet e interkoneksionit me operatorët e vendeve fqinj;
 - c) menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve të disponueshme të transferimit të interkoneksionit.
 - d) tregun sekondar të tregtimit të kapaciteteve të interkoneksionit
 - e) parime të përgjithshme dhe procedura për menaxhimin e kapacitetit të kufizuar;
 - f) përdorimin e të ardhurave nga alokimi i kapaciteteve të linjave të interkoneksionit dhe të ardhurave nga menaxhimi i kapacitetit të kufizuar.
4. Alokimi i kapaciteteve nuk duhet të diskriminojë pjesëmarrësit e tregut që dëshirojnë të ushtrojnë drejtat e tyre për përdorim të kontratave dypalëshe furnizimi apo për të ofertuar në tregun e hapur të energjisë elektrike.
 5. Të gjithë pjesëmarrësit e mundshëm të tregut, pa kufizim, do të lejohen të marrin pjesë në procesin e alokimit të kapaciteteve. Për të shmangur krijimin e problemeve të lidhura me përdorimin e mundshëm të pozitës dominuese të ndonjë pjesëmarrësi të tregut, ERE dhe/ose autoritetet përkatëse të konkurrencës, sipas rastit, mund të vendosin kufizime të përgjithshme ose të veçanta ndaj një shoqërie për shkak të pozitës dominuese të tregut.
 6. Procedura e kufizimit të transaksioneve të energjisë elektrike do të përdoret vetëm në situata emergjente, kur operatorit të sistemit të transmetimit i duhet të veprojë në mënyrë të ngutshme, dhe kur ri-dispecerimi ose shkëmbimi nuk është i mundur. Kjo procedurë duhet të aplikohet në mënyrë jodiskriminuese.
 7. Përdorimi i çmimeve rezervë në metodat e alokimit të kapaciteteve, nuk do të lejohet përveç rastit të linjave të reja të interkoneksionit, të cilat përfitojnë nga përjashtimi sipas nenit 31 të këtij ligji.
 8. Operatori i sistemit të transmetimit duhet të pranojë të gjitha transaksionet e mundshme tregtare, përfshirë edhe ato që rrjedhin prej tregtisë me vendet kufitare.
 9. Kur nuk ka situatë të kapacitetit të kufizuar, nuk do të ketë kufizim të aksesit në linjat e interkoneksionit.
 10. Alokimi i kapaciteteve të disponueshme të transmetimit zhvillohet në afatet paraprake të nevojshme.
 11. Të drejtat e aksesit për alokime afatgjata dhe afatmesme do të konsiderohen si të drejta të plota ndaj kapacitetit të transmetimit. Në momentin e nominimit të alokimit, ato i nënshtrohen parimeve "përdore-ose-humbe" ose "përdore-ose-shite".
 12. Për çdo alokimi, operatori i sistemit të transmetimit së bashku me OST-të respektive fqinje, publikojnë kapacitetet që do të alokohen, duke marrë parasysh sipas rastit kapacitetin e çliruar nga ndonjë e drejtë transmetimi dhe, (nominimet)!!! për kapacitetet nga të cilat është hequr dorë, së bashku me periudhën kohore gjatë së cilës kapaciteti do të reduktohet ose nuk do të jete i disponueshem.

Neni 62

Perdorimi i të ardhurave nga menaxhimi i kapaciteteve të kufizuara

1. Çdo e ardhur që rezulton nga alokimi i kapaciteteve të interkoneksionit përdoret për qëllimet e mëposhtme:
 - a) Garantimin e kapacitetit aktual të disponueshëm për kundërt kapacitetit të alokuar; dhe/ose
 - b) Mirëmbajtjenose përmirësimin e kapaciteteve të interkoneksionit nëpërmjet investimeve të rrjetit, veçanërisht në interkoneksionet e reja.
2. Në rastet kur këto të ardhura nuk mund të përdoren për qëllimet e parashikuara në pikën (1), atëherë këto të ardhura mund të përdoren deri në një vlerë të caktuar të vendosur nga ERE, si të ardhura që duhet të merren parasysh në miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave të rrjetit dhe/ose për ndryshimin e tarifave aktuale të rrjetit.

SEKSIONI V

SHPËRNDARJA E ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 63

Shpërndarja e energjisë elektrike

1. Shpërndarja e energjisë elektrike kryhet nga operatorë të sistemit të shpërndarjës të cilët janë persona juridik të liçencuar nga ERE sipas dispozitave të këtij ligji.
2. Operatori i sistemit të shpërndarjes, , ofron pa diskriminim shërbimin e shpërndarjes së energjisë elektrike për të gjithë përdoruesit e rrjetit, duke siguruar akses dhe përdorim të rrjetit të shpërndarjes për të gjithë aplikuesit që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet e tjera nënligjore. Operatori i sistemit të shpërndarjes monitoron respektimin e kërkesave dhe treguesvetë performancës të parashikuara nga rregulloret teknike në fuqi.
3. Rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike zhvillohet mbi parimet e kostos me të ulët, në përputhje me planifikimin urban, të drejtat e pronësisë, mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve dhe përdorimin efiçent të energjisë, mbështetur në rregullat teknike dhe të sigurisë të parashikuara në rregulloret teknike në fuqi.

Neni 64

Detyrat e operatorit të sistemit të shpërndarjes

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes:

1. Mban dhe operon një sistem shpërndarje në gjendje të sigurtë, të qëndrueshëm dhe efiçent;
2. Zhvillon rrjetin e shpërndarjes në përputhje me zhvillimin ekonomik dhe parashikimet e rritjes së kërkesës;
3. Lidh të gjithë klientet dhe/ose prodhuesit që do të lidhen në rrjetin e shpërndarjes sipas rregulloreve në fuqi.

4. Siguron akses jodiskriminues të klientëve në rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me dispozitat e legjislacionit perkates qe trajtonburimet e rinovueshme;
5. I siguron përdoruesve të rrjetit informacionin e nevojshëm për aksesin ne rrjet dhe përdorim efikas të rrjetit të shpërndarjes;
6. Mbledh dhe publikon të dhënat e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të monitorimit të tregut dhe transparencës.
7. Mbledh dhe paraqet tek operatori i sistemit të transmetimit, të dhënat e nevojshme për funksionimin e tregut të energjisë elektrike në përputhje me këtë ligj, rregullat e tregut dhe rregullat për ndryshimin e furnizuesit.
8. Ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar të përftuar gjatë kryerjes së veprimtarisë;
9. Prokuron energji për mbulimin e humbjeve të energjisë në rrjetin e shpërndarjes dhe kapacitet rezervë në rrjetin e shpërndarjes në përputhje me procedura transparente jo- diskriminuese.
10. Harton profile tip ngarkese për kategori të caktuar klientësh, për rastet kur të dhënat e matësave të nevojshem për llogaritjen e disballancave janë të padisponueshme.
11. Mban evidencën e shoqërive të regjistruara të furnizimit, të cilat furnizojnë me energji elektrike të gjitha pikat e lidhjesdhe pikat matëse të rrjetit shpërndarës perkates;
12. I jep pa pagese çdo shoqërie të regjistruar të furnizimit të energjisë elektrike, akses në të dhënat e saj të matjes për klientët fundore përkatës. ERE përcakton formatin e të dhënave dhe procedurën për aksesin e furnizuesve ndaj këtyre të dhënave.
13. Ofron shërbime të tjera të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve sipas këtij neni.

Neni 65

Te drejtat e OSSH lidhur me burimet alternative

1. Operatori i sistemit të shpërndarjes përcakton kushtet teknike për instalimin e një burimi alternativtë furnizimit me energji elektrike për klientët që kërkojnë të instalojnë një burim të tillë, si dhe kushtet që duhet të përmbushë një burim alternativ, me qëllim parandalimin e çrregullimeve në rrjet. Këto kushte janë të detyrueshme për klientët që përfitojnë nga një shërbim i tille prej burimeve alternative.
2. Cdo klient që kërkon të instalojë burimin e tij alternativ, dërgon njoftim me shkrim për këtë qëllim pranë operatorit të sistemit të shpërndarjes dhe i siguron përfaqësuesve të furnizuesit akses në burimin alternativme qëllim inspektimin e këtij instalimi.
3. Operatori i rrjetit ka të drejtë të ndërpresë furnizimin me energji elektrike për një klient, në rast se nuk përmbush detyrimet e parashikuara në pikat (1) dhe (2) të këtij neni.

Neni 66

Te drejtat lidhur me sistemet e mbyllura të shpërndarjes

1. ERE mund të klasifikojë një sistem, i cili shpërndan energji elektrike brenda një zone gjeografikisht të kufizuarshërbimesh industriale, tregtare aposherbimesh të përbashkëta, dhe pa rënë ndesh me pikën 4 te ketij neni, nuk bën furnizim për klientët familjare ose kliente jo-familjarë të vegjël, si një sistem imbyllur shpërndarjeje, nëse:
 - a) për arsye të veçanta teknike apo të sigurisë,aktivitetet ose proceset e prodhimit të përdoruesve të këtij sistemi, janë të integruara; ose
 - b) kysistem shpërndan energji elektrike kryesisht pronarit ose operatorit të sistemit te mbyllur apo shoqërive të lidhura ne sistimin e mbyllur.
2. ERE mund të përjashtojë operatorin e një sistemi të mbyllur shpërndarje nga:
 - a) kërkesa për të prokuruar energjinë që përdor për të mbuluar humbjet e energjisë dhe kapacitetet rezervë në sistemin e tij sipas procedurave transparente, jo-diskriminuese dhe të bazuara në tregpercaktuar sipas Nenit 64 te ketij ligji;
 - b) kërkesa që tarifat, ose metodologjitë e llogaritjes se tyre, të jenë të miratuara para hyrjes të tyre në fuqi përcaktuar sipas Nenit 20 te ketij ligji.
3. Kur është dhënë një përjashtim sipas pikës 2 me sipër, tarifat e aplikueshme, ose metodologjitë për llogaritjen e tyre, me kërkesë të një përdoruesi të sistemit të mbyllur të shpërndarjes,do të shqyrtohen dhe miratohen prej ERE në përputhje me nenin 20 te ketij ligji;
4. Përdorimi nga një numër i vogël i klienteve familjaredhe jo-familjare te vegjel, të ndodhur në zonën e mbuluarnga një sistem i mbyllur i shpërndarjes, nuk pengon dhënien e një përjashtimi sipas paragrafit 2;
5. ERE lëshon licencë te veçantepër operatorin e sistemit të mbyllur të shpërndarjes;
6. ERE miraton rregullat për funksionimin e një sistemi të mbyllur shpërndarje.

Neni 67

Ndarja e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

1. Operatori i sistemit të shpërndarjes duhet të jetë ligjërisht i ndarë dhe i pavarur nga aktivitetet e tjera të cilat nuk kanë të bëjnë me shpërndarjen e energjisë elektrike, përfshirë furnizimin e energjisë elektrike.
2. Kur operatori i sistemit të shpërndarjes është pjese e një shoqërie vertikalisht të integruar, në mënyrë që të provojë organizimin dhe funksionimin e e vecantë ligjor, duhet të mbaje një emër tregtar dhe markë tregtare, të ndryshëme nga emrat dhe markat tregtare të aktiviteve të tjera që nuk lidhen me shpërndarjen e energjisë elektrike.
3. Kur operatori i sistemit të shpërndarjes është pjese e një shoqërie të integruar vertikalisht, me qëllim që të jete i pavarur në aspektin organizativ dhe të vendimmarrjes, nga aktivitetet e tjera që nuk lidhen me shpërndarjen, ai duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
 - a. personat përgjegjës për menaxhimin e operatorit të sistemit të shpërndarjes nuk duhet të marrin pjese në strukturat përgjegjëse të shoqërisë së integruar, në mënyrë direkte ose indirekte, lidhur me veprimtarinë e përditshme të prodhimit, transmetimit dhe furnizimit me energji elektrike;

- b. të marrë masat e duhura për të siguruar se interesat dhe aftësitë profesionale të personave përgjegjës për menaxhimin e operatorit të sistemit të shpërndarjes janë marrë në konsideratë, për të garantuar se ata janë të aftë për të vepruar në mënyrë të pavarur për përmbushjen e detyrave dhe objektivave të shoqërisë. Në funksion të përmbushjes së detyrave dhe objektivave si dhe garantimin e pavarësisë së veprimtarisë së tyre, trajtimi financiar i personave përgjegjës për menaxhimin, përfshirë edhe personat përgjegjës të organeve mbikqyrëse të operatorit të sistemit të shpërndarjes që kontrollohet nga shteti, do të miratohet nga Këshilli i Ministrave;
- c. operatori i sistemit të shpërndarjes të këtë të drejta të plotavendim-marrëse, të pavarura nga shoqëria e integruar, lidhur me asetet e nevojshme për funksionimin, mirëmbajtjen apo zhvillimin e rrjetit. Për plotësimin e këtyre detyrave, operatori i sistemit të shpërndarjes duhet të ketë në dispozicion burimet e nevojshme përfshi ato njerëzore, teknike, fizike dhe financiare. Megjithatë, kjo nuk pengon ekzistencën e mekanizmave të përshtatshëm për garantimin e të drejtave të shoqërisë mëmë (kontrolluese) lidhur me mbikqyrjen ekonomike dhe menaxhuese dhe vendimmarrjen për çështje, të cilat janë në kopetencën e saj, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.. Nuk lejohet që shoqëria mëmë (kontrolluese) të japë udhëzime mbi veprimtarinë e përditshme operacionale të sistemit të shpërndarjes së energjisë, dhe as të marrë vendime të caktuara lidhur me ndërtimin apo rikonstruksionin e linjave të shpërndarjes, vlera e investimit të të cilave, nuk tejkalon nivelet e planeve financiare të miratuara apo vlerat e përcaktuara në statutin e shoqërisë apo legjislacionin në fuqi.
- d. Operatori i sistemit të shpërndarjes harton nje program, i cili përcakton masat që do të merren për të siguruar ndalimin e veprimeve diskriminuese si dhe realizimin e objektivave kryesore të shoqërisë të cilat ndikojnë drejtëpërdrejtë në aktivitetin ekonomik e financiar të saj si dhe e mbikëqyrjen e zbatimit të tyre. Ky program përcakton detyrat specifike të punonjësve për arritjen e këtyre objektivave.
- Mbi bazën e programit të hartuar, operatori i sistemit të shpërndarjes përgatit një raport vjetor mbimasat e ndërmarra dhe objektivat e arritura, i cili hartohet nga një strukturë e caktuar përgjegjëse e shoqërisë dhe më pas depozitohet në ERE. Raporti i parë do të dërgohet në ERE brenda muajit shkurt të vitit 2016. Në përmbushje të kësaj detyrestruktura përgjegjëse e operatorit të sistemit të shpërndarjes që harton raportin, duhet të këtë akses ndaj gjithë informacionit të nevojshëm në strukturat e shoqërisë në mënyrë që të përmbushë me korrektësi detyrën e saj.
- e. aktivitetet e operatorit të sistemit të shpërndarjes duhet të monitorohen nga ERE, e cila në bashkëpunim me autoritetin e konkurrencës, siguron se nuk mund të ketë asnje përfitim duke shtrembëruar konkurrencën., Operatori i sistemit të shpërndarjes duhet të marrë masa që të shmangë krijimin e ngatërresave tek palët e interesuara, gjatë komunikimeve e përdorimit të emrit e markës tregtare, në mënyrë që të demonstron identiteti i veçantë i tij, në raport me shoqërinë e furnizimit, në shoqërinë e integruar vertikalisht.

Kodi i shpërndarjes

1. Funksionimi i rrjetit të shpërndarjes duhet të jetë në përputhje me dispozitat e Kodit të Shpërndarjes.
2. Kodi i Shpërndarjes miratohet nga ERE, me propozim të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, i cili bashkëpunon me të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të energjisë elektrike me qëllim hartimin, rishikimin apo përshtatjen e tij.
3. Kodi i shpërndarjes duhet të përcaktojë kërkesat teknike për planifikimin, zgjerimin, funksionimin, kontrollin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes duke përfshirë rregullat specifike për lidhjen dhe aksesin në rrjetin e shpërndarjes, si dhe rregullat e matjes.

Neni 69

Konfidencialiteti i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

Operatori i sistemit të shpërndarjes në përputhje me kërkesat dhe dispozitat e tjera të këtij ligji, ose detyrimi tjetër ligjor për dhenie informacioni, duhet të ruajë konfidencialitetin e informacionit tregtar të marre gjatë kryerjes të funksionit të tij, dhe duhet të parandalojë shpërndarjen e informacionit të ndjeshëm tregtar mbi aktivitetet e tij, i cili do të krijonte perparësi ndaj të tjerëve nëse përhapet në mënyrë jo të drejtë.

Neni 70

Zhvillimi i rrjetit të shpërndarjes

1. Operatorët e sistemit të shpërndarjes, brenda datës 30 shtator të çdo viti, duhet të paraqesin për miratim pranë ERE-s planin e tyre të zhvillimit të rrjetit për 5 (pesë) vitet e ardhshme kalendarike.
2. Në planifikimin e zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes, operatorët e sistemit të shpërndarjes duhet të marrin parasysh masat e efikasitetit të energjisë ose menaxhimit të kërkesës dhe / ose prodhimit prej centraleve të vogla të lidhura në rrjetin e shpërndarjes, që mund të kërkojnë përmirësim ose zëvendësimin e pjesëve të sistemit të shpërndarjes. Planin duhet të përfshijnë mjetet financiare të siguruar për investim në sistemin e shpërndarjes, duke marrë gjithashtu parasysh planifikimin urban dhe rajonal për zonën ku do të kalojnë linjat dhe pajisjet e sistemit të shpërndarjes, që duhet të jenë në përputhje me normat dhe kërkesat e mbrojtjes së mjedisit.
3. Operatori i sistemit të shpërndarjes duhet të paraqesë pranë ERE-s, së bashku me aplikimin për miratim të tarifave, një plan të përditësuar të investimeve për vitin pasardhës. Për ato subjekte që aplikojnë për tarifa për periudha rregullatore më shumë se një vjeçare, programi i përditësuar i investimeve duhet të përfshijë një analizë të investimeve të planifikuara referuar periudhës përkatëse rregullatore.
4. Në rrethanat kur operatori i sistemit të shpërndarjes, përveç arsyeve më të mëdha që janë përtej kontrollit të tij, nuk kryejnë investim i cili sipas planit afatgjatë referuar në paragrafin 1, do të realizohej në tre vitet e ardhshme, ERE ka të drejtë

të ndërmarrë një nga masat e mëposhtme ndaj operatorit të sistemit të shpërndarjes:

- a. detyrimin e operatorit për kryerjene investimit në fjalë;
 - b. detyrimin e operatorit të shpërndarjes për organizimin e një procedure të hapur tenderi, për kryerjene investimit nga investitore privat;
5. Kur ERE ushtron autoritetin e saj në përputhje me pikën 4, shkronja (b), ajo mund të detyrojë operatorin e sistemit të shpërndarjes të pranojë financiminose kryerjen e investimit nga një palë e tretë në emër të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.
 6. Operatori i sistemit të shpërndarjes, në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik organizon procedurat për përzgjedhjen e një investitori sipas pikës 4 të gërmas b) të këtij neni. Në dokumentacionin e hartuar nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe miratuar nga ERE, specifikohet midis të tjerave, edhe norma e kthimit mbi investimin që pasqyron normat e tregut të kapitalit, si dhe marrëveshjen standarde financiare për kryerjen e investimit.
 7. Në rastet kur investimi është bërë sipas pikës 4 germa (b) dhe pikës 5 të këtij neni, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet t'i sigurojë investitorëve të gjithë informacionin e nevojshëm për realizimin e investimit, lidhjen e aseteve të reja me rrjetin e transmetimit ose shpërndarjes dhe të bëjë përpjekjet maksimale për të lehtësuar zbatimin e projektit të investimit.
 8. Çdo investim i ri i bërë nga një palë e tretë sipas pikës 4, germa (b) e këtij neni duhet të jetë në përputhje me standardet dhe normat teknike dhe të sigurisë në fuqi.
 9. ERE, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, harton dhe miraton rregulloren për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planeve të zhvillimit.
 10. Vendimet e parashikuara në pikën (1) dhe (8) të këtij neni, miratohen nga ana e ERE-s pasi të jetë dhënë pëlqimi nga Ministri përgjegjës për energjinë në përputhje me politikën dhe programin e zhvillimit të sektorit sipas nenit 4 të këtij ligji.

Neni 71

Detyrimi i OSSH lidhur me linjat e shpërndarjes

OSSH nuk ka asnjë detyrim ndaj çdo personi fizik apo juridik, për dëme që pretendohet se janë shkaktuar nga afërsia me linjat dhe elementeve të tjera të sistemit të shpërndarjes, ndaj çdo objekti apo strukture, kur kjo e fundit ose çdo pjesë e lidhur me të, është ndërtuar pas ndërtimit të rrjetit respektiv të shpërndarjes.

SEKSIONI VI

MATJA E ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 72

Matja e energjisë elektrike

1. Operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes janë përgjegjës për veprimtarinë matëse dhe shërbimin e leximit të matësve në rrjetet përkatës.
2. Me miratim të ERE, operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes mund të kontraktojnë operatorë të pavarur për kryerjen e funksionit të matjes dhe/ose shërbime të leximit të matësve në sistemet e tyre perkatës.
3. Energjia elektrike e futur në rrjet ose e furnizuar të klientët fundor matet nëpërmjet pajisjeve matëse, në përputhje me rregullat specifike matëse të përcaktuara në Kodet e Transmetimit dhe Shpërndarjes si dhe legjislacionin në fuqi lidhur me fushën e metrologjisë. klientët kanë të drejte të instalojnë njësi matëse shtesë me kërkesën dhe shpenzimet e tyre.
4. Në rast se të dhënat matëse janë përkohësisht të padisponueshme ose të paaksesueshme për një periudhë me të gjatë se 1 muaj, operatorët e sistemit të shpërndarjes dhe transmetimit janë të detyruar të llogarisin vlera reference zëvendësuese bazuar në metodologji specifike të miratuara nga ERE.
5. Matesi dhe/ose sistemi matës pas instalimit duhet vulosur nga operatori i sistemit dhe nga një person juridik i autorizuar apo ilicencuar për këtë qëllim sipas legjislacionit në fuqi, me vulë të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë. Vulosja behet në prani të klientit.
6. Matësit e energjisë elektrike duhet të jenë në përputhje me legjislacionin për instrumentet matës. ERE përcakton klasen e saktësisë matësve të energjisë elektrike në përputhje me qëllimin e përdorimit të tyre.

Neni 73

Kontrolli i matësve

1. Verifikimi i matësve të energjisë elektrike kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) ose nga një person juridik i autorizuar/licencuar për këtë qëllim.
2. Aparatet matës verifikohen përpara vënies në përdorim nëpërmjet metodës së kampionit në bazë të përzgjedhjes rastësore dhe në mënyrë periodike.
3. Periodiciteti i verifikimeve miratohet nga Ministri përgjegjës për energjinë.
4. Gjate procesit të verifikimit të matësve të energjisë elektrike nga DPM ose nga personi juridik i licencuar, duhet të jete pranishëm operatori i sistemit dhe klienti, i cili njoftohet paraprakisht për kohën e kryerjes së verifikimit. DPM miraton procedurat e verifikimit të sistemit matës të energjisë elektrike.
5. Matesi i energjisë elektrike verifikohet nga DPM ose një person juridik i licencuar. Kur pas verifikimit konstatohen pasaktësi në matës dhe nuk ka prova të dëmtimeve të shpenzimet për riparimin ose zëvendësimin, janë në ngarkim të operatorit të sistemit, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Metrologjinë. Nëse konstatohet se matësi është dëmtuar ose në të është ndërhyrë, atëherë zbatohen dispozitat ligjore perkatëse mbi dëmet eventuale të shkaktuara.

6. Kur Klienti dyshon në saktësinë e aparatit mates ose kur vëren pasaktësi në matës, paraqet një ankesë me shkrim prane ERE ose çdo institucioni përgjegjës për mbrojtjen e klientëve, të cilët ia kalojnë DPM-së për trajtim të mëtejshëm. Kur verifikimi i matësit është bërë me kërkesë të klientit dhe gjate verifikimit të matësit nuk konstatohen pasaktësi, shpenzimet e verifikimit paguhen nga klienti ankues.
8. Procedura për paraqitjen e një ankese, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit të ankuesit miratohen me vendim të ERE-s.
9. Tarifat për shërbimet e kryera nga personi juridik i licensuar sipas këtij neni jane te liberalizuara, me kusht që të mos te tejkalojnë tarifatat tavan të miratuara me Udhezim të perbashket të Ministrisë të Financave dhe Ministrisë Përgjegjës për Energjinë.
10. Cdo ndërhyrje në matësit e energjisë elektrike nga persona të pautorizuar ndalohet dhe ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.
11. ERE miraton kontratën "tip" ndermjet operatorit të sistemit dhe subjektit të autorizuar për verifikimin e matesve.

Neni 74

Sistemet matës inteligjente

5. Në veprimtarinë e matjes, do të implementohen sisteme matës inteligjente që ndihmojnë pjesëmarrjen aktive të klientëve fundor në tregun e furnizimit me energji elektrike.
6. Implementimi i këtyre sistemeve matëse është subjekt i një vlerësimi paraprak ekonomik i gjithë kostove afatgjata, përfitimeve të tregut dhe klienteve, duke përcaktuar cila formë e matjes inteligjente është ekonomike dhe arsyeshme me kosto efektive, si dhe cili është afati i pershtatshëm kohor për implementimin e tyre.
7. Ministria përgjegjëse për energjinë, brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përgatit vlerësimin ekonomik sipas paragrafit 2 të këtij neni. Në bazë të këtij vlerësimi, Ministria përgatit një kalendar për implementimin brenda një periudhe 10 vjeçare të sistemeve inteligjente të matjes.
8. ERE siguron ndërveprimin e sistemeve të ndryshme matëse që do të implementohen në gjithë territorin e vendit duke i kushtuar rëndësinë e duhur përdorimit të standardeve të përshtatshme, praktikës më të mirë si dhe rëndësisë e zhvillimit të tregut të brendshëm të energjisë elektrike.

PJESA E GJASHTE

FURNIZIMI I ENERGISË ELEKTRIKE

SEKSIONI I

Neni 75

Aktivitetet e furnizimit

1. Furnizimi me energji elektrike i klientëve fundore mund të bëhet nga çdo i licencuar, i është i pajisur me liçencë për furnizim me energji elektrike të lëshuar nga ERE.
2. Furnizuesit blejnë energji elektrike për furnizimin e klientëve fundore, në tregun e brendshëm bilateral ose të organizuar, si dhe nëpërmjet importeve, me çmime të parregulluara.
3. Furnizimi me energji elektrike i klientëve fundorë duhet të bëhet me çmime të parregulluara, i cili përcaktohet mbi bazën e kontratave të negociuara ndërmjet furnizuesit dhe klientit fundor.
4. Pavarësisht parashikimeve të pikës 2 dhe 3 të këtij neni, për një periudhë tranzitore sikurse përcaktohet në këtë ligj, ERE mund të përcaktojë çmime të rregulluara për kategori të caktuar konsumatorësh, në kuadrin e vendosjes së detyrimit të shërbimit publik ndaj të licensuarëve, sikurse përcaktohet në nenin 46.

Neni 76

Kushtet e përgjithshme për furnizimin

1. ERE miraton rregullore me kushtet e përgjithshme të furnizimit, të cilat janë të unifikuara për të gjithë furnizuesit dhe klientët në territorin e Shqipërisë.
2. Furnizuesit janë të detyruar të pranojnë dhe të aplikojnë kushtet dhe detyrimet e përcaktuara nga kushtet e përgjithshme të furnizimit.
3. Kushtet e përgjithshme të furnizimit publikohen në faqen e internetit të ERE-s, si dhe në faqet e internetit të furnizuesve.

Neni 77

Kontrata për furnizim me energji elektrike

1. Të drejtat dhe detyrimet e ndërsjellta të furnizuesit dhe klientit të energjisë elektrike përcaktohen në një kontratë të nënshkruar nga të dy palët.
2. Kontrata sipas pikës 1 të këtij neni përmban, përveç elementeve të përgjithshme të përcaktuara në legjislacionin që rregullon marrëdhëniet kontraktuale, edhe elementet e mëposhtme:
 - a. Të dhënat dhe adresën e furnizuesit;
 - b. shërbimet e siguruara nga furnizuesi, duke përfshirë kohën e lidhjes në rrjet të klientit si dhe nivelet e cilësisë së shërbimit të ofruar;
 - c. llojet e shërbimeve të mirëmbajtjes të ofruara;
 - d. çdo rregullim të aplikueshëm mbi kompensimin dhe rimbursimin, në rast mospermbushje të nivelit të cilësisë së shërbimit të kontraktuar, duke përfshirë këtu edhe faturimin e pasaktë dhe të vonuar;
 - e. mjetet me të cilat mund të sigurohet informacioni i përditësuar mbi gjithë tarifatat e aplikueshme dhe pagesat e mirëmbajtjes;

- f. metoden e njoftimit të ndryshimeve në çmime dhe kushtet e tjera të furnizimit me energji elektrike;
 - g. kohëzgjatjen e kontratës së furnizimit, kushtet për rinovimin dhe përfundimin e saj, si dhe të drejtat dhe detyrimet në rast të anulimit dhe përfundimit të marrëveshjes, duke përfshirë informacionin për detyrimet financiar në rastet e tërheqjes nga kontrata;
 - h. mënyrën e fillimit të procedurave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
 - i. informacion lidhur me të drejtat e klientëve, përfshirë trajtimin e ankesave dhe të gjithë informacionin e përmendur në këtë pikë, të komunikuar në mënyrë të qartë përmes faturave të energjisë elektrike ose faqes së internetit të operatorit të energjisë elektrike;
 - j. të drejtat dhe detyrimet e furnizuesit dhe klientit në rast dështimi në përmbushjen e detyrimeve të tyre, dhe në rast pezullimi të përkohshëm të furnizimit;
 - k. elemente të tjera në varësi të karakterit specifik dhe llojit të shërbimit të ofruara nga furnizuesi.
3. Kushtet dhe detyrimet për kontratën e furnizimit përcaktohen në mënyrë të detajuar nerregulloren e parashikuar në piken(1) të nenit 76.
 4. Dispozitat e kontratës përfshijnë të drejtat dhe detyrimet e klientit të shprehura në mënyrë të qartë, të thjeshtë dhe pa nënkuptime.
 5. Klientëve u sigurohet paraprakisht një informacion imjaftueshëm mbi kushtet e kontratës, por në çdo rast përpara lidhjes së kontratës. Kushtet dhe detyrimet e përgjithshme të kontratës duhet të jenë të drejta dhe transparente. Ato jepen në një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme dhe nuk duhet të përfshijnë pengesa jo-kontraktuale në ushtrimin e të drejtave të klientëve. Klientët mbrohen nga metodat e padrejta ose deformuese të shitjes.
 6. Kur kontratat lidhen nëpërmjet personave të tretë të autorizuar, informacioni lidhur me çështjet e parashtruara në këtë nen, i jepet përpara lidhjes së kontratës.
 7. Kontrata nuk mund të kufizojë të drejtën e klientit për të ndryshuar furnizuesin dhe nuk imponon detyrime financiare shtesë për klientin që ushtron të drejtën e tij legjitime.

Neni 78

Detyrimet e furnizuesve

1. Në rast të një kontrate furnizimi, furnizuesi është i detyruar të lidhë një marrëveshje për akses në sistem, me operatorin e sistemit të transmetimit apo shpërndarjes, në rrjetin e të cilit është lidhur objekti i klientit. Në këtë rast, Furnizuesi është përgjegjës përballë operatorit të sistemit për çdo disbalancë të shkaktuar nga ana e klientit fundor dhe ky i fundit, është përgjegjës përballë Furnizuesit për çdo disbalance të shkaktuar nga ana e tij.
2. Furnizuesi informon klientët e tij:
 - a. në mënyrë të qartë dhe transparente lidhur me çmimet në fuqi, kushtet dhe detyrimet standarde për përdorimin e shërbimeve të tij;

- b. mbi metodat e ndryshme të pagesës, të cilat nuk duhet të jenë diskriminuese midis klientëve. Sistemet e parapagimit duhet të jenë të drejta dhe të reflektojnë konsumin e pritshëm. Çdo ndryshim në kushte dhe detyrime duhet të pasqyrojë kostot e furnizuesit për sistemet e ndryshme të pagesave.
 - c. për të drejtën e tyre për të zgjedhur dhe ndryshuar pa pagesë furnizuesin, pasi kanë ekzekutuar të gjitha detyrimet e mëparshme..
 - d. lidhur me mundësinë e përdorimit të procedurave të thjeshta dhe me kosto efektive për ndjekjen e ankesave të tyre. Çdo furnizues i siguron klientëve të tij të drejtën për një standard të mirë shërbimi dhe ndjekje të ankesës, duke lehtësuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes në mënyrë të drejtë dhe të shpejte, brenda jo më shumë se 3 (tre) muaj nga paraqitja e ankesës;
 - e. në menyre të sakte, mbi konsumin dhe kostot aktuale të energjisë elektrike , me qëllim mundësimin e menaxhimit të konsumit të energjisë nga ana e tyre..
 - f. për ndryshimin e kushteve kontraktuale të paktën 15 ditë përpara aplikimit të tyre, duke përfshirë informacionin në lidhje me të drejtën e tyre për të hequr dore nga kontrata me dhënien e njoftimit. Furnizuesit njoftojnë klientët në mënyrë të drejtpërdrejtë për rritje të mundshme të tarifave, dhe duhet t'i informojë se janë të lirë të tërhiqen nga kontrata nëse ata nuk pranojnë kushtet e reja, të cilat u janë njoftuar paraprakisht;
 - g. nëpërmjet faturës dhe me materiale promovuese, informon klientët fundorë në lidhje me:
 - i. Të dhëna mbi cdo burim energjietë siguar nga furnizuesi gjatë vitit të mëparshëm , në nivel kombëtar, në mënyrë të qartë dhe të krahasueshme;
 - ii. burimin e informacionit, siç janë faqet e internetit, ku vihen në dispozicion të publikut të dhënat për ndikimin në mjedis, të emetimit të CO₂ dhe mbeturinave radioaktive, si dhe energjisë elektrike tëeprodhuar. iii. të drejtat e tyre për sa i përket mënyrës së zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të raste të tilla.
 - h. lidhur me të dhënat e konsumit të tij, duke i mundësuar çdo furnizuesi akses ndaj të dhenave të matjes së klientit, në baze të nje marrëveshje të qarte dhe pa pagese.
 - i. lidhur me detyrimet përfundimtare të klientëve pas çdo ndryshimi të furnizuesit të energjisë elektrike. Ky informacion duhet të paraqitet jo më vonë se gjashtë javë pas ndryshimit të furnizuesit;
3. Furnizuesi gjithashtu:
- a. publikon dhe ruan parametrat e kontraktuar të cilësisë së furnizimit me energji elektrike të klientëve, në përputhje me rregulloren për cilësinë e furnizimit të miratuar nga ERE-ja, sipas Nenit 7 të këtij ligji,
 - b. furnizon klientët me energji elektrike në përputhje me kontratën e nënshkruar, sipas Neneve 76 dhe 77 të këtij ligji,
 - c. mban të dhëna të ndara në regjistrat e tij të biznesit lidhur me furnizimin e klientëve sipas kushteve të tregut, furnizimin e klientëve në bazë të çmimeve të rregulluara dhe kushteve për ofrimin e shërbimit universal dhe furnizimin e klientëve si mundësi e fundit,
 - d. Përshtat dhe zbaton kushtet për furnizuesit, të cilat duhet të përputhen me dispozitat e rregullores së hartuar sipas Nenit 76 dhe i publikon ato, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para fillimit të aktivitetit të furnizimit me energji.

e. ushtron veprimtarinë e furnizimit me energji elektrike në mënyrë të sigurt, të besueshme dhe efikase;

Neni 79

Detyrimet e furnizuesve sipas detyrimit të shërbimit publik për të siguruar shërbimin universal

1. Furnizuesit e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, për të siguruar shërbimin universal, duhet të:
 - a) të informojë klientët për të drejtat e tyre dhe për kushtet e furnizimit sipas shërbimit universal;
 - b) të njoftojë klientët për kushtet e furnizimit dhe cmiimin e energjisë elektrike përfshirë informimin për të drejtën e tyre për të zgjedhur një furnizues tjetër;
 - c) të furnizojnë me energji elektrike në kushtet e shërbimit universal kategori të caktuar të klientëve brenda territorit, për të cilin janë licensuar për të kryer shërbimin universal sipas parashikimeve të nenit 81;
 - d) të furnizojë konsumatorët në nevojë duke respektuar kushtet e përcaktuara në Nenin 83 të këtij ligji;
 - e) të paguaj për energjinë e lëvruar sipas shërbimit universal në përputhje me çmimet e miratuara nga ERE, sipas metodologjisë së përcaktuar në nenin 20 të këtij ligji;
 - f) të publikojë në faqen e internetit çmimet e furnizimit në kushtet e shërbimit universal, të miratuara nga ERE

Neni 80

Të drejtat e furnizuesit

Furnizuesit kanë këto të drejta:

- a. të përdorin, sipas kushteve të rregulluara, shërbimet e operatorit të tregut, operatorit të sistemit të transmetimit, operatorit të sistemit të shpërndarjes, në bazë të rregullave të tregut, kodeve të rrjetit dhe kontratave përkatëse.
- b. të kenë akses në sistemin e transmetimit dhe sistemin e shpërndarjes, në përputhje me dispozitat për aksesin e palëve të treta, të përcaktuar në Nenin 23 të këtij ligji.
- c. të kërkojnë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike nga operatori i sistemit të transmetimit ose operatori i sistemit të shpërndarjes, kur klienti nuk përmbush detyrimet kontraktore, në përputhje me dispozitat e Nenit 77, përveç rastit të një klientinë nevojë, për të cilët zbatohen parashikimet e veçanta, të përcaktuara në këtë ligj dhe akteve nenligjore përkatëse;
- d. të kërkojnë nga operatori i sistemit të transmetimit ose nga operatori i sistemit të shpërndarjes, rilidhjen dhe vazhdimin e furnizimit me energji elektrike, kur klienti ka përmbushur detyrimet, të cilat shkaktuan ndërprerjen e furnizimit.

Neni 80/a

Kushtet për çmimet e rregulluara

1. Kur ERE përcakton çmimet e rregulluara për klientët fundorë që furnizohen sipas shërbimit universal, duhet të argumentojë arsyen e vendosjes të çmimeve të rregulluara bazuar në rrethanat e veçanta të tregut të energjisë elektrike, në përputhje me këtë nen.

2. ERE mund të vendosi që kategori të caktuar klientësh, mund të mos përfitojnë nga i njëjti trajtim dhe kushte mbrojtje.

3. ERE duhet të sigurojë që çmimet e energjisë objekt rregullimi për qëllim të shërbimit universal reflektojnë kostot përkatëse, të cilat përfshijnë kostot reale të furnizimit, koston e plotë të gjenerimit, investimet e nevojshme dhe një normë të arsyeshme të kthimit të investimit, koston e importit, koston e shërbimit të furnizimit dhe një normë të arsyeshme të borxhit të keq.

4. Në vendimin për miratimin e çmimit të rregulluar për kategoritë e caktuara të konsumatorëve, ERE përcakton afatin për përfundimin e periudhës, brenda së cilës klientët trajtohen me çmime të rregulluara.

5. ERE rishikon mbi baza vjetore, metodologjitë përkatëse dhe nivelin e çmimit të miratuar si dhe nevojën për vazhdimin e trajtimit me çmime të rregulluara për kategorinë e caktuar të klientëve, bazuar në detyrimet e përcaktuara të shërbimit publik.

Këto vendime i njoftohen Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, i cili, bazuar në analizën e tregut rajonal mund të propozojë masa të tjera për përfundimin e trajtimit të kësaj kategorie klientësh nga çmimet e rregulluara.

Neni 81

Përcaktimi i furnizuesit të mundësisë së fundit

1. ERE në përputhje me nenin 80 të këtij ligji, përcakton një furnizues të mundësisë së fundit për sigurimin e shërbimit universal, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
2. Furnizuesi i mundësisë së fundit caktohet për një periudhe jo më të gjatë se 3 (tre)vjet.

Neni 82

Detyrimet e furnizuesit të mundësisë së fundit

Furnizuesi i mundësisë së fundit ka këto detyra:

1. informon klientët mbi të drejtat dhe kushtet për t'u furnizuar sipas shërbimit universal;
2. njofton klientët mbi kushtet dhe detyrimet e furnizimit dhe çmimin e energjisë elektrike, dhe i informon mbi të drejtën e tyre për të zgjedhur një furnizues tjetër;

3. furnizon energji elektrike si një shërbim universal për klientët shtëpiak dhe të vegjël jo shtëpiakë brenda një territorit të caktuar, për të cilin është caktuar të realizoje shërbimin universal sipas Nenit 80 të këtij ligji.
4. furnizon klientët në nevojë duke respektuar kushtet e caktuara në Nenin 83 të këtij ligji;
5. faturon për energjinë e dorëzuar si shërbim universal me çmimin e miratuar nga ERE sipas metodologjisë të zhvilluar dhe miratuar nga ERE, në përputhje me nenin 20 të këtij ligji;
6. publikon në faqen e vet te internetit, çmimet e furnizimit sipas shërbimit universal të miratuara nga ERE.

Neni 83

Furnizimi për klientët në nevojë

1. Për zbatimin e shërbimit universal për klientët familjare të cilëve u është aprovuar statusi i klientëve në nevojë, këta të fundit kanë të drejtën e përfitimit nga kushtet e përcaktuara me poshtë, vetëm në rastet kur ata janë regjistruar si të tillë pranë ministrisë përgjegjëse për mirqëniën sociale, dhe pasi i njoftohen. .
2. Kontrata e furnizimit të klientëve në nevojë, fillon në ditën që klienti fundor rregjistrohet prej operatorit të sistemit të shpërndarjes. Operatori i sistemit të shpërndarjes paraqet informacion për furnizuesit e shërbimit universal rreth klientëve në nevojë, brenda 5 (pese) ditëve nga regjistrimi i tyre..
3. Furnizuesi i klientit në nevojë , i paraqetkëtij te fundit kontratën dhe e informon rreth të drejtave dhe kushteve të furnizimit nen shërbimin universal.
4. Klienti në nevojë furnizohet me energji elektrike sipas tarifave të miratuara nga ERE dhe në përputhje me Nenin 81 të këtij ligji.
5. ERE siguron që çmimet e energjisë elektrike, subjekt i rregullimit për qëllim të sigurimit të shërbimit universal për klientët në nevojë, janë në përputhje me parimin e reflektimit të kostos dhe të pandryshueshme gjate një viti kalendarik. .
6. Furnizuesi që furnizon me energji elektrike klientin në nevojë mund të ndërpresë shërbimin në përputhje me kushtet specifike për këtë kategori klientësh, te përcaktuara nga ERE .
7. Kontrata e furnizimit të klientëve në nevojë, përfundon në fund të muajit të dytë, nga momenti i çregjistrimit nga ana e operatorit të sistemit të shpërndarjes si klientë në nevojë.

Neni 84

Rregullat për ndryshimin e furnizuesit

1. Termat, kushtet dhe procedurat për ndryshimine furnizuesit të energjisë elektrike do të miratohen nga ERE brenda 6-muajsh nga hyrja në fuqi e ketij ligji.
2. Rregullat për ndryshimin e furnizuesit përfshijnë të paktën:
 - a. kushtet dhe proceduren për ndryshimin e furnizuesit, që duhet të mundesojë ndryshimin brenda një periudhe maksimale te percaktuar sipas Modelit të Tregut.

- b. kushtet që duhet të plotësoje furnizuesi i ri, veçanërisht lidhur me balancimin, në përputhje me rregullat e balancimit të percaktuara në Nenin 57 të këtij ligji;
 - c. të drejtat e furnizuesit të ri lidhur me aksesin, përdorimin e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes, për furnizimin e klientit që ndryshoi furnizuesin.
 - d. detyrimet e furnizuesit, kontrata e furnizimit cila është në proces përfundimi;
 - e. të drejtat e furnizuesit, kontrata e furnizimit cila është në proces përfundimi, lidhur me rregullimin e të gjitha detyrimeve të mbetura;
 - f. detyrimet e operatorit të sistemit në të cilin është i lidhur klienti fundor;
 - g. rregullimin e detyrimeve të klientëve fundore kur ndryshojne furnizuesin.
 - h. detyrimin e klientëve fundore që të kenë ekzekutuar të gjitha detyrimet në raport me furnizuesin e parë.
3. Ndryshimi i furnizuesit behet me kërkesë të klientit fundor dhe pa kosto shtese perklientin.
 4. Çdo mosmarrëveshje që rezulton prejankesavete bëra nga klientet fundore ose furnizuesit, lidhur me procedurën e ndryshimit të furnizuesit, paraqiten neERE-s për zgjidhje. Ankesa nuk ka efekt te shtyrjes ne kohete se drejtesper ndryshim të furnizuesit dhe/ose të hyrjes në fuqi të kontratës së re të furnizimit.
 5. Një furnizues, kontrata e të cilit për furnizimin e klientit është në proces përfundimi, nuk mund të vendosë kushte të tjera për ndërprerjen e furnizimit, përveç atyre të percaktuara në rregullat për ndryshimin e furnizuesit, të miratuara nga ERE-ja në përputhje me paragrafin 1 të këtij Neni.Ky furnizues është i detyruar të furnizojë klientin fundor deri në përfundimin e procedurës së ndryshimit të furnizuesit;
 6. ERE-ja monitoron zbatimin e rregullave për ndryshimin e furnizuesit.

Neni 85

Ruajtja e të dhënave

1. Te licencuarit për furnizimin e energjisë elektrike mbajnë në dispozicion të ERE-s, dhe autoritetit kombëtar të konkurrencës, ne permbushjen e detyrave të tyre, të dhënat mbi transaksionet në kontratat e furnizimit me energji elektrike, dhe derivativat e energjisë elektrike me operatorët e shitjes me shumice dhe operatorët e sistemit të transmetimit, për një periudhe të paktën 5 (pese) vjeçare.
2. Të dhënat përfshijnë detaje mbi karakteristikat e transaksioneve të tilla si, kohëzgjatja, rregullat e shpërndarjes dhe të shlyerjes, sasine, afatete ekzekutimit, çmimet e transaksionit, mjetet e identifikimit të operatorit të shitjes me shumice në fjale, detajet e specifikuar për të gjitha kontratat e pashlyera të furnizimit me energji elektrike, si dhe derivativat e energjisë elektrike.
3. ERE mund të vendosë, venien në dispozicion ndaj pjesëmarrësve të tregut pjese të këtij informacioni, duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtare.

Neni 86

Situatat emergjente në furnizimin me energji elektrike

1. Këshilli i Ministrave mund të shpalle gjendjen e emergjences në furnizimin me energji elektrike në rast të:
 - a. një force madhore, përfshirë edhe një thatësi e cila redukton prodhimin e hidrocentraleve në Shqipëri;
 - b. masave të marra nga strukturat shtetërore për garantimin e sigurisë kombëtare dhe mbrojtjen e vendit;
 - c. aksidenteve dhe avarive në pajisjet e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes të sistemit të energjisë elektrike;
 - d. mungesave afatgjata të burimeve paresore energjetike për prodhimin e energjisë elektrike.
 - e. falimentimit të furnizuesit;
2. Gjate situatave emergjente, të licensuarit dhe klientet duhet të respektojnë kufizimet në përdorimin e energjisë elektrike. Ministri përgjegjës për energjinë nëpërmjet një rregullore të veçantë përcakton shtrirjen dhe mënyrën e kufizimit të furnizimit me energji elektrike.
3. Shkurtime të furnizimit në situata të jashtëzakonshme bazohen në kritere të paracaktuara që kanë të bëjnë me menaxhimin e disbalancave prej operatorit të sistemit të transmetimit. Çdo masë mbrojtëse merret në konsultim të ngushtë me operatorët esistemeve të transmetimit të vendeve ndërkufitare, duke respektuar marrëveshjet përkatëse dypalëshe, përfshi edhe marrëveshjet për shkëmbimin e informacionit
4. Të licencuarit ose furnizuesit e tjerë nuk janë përgjegjës për sanksionet e ardhura si rezultat i ndërprerjes ose kufizimit të energjisë elektrike për rastet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij Neni, përveç rasteve kur situata e emergjencës vjen si rezultat direkt i fajit të të licencuarit apo furnizuesit.
5. Në situata emergjente, me propozimin e Ministrisë Përgjegjëse për Energjinë Komitetin e Emergjencave Civile dhe me vendim të Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, mund të vendoset mbi të licencuarit detyrimi i shërbimit publik në lidhje me sigurinë e furnizimit, duke përfshirë detyrimin e importit të energjisë elektrike, detyrimin e furnizimit vetëm të kategorive të caktuara të klientëve ose kushte të tjera të veçanta në kryerjen e aktiviteteve të licencuara. Ky detyrim do të jetë në proporcion me emergjencën dhe nuk duhet të shtrihet përtej periudhës së nevojshme për kapërcimin e situatës së emergjences. Ministri përgjegjës për energjinë kërkon mendimin e ERE-s para propozimit për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme dhe marrjes së masave përkatëse, sipas pikës 1 të këtij neni. Vendimi sipas pikës 1 të këtij neni është i kufizuar në kohë dhe publikohet. Çdo kosto shtesë e shkaktuar ndaj të licencuarit për shkak të detyrimit të shërbimit publik të vendosur sipas këtij paragrafi, pasi konfirmohet edhe nga ERE-ja, kompensohet nga Buxheti i Shtetit.

SEKSIONI II

PAGIMI I DETYRIMEVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 87

Pagesa e detyrimeve të energjisë elektrike

1. Klienti fundor i energjisë elektrike, është i detyruar të paguaj detyrimet e energjisë elektrike, përfshirë edhe vlerën e kamatëvonesave kur është në vonesë, brenda afateve kohore të përcaktuara në kontratën tip të furnizimit, të miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë Elektrike ose brenda cdo afati tjetër kohor, të rënë dakord ndërmjet klientit dhe furnizuesit të energjisë elektrike.

2. Furnizuesi i energjisë elektrike, ka autoritetin dhe kompetencat e dhëna sipas këtij kreu dhe legjislacionit në fuqi, për të arkëtuar vete ose nëpërmjet të tretëve detyrimet e energjisë elektrike të papaguara, për të cilat nuk është ushtruar e drejta e ankimit gjyqësor dhe nuk është siguruar një masë sigurimi për pezullimin e procedurave të arkëtimit të detyrimit.

Neni 88

Njoftimi dhe kërkesa për të paguar

1. Sa herë që furnizuesi I energjisë elektrike, konstaton se një konsumator nuk ka paguar plotësisht dhe në datën e caktuar detyrimet e energjisë elektrike, furnizuesi i dërgon, me postë rekomande, një njoftim me shkrim, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimit.

2. Nëse klient nuk paguan detyrimin e energjisë elektrike, nuk ankimon detyrimin dhe nuk ka marrë një vendim për pezullimin e procedurave të arkëtimit të detyrimit nga ana e gjykatës, furnizuesi i energjisë elektrike duhet ta arkëtojë detyrimin, duke përdorur njërën ose disa prej masave, të parashikuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi.

Neni 89

Masat e sigurimit dhe masat e ekzekutimit të detyrueshëm të detyrimeve të energjisë elektrike

1. Nëse klient nuk paguan detyrimin e energjisë elektrike në datën e caktuar, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, furnizuesi I energjisë elektrike, nëpërmjet personave të autorizuar nga ana e tij, përveç inicimit të procedurave të nderprerjes se energjisë, ndërmerr masat e mëposhtme:

1.1- Në rast se detyrimi i akumuluar që rrjedh nga një kontratë furnizimi energjie elektrike , i papaguar brenda afatit kohor të përcaktuar në kushtet e saj, është mbi 100,000 lekë për klientin familjarë dhe mbi 200,000 lekë për klientin jofamiljarë, Furnizuesi siguron detyrimet e papaguara, duke vendosur masën e sigurimit, barrë hipotekore, mbi pasurinë e paluajtshme që furnizohet me energji elektrike nga kjo kontratë furnizimi, detyrimet e së cilës nuk janë paguar. Në këtë rast zbatohet procedura e parashikuar në Nenin ___ si më poshtë.

1.2- Në rast se detyrimi i akumuluar që rrjedh nga një kontratë furnizimi energjie elektrike , i papaguar brenda afatit kohor të përcaktuar në kushtet e saj, është nën 100,000 lekë për klientin familjarë dhe nën 200,000 lekë për klientin jofamiljarë, Furnizuesi i energjisë elektrike, inicion procedurat e ekzekutimit të detyrueshim duke

kërkuar lëshimin e urdhrin të ekzekutimit dhe inicimin e ekzekutimit të detyrueshëm, sikurse përcaktohet në Kodin e Procedurës Civile dhe legjislacionin në fuqi.

1.3 Në cdo rast, Furnizuesi ka të drejtë të arkëtojë detyrimin e energjisë elektrike duke iniciuar procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm sipas pikës 1.2 edhe nëse detyrimet janë në vlera më të larta se ato të parashikuara në pikën 1.1.

Neni 90

Masa e sigurimit të detyrimit të energjisë elektrike

1. Masa e sigurimit konsiston në vendosjen e barrës hipotekore mbi pasurinë e paluajtshme të klientit, që furnizohet me energji elektrike në bazë të kontratës së furnizimit e cila rezulton me detyrime të papaguara të energjisë elektrike.

2. Vendimi për të vendosur barrën hipotekore mbi pasurinë e paluajtshme për detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, bëhet me shkrim nga personat e autorizuar të Furnizuesit.

3. Përpara nxjerrjes së vendimit të vendosjes së hipotekës ligjore mbi pasurinë e paluajtshme, Furnizuesi njofton me postë rekomandë klientin fundor, mbi masat që do të ndërmerren për shkak të moszekutimit të detyrimit. Njoftimi për barrën hipotekore duhet të përmbajë të dhënat e nevojshme, për të identifikuar klientin, detyrimin e papaguar, pasurinë objekt të barrës hipotekore dhe kompetencën e furnizuesit për të dorëzuar kërkesë për vendosjen e masës së sigurimit.

4. Furnizuesi Publik me Pakicë nuk procedon me dorëzimin e kërkesës për vendosjen e hipotekës ligjore, në rast se klienti tarifor ekzekuton menjëherë pas njoftimit, të gjitha detyrimet e energjisë elektrike dhe njofton Furnizuesin për ekzekutimin e detyrimit, mënyrën dhe datën e ekzekutimit.

5. Kushtet dhe procedurat e detajuara duke përfshirë edhe formatin e njoftimit dhe formatin e vendimit për vendosjen e hipotekës ligjore, parashikohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Vendimi dhe kërkesa për vendosjen e hipotekës ligjore i drejtohen zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ku gjendet pasura e paluajtshme..

Neni 91

Ankimimi i masës së sigurimit të detyrimit të energjisë elektrike

1. Klienti ka të drejtë të ankimojë vendimin për masën e sigurimit të detyrimit të papaguar të energjisë elektrike, pranë organit më të lartë ekzekutiv të furnizuesit dhe të kërkojë çlirim nga sigurimi, vetëm nëse vendimi ka dalë apo është ekzekutuar në mënyrë të parregullt. Ankimi bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga çasti i marrjes dijani për këtë parregullsi.

2. Kur kërkesa e klientit miratohet nga organi më i lartë ekzekutiv I furnizuesit, në bazë të një vendimi të marrë me shkrim, titullari I organit më të lartë ekzekutiv ndërmer menjëherë të gjitha masat e nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi, për zhbllokimin e masës së sigurimit mbi pasurinë e paluajtshme të klientit.

3. Në qoftë se organi më i lartë ekzekutiv i furnizuesit, nuk pranon ankimin e paraqitur, klient mund ta ankimojë këtë vendim në gjykatë.

Neni 92

Sekuestrimi dhe shitja e pasurisë së sekuestruar

1. Nëse klient nuk paguan detyrimin e energjisë në datën e caktuar, Furnizuesi mund të mbledhë detyrimin e papaguar nëpërmjet sekuestrimit të pasurisë së paluajtshme të siguruar në favor të tij sipas pikës 1.1 të Nenit 89, pasuri e cila është në pronësi të klientit fundor.

2. Ekzekutimi i masës së sigurimit nëpërmjet sekuestrimit dhe shitjes së pasurisë, është objekt i dispozitave të Kodit të Procedurës Civile dhe realizohet nga furnizuesi nëpërmjet përbaruesit gjyqësor.

3. Pasuria e paluajtshme mund të sekuestrohet sipas pikës 2, pas vendosjes së masës së sigurisë mbi pasurinë, dhe vetëm nëse kanë kaluar 30 ditë kalendarike pas datës, kur urdhri i sekuestrimit është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga klient. Urdhri i sekuestrimit, përmban:

a) shumën e detyrimeve të papaguara;

b) të dhëna identifikuese të kontratës së furnizimit për të cilën rezultojnë detyrime të papagura ;

b) afatin për pagesën e detyrimeve;

c) pasurina e paluajtshme që sekuestrohet;

ç) mënyrën e ekzekutimit të sekuestrimit;

d) informacionin rreth së drejtës së klientit për ankimim në gjykatë.

4. Pasuria e sekuestruar shitet në ankand, i cili kryhet në përputhje me procedurat dhe kushtet e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

5. Të ardhurat nga shitjet përdoren fillimisht për të paguar shpenzimet e procedurave të sekuestrimit e shitjes, kamatëvonesat dhe detyrimin kryesor.

6. Shuma e mbetur i kthehet klientit brenda pesë ditëve pune nga data e përfundimit të ankandit.

PJESA E SHTATE KLIENTËT DHE MBROJTJA E KLIENTIT

Neni 93

Klientët fundorë

1. Të gjithë klientët kanë të drejtë të zgjedhin furnizuesin e tyre të energjisë elektrike.
2. Të gjithë klientët mund të zgjedhin që të furnizohen nga çdo furnizues i licencuar, vendas ose i huaj me çmime të parregulluara, që siguron se:
 - a. marrëveshja e furnizimiteshte në përputhje me Rregullat e Tregut dhe kushtet e përgjithshme për furnizim të miratuar nga ERE;
 - b. para se të hyjë në një marrëveshje të plotë furnizimi, furnizuesi nënshkruan një marrëveshje për shërbimin e balancimit, me operatorin e sistemit të transmetimit ose operatorin e sistemit të shpërndarjes, në përputhje me rregullat e tregut të miratuara nga ERE-ja;
3. Klienti fundor ka të drejtë:
 - a. të paraqesë ankesë pranë ERE-s, nëse veprimtaria e furnizuesit nuk përputhjet me kushtet e miratuara të vendosura në kontrate;
 - b. të marrë të gjithë informacionet e nevojshme nga furnizuesit në përputhje me Nenin 78 të këtij ligji, përfshirë informacionin në formë të shkruar, lidhur me konsumin e energjisë elektrike
4. Klienti fundor ka detyrim:
 - c. të paguajë për energjinë elektrike, në përputhje me kushtet e kontratës ose atotë rregulluara.
 - d. t'i mundësojë operatorit të sistemit të shpërndarjes ose transmetimit, ku klienti ka kryer lidhjen, instalimin, mirëmbajtjen dhe leximin e pajisjeve për matjen e konsumit të energjisë elektrike.
 - e. të përdorë energjinë elektrike duke respektuar kushtet dhe detyrimet e specifikuar në kontratën e furnizimit, dhe në përputhje me këtë ligj;
5. Klientet jo-familjarë të lidhur në rrjetin e tensionit të mesëm dhe rrjetin e tensionit të lartë kanë të drejtë të kontraktjnë në të njëjtën kohë disa furnizues.

Neni 94

Mbrojtja e klientit

1. Klienti fundor, gëzon mbrojtje të drejtave të tij në përputhje me këtë ligj si dhe të legjisllacionit në fuqi që rregullon mbrojtjen e klientit.
2. Nuk lejohet sjellja diskriminuese e të licensuarve ndaj klienteve. Kushtet e ofruara për nënshkrimin e kontratës duhet të jenë transparente, të hartuara në gjuhë të qartë dhe lehtësisht të kuptueshme.
3. Gjatë kryerjes së aktiviteteve të tij, furnizuesi vepron në mënyrë të tillë që të sigurojë trajtim të barabartë të të gjithë klientëve.
4. Klientët fundorë kanë të drejtë:
 - a. të marrin të gjithë informacionin e përcaktuar në Nenin 78 të këtij ligji.
 - b. të njoftohen paraprakisht për çdo ndryshim të kushteve të kontratës dhe nëse nuk bie dakord me to të ndërpresë në mënyrë të njehshme kontratën. Ofruesit e shërbimeve njoftojnë paraprakisht në mënyrë transparente dhe të kuptueshme klientët e tyre për çdo rritje të tarifave, por jo më pakse një periudhë normale faturimi përpara se rritja të hyjë në fuqi.

- c. të marrin informacion te plotepër çmimet, tarifat, termat dhe kushtet standarde në lidhje me aksesin dhe përdorimin e shërbimeve të energjisë elektrike.
- d. ti perdore mekanizma të ndryshme të pagese te cilat sigurojne trajtim te barabarte midis, perfshire mekanizma parapagimi që reflektojnë në mënyrë drejte konsumin e pritshëm dhe tarifat e mundshme.
- e. të mbrohen prejmetodave të padrejta të faturimit;
- f. te mos paguajnë asnjë kostoshtese lidhur me ndryshimin e furnizuesit;
- g. te perfitojnë nga procedura transparente e të thjeshta për trajtimin e ankesave të tyre. Klientët kanë të drejtë te perfitojnë një nivel të mirë shërbimi dhe trajtimi të ankesave prej furnizuesve të tyre. Këto procedura të shqyrtimit të ankesave jashtë-gjyqësore duhet te zgjidhen në mënyrë të drejtë dhe të shpejtë, mundësisht brenda një afati 3-mujor, dhe kur është e mundur, të parashikojnë një sistemi rimbursimi dhe / ose kompensimi.
- h. duhet të informohen për të drejtën e tyre përsa i përket shërbimit universal në përputhje me Nenin 82 të këtij ligji.
- i. duhet të informohen në mënyrë të plote dhe te shpeshte mbi konsumin e tyre aktual dhe kostot respektive të energjisë elektrike, për te patur mundesi te rregullojne konsumin e energjisë elektrike. Ky informacion jepet brenda afateve të arsyeshme kohore, në varesi të pajisjeve matëse me të cilat është i pajisur klienti. Ky shërbim ofrohet pa kosto shtesë për klientin.
- j. marrin një informacion të bilancit te konsumit dhe financiar të mbylljes pas çdo ndryshimi të furnizuesit të energjisë elektrike, jo më vonë se gjashtë javë nga ndryshimi i furnizuesit.

Neni 95

Mbështetja për klientët në nevojë

1. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale, brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për energjinë, Ministrinë e financave, në konsultim me ERE dhe grupet e interesit, përcakton kriteret dhe procedurat për përfitimin e statusit të klientit në nevojë, të drejtat e tyre, si dhe masat që do të ndërmerren me qëllim mbrojtjen e kësaj kategorie klientesh, për përmbushjen e nevojave të tyre për energji elektrike.
2. Menyra e trajtimit, kriteret dhe procedurat për përfitimin statusit të klientit në nevojë, përmendur në pikën (1) të këtij neni, miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale, duke pasur në konsideratë të paktën rrethanat e mëposhtme:
 - klientët me të ardhura me të ulëta, të cilët e përdorin energjinë elektrike për furnizimin e vendbanimit tyre të përhershëm. Në përcaktimin e nivelit të të ardhurave, përveç të ardhurave monetare, duhet të merren në konsideratë të gjitha pasuritë që disponon klienti.
 - klientët që kanë konsum të energjisë elektrike të lidhur në rrjetin një-fazor me një fuqi maksimale prej 16 Amper;
 - nivelin maksimal i konsumit të energjisë për person, në varësi të sezonit;
 - mënyra e përkrahjes së drejtpërdrejtë nga Buxheti i Shtetit;
 - financimi për mbështetje të klientëve në nevojë, të behet në mënyrë jo-diskriminuese, duke mos lejuar ndërfinancimin nga kategoritë e tjera të klientëve të energjisë elektrike.

3. Klientët në nevojë, që përfitojnë mbështetje financiare nga buxheti i shtetit, sipas kriterëve dhe procedurës së përcaktuar me Vendim të Keshillit të Ministrave, rregjistrohn në një rregjistër të vecantë nga struktura përkatëse pranë ministrisë përgjegjëse për mirqënien sociale. Ky informacion i përcillet edhe operatorit të sistemit të shpërndarjes dhe nga ky i fundit i përcillet furnizuesit të energjisë elektrike.

4. Klientët në nevojë, që përfitojnë mbështetje financiare nga buxheti i shtetit, sipas kriterëve dhe procedurës së përcaktuar me Vendim të Keshillit të Ministrave, duhet të përdorin fondet e përfitura për të paguar detyrimet e energjisë elektrike. ,

5. Klientet në nevojë kane të drejtën e furnizimit me energji elektrike në përputhje me parashikimet e nenit 83 të këtij ligji për sa kohe ata permbushin kriteret e përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të këtij neni.

6. Kriteret mbi bazën e të cilave përfitohet statusi i klientëve në nevojë, kontrollohen të paktën çdo 3 muaj nga struktura përkatëse pranë ministrisë përgjegjëse për mirëqënien sociale. Në rastet kur, për shkak të ndryshimit të rrethanave, klienti humb statusin e klientit në nevojë, struktura përkatëse pranë ministrisë përgjegjëse për mirëqënien sociale e heq nga rregjistri i klientëve në nevojë dhe njofton operatorin e sistemit të shpërndarjes. Te dhënat e klientit të hequr nga rregjistri i klientëve në nevojë, duhet të ruhen për një periudhë prej pesë vjetësh pas çregjistrimit.

7. Me marrjen e njoftimit, operatori i sistemit të shpërndarjes, njofton me shkrim furnizuesit për çregjistrimin e klientit në nevojë. .

8. Mbi bazën e rregjistrimit të përcjellë nga krijon dhe ruan një regjistër të klientëve vulnerabël. Regjistri permban emrin dhe mbiemrin e klientit vulnerabël, numrin e identifikimit personal, adresën në të cilën banesa e tij furnizohet me energji elektrike, numrin e kontratës së furnizimit, kategorinë e veçantë të shërbimit për të cilin ai ka të drejtë përfitimi, si dhe përfitimet që i janë dhënë sipas statusit të klientit vulnerabël. Te dhënat prej regjistrimit mund t'ijepen vetëm klientit i cili ka aplikuar për regjistrim si klient vulnerabël, si dhe furnizuesit të tij.

PJESA E TETË

TREGU I ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 96

Tregu i energjisë elektrike

1. Tregu i energjisë elektrike mund të zhvillohet si treg bilateral ku energjia elektrike shitet dhe blihet drejtpërdrejt ndërmjet pjesëmarrësve të tregut, në bazë të kontratave dypalëshe ose si treg i organizuaritës në avance, i organizuar dhe i menaxhuar nga Operatori i Tregut.
2. Ministri përgjegjës për energjinë, në bashkëpunim me palët e interesuara në sektorin e energjisë elektrike, harton modelin e tregut të energjisë elektrike në përputhje me dispozitat e këtij ligji, ku përfshihen të paktën:
 - a) përcaktimi i mënyrave të bashkëpunimit ndërmjet pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike;
 - b) përcaktimi i marrëdhënieve kontraktuale të nevojshme;

- c) përcaktimi i informacionit dhe shkëmbimit të të dhënave kryesore të kërkuara;
3. Modeli i Tregut të energjisë elektrike, i cili brenda datës 31 dhjetor 2018, do të krijojë një treg konkurrues të ditës në avance të energjisë elektrike, miratohet nga Këshilli i Ministrave, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
 4. Operatori i Sistemit të Transmetimit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, prodhuesit, furnizuesit, klientët dhe pjesëmarrësit e tjerë të tregut kontribuojnë në mirëfunksionimin dhe transparencën e tregjeve me shumicë dhe pakicë.
 5. Funkcionet e tregut kryhen nga operatori i sistemit të transmetimit, i cili vepron si operator i tregut për tregun e energjisë elektrike në Shqipëri, deri ne daljen e tij si strukture e veçante jashte Operatorit te Sistemit te Transmetimit.

Neni 97

Rregullat e tregut

1. ERE bashkëpunon me të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të energjisë elektrike për hartimin dhe miratimin e Rregullave të Tregut të energjisë elektrike në përputhje me këtë ligj dhe Modelin e Tregut të Energjisë Elektrike, duke përfshirë rregullat që përcaktojnë planifikimin, dispeçerimin, balancimin, zgjidhjen, dhe kërkesat per rezervën.
- 2 Rregullat e Tregut miratohen nga ERE-ja, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e miratimit të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike.

Neni 98

Përgjegjësia e balancimit të pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike

1. Çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike ka përgjegjësi për balancimin të energjisë elektrike.
2. Pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike, mund të rregullojnë përgjegjësinë për balancimin, nëpërmjet një kontrate me operatorin e tregut duke marrë kështu statusin e palës përgjegjëse për balancim, ose duke nënshkruar një kontratë për transferimin e përgjegjësisë së balancimit ndaj një pale tjetër përgjegjëse, duke u bërë kështu një pjesëtar i grupit balancues të palës përgjegjëse për balancim, në përputhje me rregullat e tregut.

Neni 99

Tregu i balancimit të energjisë elektrike

1. Operatori i tregut siguron shërbimet e balancimit të sistemit prej ofruesve të ketij shërbiminë tregun e balancimit, në përputhje me rregullat e balancimit të miratuara nga ERE-ja.
2. Rregullat e balancimit përcaktojnë kushtet lidhur me balancimin, përfshi rregullat për:

- a. ofruesit e shërbimit të balancimit, sigurimin e shërbimeve të balancimit, përcaktimin e sasive të energjisë për tu përdorur prej ofruesve të shërbimit të balancimit, dhe shlyerjen e detyrimeve financiare ndaj ofruesve të shërbimit të balancimit;
 - b. pjestaret përgjegjës të grupit balancues, përfshirë krijimin dhe menaxhimin e llogarive të grupit balancues, përcaktimin e sasive të energjisë që do të përdoren për disbalancimin dhe përgjegjësitë financiare të palëve përgjegjëse të grupit të balancimit.
3. Operatori i sistemit të transmetimit bashkëpunon me operatorët e tjerë të rrjeteve të transmetimit të vendeve fqinje për sigurimin e tregut balancues në nivel rajonal, me qëllim garantimin e sigurisë operacionale dhe funksionimin eficient të tregut të balancimit, bazuar në parimin e konkurrencës efektive, mos-diskriminimit dhe transparencës.

PJESA E NENTË TË DREJTAT E PRONËSISË

Neni 100

Të drejtat e pronësisë të të licencuarve

1. Për sigurinë e shërbimit të energjisë elektrike, i licencuari mund të kërkojë përdorimin e njërës prej të drejtave të mëposhtme mbi pronën:
 - a. të drejtën për linjat;
 - b. të drejtën e përdorimit;
 - c. të drejtën e servitutit;
 - d. shpronësimin.
2. Kur ushtrohen të drejtat, sipas pikës 1 të këtij neni, dëmet e shkaktuara nga:
 - a. vendosja e shenjave, matjeve, testeve;
 - b. instalimi i pajisjeve, aksesit në to, kryerja e punës në to; dhe
 - c. pengimi ose kufizimi i përdorimit të pronës,
 i rimbursohen pronarit ose përdoruesit të pronës nga i licencuari, në përputhje me Kodin Civil dhe legjislacionin për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik.
3. Në zonat natyrore të mbrojtura, të drejtat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni jepen me miratimin paraprak të autoritetit përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për zonat e mbrojtura. Në zonat që gëzojnë mbrojtje vendore nevojitet miratimi paraprak i njësisë përkatëse vendore.
4. Në rast të përfundimit të të drejtave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, i licencuari risjell pronën e përdorur në gjendjen e mëparshme.
5. Kur klienti fundor ndodhet në një ndërtesë me shumë apartamente banimi ose strukturë me disa biznese, i licencuari ka të drejtë të ushtrojë të gjitha të drejtat lidhur me shtrirjen e kabllave, përdorimin, riparimin, ndërtimin, servitutit dhe shpronësimin në atë ndërtesë, të cilat janë të nevojshme për sigurinë e pajisjes dhe furnizimit të këtij klienti, deri tek matësi i energjisë elektrike.
6. Pajisjet dhe rrjetet e furnizimit me energji elektrike të ndërtuara pas hyrjes në fuqi të këtij ligji nga persona ose shoqëri private, që përdoren për t'i shërbyer më shumë se një klienti fundor, transferohen tek OSSH bazuar në rregullat e përcaktuara nga ERE dhe regjistrohen në librin e aseteve të reja që i shtohen rrjetit të shpërndarjes.

Pas transferimit, OSSH ka përgjegjësinë e riparimit dhe mirëmbajtjes së këtyre pajisjeve dhe instalimeve. Në rast se transferimi i këtyre pajisjeve dhe rrjeteve tek operatori i rrjetit behet pa pagese, prona do të përfshihet në librine aseteve të reja që i shtohen operatorit të rrjetit, dhe do të shërbejë vetëm për llogaritjen e kostove të mirëmbajtjes së aseteve të reja në llogaritjen e tarifës së shpërndarjes.

Neni 101

E drejta për linjat ose e drejta e servitutit

1. Bazuar në dispozitat e neneve 56 dhe 70 të këtij ligji, e drejta mbi linjat ose e drejta e servitutit i garantohet OST ose OSSH për instalimin dhe funksionimin e rrjetit të shpërndarjes ose transmetimit mbi pronën e të tretëve, duke garantuar përdorimin e pronës në përputhje me standardet dhe rregullat e shfrytëzimit dhe sigurimit teknik të pajisjeve elektrike.
2. Në përputhje me të drejtën e linjës ose të servitutit, i licencuari për funksionet e transmetimit ose shpërndarjes, mund të kryejë në pronën e të tretit veprimet e mëposhtme:
 - a. instalon dhe vendos, nën tokë dhe/ose mbi tokë, linja elektrike dhe telekomunikacioni;
 - b. instalon struktura mbajtëse, pajisjet e transformimit dhe ato kyçëse të vendosura mbi to;
 - c. instalon dhe shfrytëzon në pronën e të tretit linja të varura (teleferik dhelinja) të përdorur për qëllimet e ndërtimit dhe shfrytëzimit të centralit elektrik, nënstacionet, linjave të transmetimit dhe strukturat e saj mbështetëse;
 - d. shfrytëzon, mban, riparon, transformon dhe heq pajisjet e instaluar, të percaktuara në gërmat a) dhe b) të kësaj pike të këtij neni;
 - e. heq pemët, shkurret, degët e tyre dhe rrënjët e ndodhur brenda zonës së sigurisë së selinjave, të cilat çojnë në sigurinë e funksionimit të tyre;
 - f. mund të lidhet dhe të kapërcejë rrugët e transportit, lumenjtë, rrjedhat e ujërave, liqenet, kanalet dhe ndërtesat, sipas procedurave të parashikuara në rregulloret teknike dhe legjislativën në fuqi.
3. Çdo e drejtë mbi linjat ose e drejtë servituti e vendosur sipas këtij neni, jepet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
4. Gjate shfrytëzimit të rrjeteve dhe instalimeve perkatese, Operatorët e Sistemit të Shpërndarjes dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit janë të përjashtuar nga aplikimi i çdo takse prej organeve të qeverisjes vendore.

Neni 102

E drejta e përdorimit të përkohshëm

1. Pjesë të centraleve prodhuese, pajisje të sistemeve të transmetimit, shpërndarjes dhe ato ndihmëse, mund të vendosen, funksionojnë dhe mirëmbahen në pronën e të tretëve, në bazë të të drejtës së përdorimit të përkohshëm.
2. E drejta e përdorimit të përkohshëm rregullohet sipas legjislativës për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik.

Neni 103

Shpronësimi

1. Për vendosjen e centraleve, të nënstacioneve, të kabinave elektrike ose të linjave të transmetimit të energjisë elektrike, i licencuari mund të nisë procedurën e shpronësimit të pronës së një personi të tretë, në përputhje me legjislacionin për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik. Për vendosjen e centraleve, të nënstacioneve, kabinave e linjave elektrike të cilat vendosen mbi pronë publike në administrim të njesive të pushtetit vendor, në rast të pamundësisë së lidhjeve të kontratave perkatese me njesinë e qeverisjes vendore, i licencuari mund të nisë procedurën për marrjen e titullit mbi truallin, në përputhje me legjislacionin që rregullon heqjen e titullit mbi truallin në administrim të njesive vendore.
2. Nisja e procedurës së shpronësimit me qëllim instalimin dhe funksionimin e rrjeteve të transmetimit e të shpërndarjes dhe të strukturave të tyre mbështetëse, mund të kërkohet vetëm nëse e drejta mbi linjat, sipas pikës 2 të nenit 95 të këtij ligji, pengon ose ndërpret në mënyrë thelbësore përdorimin e rregullt të pronës.
3. Procedura e shpronësimit për instalimin dhe funksionimin e pajisjeve të transformimit dhe të komutimit që nuk janë të vendosura në struktura mbështetëse, që i perkasin centralit të prodhimit të energjisë elektrike, mund të fillojë vetëm nëse palët nuk bien dakord për të drejtën e përdorimit sipas neneve 95 dhe 96 të këtij ligji ose nëse autoritetet përgjegjëse të planifikimit dhe rregullimit të territorit nuk e kanë miratuar atë.

PJESA EDHJETË

DISPOZITA TË TJERA

Neni 104

Hetimet administrative

1. ERE-ja, në përmbushje të detyrimeve të saj sipas nenit 19 të këtij ligji, në bazë të fakteve të siguruara për shkeljen e dispozitave të këtij ligji, nepermjet një aktitë nxjerrë në përputhje me këtë ligj, mund të fillojë hetimin administrativ mbi ketoshkelje të evidentuara.
2. Hetimet Administrative bëhen në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe procedurat specifike të miratuara nga ERE-ja.

Neni 105

Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e mëposhtme të kryera prej të licencuarve, kur nuk përbëjnë vepër ose kundravajtje penale, përbëjnë kundravajtje administrative dhe ndëshkohen nga ERE me gjobë prej 0.5 % të të ardhurave vjetore të vitit paraardhës të licencuarit.

- a. Refuzimi i paraqitjes së të dhënave dhe raporteve periodike apo dërgimi me vonesë i tyre, ose dërgimi i të dhënave të pasakta nga i licencuari.
 - b. Moszbatimi i detyrimeve lidhur me llogaritjen dhe aplikimin e kostove dhe tarifave.
 - c. Moszbatimi i detyrimeve të shërbimit publik të vendosura sipas Nenit 46 të këtij ligji.
 - d. Moszbatimi i detyrimeve për mbajtjen e llogarive të ndara sipas Neneve 34, 52 dhe 67 të këtij ligji.
 - e. Moszbatimi i detyrimeve që lidhen me aksesine palëve të treta në rrjet, siç përcaktohet nedispozitat e këtij ligji dhe aktet e tjera nënligjore.
 - f. Moszbatimi i detyrimeve të përcaktuara në kontrata të rregulluara.
 - g. Mospublikimi i informacionit për tarifatat dhe kushtet e përgjithshme të aksesit në rrjet, si dhe përdorimit të shërbimeve të rrjetit.
 - h. Mosparaqitja e programeve të investimeve dhe/ose moskryerja e investimeve të planifikuara sipas kërkesave të nenit 19 (2)(j), 56 dhe 70 të këtij ligji dhe rregullores përkatëse të ERE-s.
 - i. Shkelja e njërës prej kushteve dhe kërkesave të cilësisë së furnizimit të miratuar nga ERE-ja.
 - j. Moszbatimi i vendimeve të ERE-s për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.
 - k. Shkeljeja e detyrimeve dhe kushteve të licencës si dhe rregullave të ERE-s që nuk janë përmendur pikat e mësipërme.
 - l. Refuzimi i pjesëmarrësve të tregut për të nënshkruar kontrata të rregulluara brenda 15 ditëve kalendarike.
2. ERE aplikon gjobë progresive për çdo ditë shkelje nga i licencuari, për rastet e mëposhtme:
- a. Kur i licencuari nuk përmbush vendimin e ERE-s për korrigjimin e një shkelje brenda afateve të përcaktuara prej saj. Në këtë rast i licencuari dënohet me gjobë në masën 0.1 % të xhiros mesatare ditore të vitit financiar paraardhës, për çdo ditë shkelje nga dita e afatit të përcaktuar në vendimin përkatës të ERE-s.
 - b. Kur i licencuari nuk përmbush detyrimin e pageses së takses rregullatore ndaj ERE-s, dënohet me gjobë në masën 0.2% të xhiros mesatare ditore të vitit financiar paraardhës, për çdo ditë vonesë nga dita e përcaktuar për pagesën.
3. ERE miraton rregullat për specifikimin dhe uljen e masës së gjobave, duke:
- i. reduktuar gjobën në masën 50% në rastet kur shkelja për të cilën parashikohet gjoba, është njoftuar nga vetë i licencuari;
 - ii. reduktuar gjobën në masën 1/3 në rastet kur i licencuari bashkëpunon në mënyrë aktive në procesin e hetimit administrativ të ERE-s për shkeljen në fjalë;
 - iii. reduktuar gjobën në masën 40% në rastet kur i licencuari tregon se ka ndermarre veprime konkrete që përmirësojnë tregun e rregulluar.
4. Për shkelje të përsëritura prej të licencuarit, ERE në përputhje me të drejtat e saj të përcaktuara sipas nenit 19 (2)(b) dhe 41 të këtij ligji, mund të vendosë heqjen e licencës ndaj subjektit që kryen shkeljen.
5. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimeve dhe ekzekutimit të vendimeve të Bordit të Komisionerëve të ERE-s bëhet sipas legjislacionit për kundërvajtjet administrative.

1. Këshilli i Ministrave ngarkohet të miratojë aktet nënligjore sipas neneve 4(2)(a), 5(3), 6(1), 8(2), 7(6), 31(10), 33(1), 33(4), 35(2), 41(4), 48(2), 48(4), 50(2) dhe 89 (4) të këtij ligji.
2. MEI ngarkohet të miratojë aktet nënligjore sipas nenit 86 (2) të këtij ligji.
3. ERE ngarkohet të miratojë aktet nënligjore sipas neneve 7(1), 15(4), 16(1), 19, 20(7), 26(5), 26(6), 27(2), 32(3), 37, 41(2), 43(1), 44(1), 55(2), 56(14), 59(2), 61(2), 66(6), 68(2), 70 (8), 73 (10), 76 (1), 83 (1), 91 (2), 93(1) dhe 99 (3) të këtij ligji.

Neni 107

Shfuqizimi i akteve dhe dispozitave të tjera ligjore

1. Ligji nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe çdo dispozitë tjetër ligjore që bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji shfuqizohet.
2. Pavarësisht këtij neni, ky ligj nuk shfuqizon asnjë të drejtë private të fituar nga personat juridikë sipas ligjeve ose kontratave për shitjen e aksioneve të shoqërive pronë shtetërore, apo të marrëveshjeve të mbështetjes shtetërore lidhur me këto shitje.
3. Ato pjesë të akteve nënligjore që bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, nuk cenojnë qëndrimin në fuqi të dispozitave të tjera të këtyre akteve nënligjore, deri në daljen e akteve të reja sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 108

Dispozitat tranzitore

1. Aktet nënligjore që rregullojnë veprimtaritë në sektorin e energjisë elektrike, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji do të zbatohen për aq sa janë të aplikueshme në përputhje edhe me pikën 3 të nenit 107, deri në rishikimin e tyre dhe daljen e akteve të reja në përputhje me kërkesat dhe afatet e vendosura në këtë ligj.
2. Klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, janë të detyruar të dalin në tregun e liberalizuar jo më vonë se data 31 dhjetor 2015, klientët e lidhur në tension 20 kV, jo më vonë se data 31 dhjetor 2016, ndërsa klientët e lidhur në nivelin e tensionit 10 kV dhe 0,6 kV, jo më vonë se data 31 dhjetor 2017.

Neni 109

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë mbas publikimit të tij në Fletoren Zyrtare